



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 16 PRILL 2009

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
16. APRILA 2009.GODINE

PRILL– APRIL
2009

Drejtoi seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritarë,
Po i hapim punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 65 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

Ju njoftoj se në pajtim me Rregullën 6 pika 2 dhe 23 të Rregullores së Punës të Kuvendit, Kryesia e Kuvendit në marrëveshje me grupet parlamentare kanë përgatitur dhe Kuvendit i ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotshme plenare. Rendin e ditës e keni marrë.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës. Të paraqitur për fjalë nuk kemi.

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 26 mars 2009

Ju njoftoj se Procesverbali dhe Transkripti i seancës plenare, të mbajtur më 26 mars 2009, u janë shpërndarë deputetëve. Pyes deputetët, nëse kanë vërejtje në Procesverbalin e seancës, të mbajtur më 26 mars 2009.

Konstatoj se Kuvendi miratoi Procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 26 mars 2009.

Pika e dytë e rendit të ditës:

- Koha për pyetje parlamentare

Ju njoftoj se në mes të dy seancave është parashtruar një numër i madh i pyetjeve parlamentare, saktësisht 47, ndërsa koha e paraparë është e kufizuar në 50 minuta.

Gjithashtu, ju njoftoj se pasi ka shumë pyetje, do të shkojmë nga një pyetje për deputetë. Nëse e arrijmë ta kryejmë këtë, pastaj fillojmë me pyetjet tjera të deputetëve.

Vazhdojmë me pyetjen e parë.

Deputeti Naim Rustemi, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala. Naimi mungon.

Atëherë, pyetja parlamentare shkon për botim. Deputetja Luljeta Shehu, pyetje për ministrin e Transportit dhe Telekomunikacionit, zotin Fatmir Limaj. Ministri nuk është.

Deputetja Nurishahe Hulaj, pyetje për ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Zenun Pajaziti. Deputetja, a është këtu? Po, ministri nuk është. Doni ta lexoni pyetjen, Luljeta? Mirë, urdhëro bëre pyetje, pastaj shkon për botim kjo, pasi është hera e dytë. Fjalën e ka deputetja Luljeta Shehu.

LULJETA SHEHU: Faleminderit!

I nderuar Kryetar,
I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,
Të nderuar deputetë,

Çështja është: Hekurudha Krushë e Vogël – Prizren, nga rruga e Atmaxhes deri në Prizren, në gjatësi rreth 6 kilometra, thuaja është e mbuluar tërësisht. Pyetja është: Pse kjo gjendje dhe a keni ndërmend të ndërmerrni masa për parandalimin dhe sanimin e kësaj gjendjeje? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete! Ministri nuk është këtu, pyetja shkon për botim në Buletinin e Kuvendit, që tani po quhet Parlamenti, ndoshta ju ka njoftuar Bordi i Informimit.

Fjalën e ka deputeti Naim Rrustemi, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe Financave, zotin Ahmet Shala. Ministri nuk është këtu, po bëje pyetjen!

NAIM RRUSTEMI: I nderuar Kryetar, faleminderit! Unë e di që ministri përgjigje në këtë pyetje s'ka, sepse Ligji u thye me dy këmbët, por po e bëj një farë ftese që ta dëgjoj edhe Përfaqësuesi i EULEX-it, hetuesia, ICO, që të kenë parasysh rrogat që i marrin dhe ta arsyetojnë pagesën dhe taksapaguesit.

Çështja: Posttelekomi i Kosovës ka lidhur marrëveshje pa procedurë të hapur dhe transparente që të marrë pjesë me konsorcium në tenderin për licencën e katërt të Telefonisë mobile në Shqipëri. Marrëveshja për konsorciumin ka pasur këtë përbërje: “PTK”, “Union Grup”, “Albania Drink”, “Distribution”, Sajmir Mane, personalisht si individ, “ACI Engineering” dhe “Infosoft”. Me këtë marrëveshje PTK-ja ka....

KRYETARI: Një përjashtim, i zgjatni kohën edhe një minutë.

NAIM RRUSTEMI: Me këtë marrëveshje PTK merr përsipër edhe financimet, shfrytëzimin e fondeve publike, të burimeve publike apo edhe të burimeve të tjera financiare. Pyetja parlamentare: A është respektuar ndonjë ligj i Kosovës gjatë procesit të krijimit të kësaj marrëveshje? Nëse po, cili është ai ligj që lejon marrjen e një vendimi të tillë pa procedura konkurruese dhe transparente? Nëse jo, pse nuk është marrë asnjë hap, asnjë masë për parandalimin e veprimeve joligjore që janë përgjegjësi të juaja si ministër i Ekonomisë dhe i Financave?

KRYETARI: Zoti ministër, fjala është e juaja.

MINISTRI AHMET SHALA: Përshëndetje! Unë pyetjen në fakt nuk e kam marrë, por megjithatë e kuptova pyetjen dhe do të përgjigjem.

Ndërmarrjet publike menaxhohen me Ligjin për ndërmarrjet publike. Çdo intervenim direkt i ndonjë ministrie do të kuptonte kthim mbrapa në historinë e dështuar, kështu që nuk e kemi ndërmend të... Ekziston, shumë e qartë, statuti i ndërmarrjeve publike për të drejtat e tyre, të drejtat e bordit për menaxhimin e ndërmarrjeve publike. Gjithçka çka Qeveria e Kosovës mund të bëjë, është respektimi i Ligjit të ndërmarrjeve publike, të cilin e ka aprovuar Parlamenti i respektuar i këtij shteti. Dhe, ne, konsideroj që konform ligjit jemi duke vepruar. Në qoftë se dikush ka shkelur procedurat, ligjet apo statutet, janë ligjet e tjera të cilat i rregullojnë këto elemente. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Luljeta Shehu, mund ta lexosh edhe njëherë pyetjen. Urdhëro, më fal, Naim Rustemi e ka fjalën.

NAIM RRUSTEMI: Unë, me fjalët e ministrit që tentoi të arsyetohet, e kuptova se e thirri në bashkëfajësi kryeshefën ekzekutiv të PTK-së, Bordin e PTK-së dhe Qeverinë, sepse nuk është e mundshme pa masa konkurruese që të futet në konsorcium, asnjë ligj nuk e ka lejuar. Si ka qenë e mundur, kah janë identifikuar njerëz që janë të afërt me biznesin e Miroslav Mishkoviqit që të futen në konsorcium me ndërmarrjet tona publike. Si janë identifikuar ata, kah i kemi njohur. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, a ke apo s'ke përgjigje shtesë? Mirë, faleminderit!
Deputetja, Luljeta Shehu, pasi ministri erdhi me vonesë, mund ta parashtroni edhe njëherë pyetjen. Fjalën e ka deputetja Luljeta Shehu.

LULJETA SHEHU: Faleminderit!
I nderuar ministër,

Çështja është: Hekurudha Krushë e Vogël – Prizren, nga rruga e Atmaxhes deri në Prizren, në gjatësi rreth 6 kilometra, thuaja është e mbuluar tërësisht. Pyetja është: Pse kjo gjendje dhe a keni ndërmend të ndërmerrni masa për parandalimin dhe sanimin e kësaj gjendjeje? Faleminderit!

MINISTRI FATMIR LIMAJ: E nderuara deputete,
Unë, së pari dua të ju them që pyetja juaj nuk më ka ardhur ende. Unë tani për herë të parë po e marrë, por sido që të jetë, është një pyetje e cila ka marrë një përgjigje para disa ditësh për të gjithë pjesën e hekurudhës nga Xërxa për Prizren. Është një segment hekurudhor që pas lufte nuk ka mund të futet në funksion për shkak të dëmtimeve që kanë ndodhur në të kaluarën dhe, fatkeqësisht, zhvillimet e pasluftës kanë dëmtuar po thuaj në tërësi këtë segment. Ministria e Transportit, në këtë rast, Drejtoria e Hekurudhave është munduar që sadopak ta ruaj atë infrastrukturë, e cila iu ka ekspozuar një vjedhjeje dhe një dëmtimi të vazhdueshëm në atë pjesë. Për shkak të mungesës së mjeteve financiare në të kaluarën, Drejtoria e Hekurudhave, Ministria e Transportit, po flas në të kaluarën, nuk ka mund të investojë. Dhe, ne tani jemi në përpjekje për të gjetur fonde që edhe këtë pjesë të hekurudhës të vendit tonë ta kthejmë në funksion, me qëllim që gjithë rrjeti hekurudhor në Kosovë të funksionalizohet. Se sa do të marrë kohë kjo, tani nuk mund të them për shkak se varet nga fondet. Por, ajo që dua të them, është se ne jemi në koordinim të ngushtë me Policinë e Kosovës që, të paktën, pasurinë publike të Hekurudhës së Kosovës, jo vetëm në këtë pjesë, por dua t'ju them që hekurudhat e Kosovës iu kanë ekspozuar një vjedhjeje, po them, në tërë territorin e Kosovës, një dëmtimi të tërësishëm. Unë disa herë edhe këtu kam bërë apel që njerëzit të kenë kujdes dhe të apelojnë t'i denoncojnë të gjithë ata keqbërës, sepse kjo po kushton me jetën e njerëzve, posaçërisht në pjesët ku hekurudha është funksionale, sidomos ajo Fushë Kosovë – Ferizaj – Shkup. Ajo pjesë shpesh ka ndodhur që mjetet e sigurisë, të cilat e kanë një kosto të lartë të çmimit, janë dëmtuar, janë vjedhur dhe kjo ka shkaktuar si pasojë edhe fatkeqësi të ndryshme që kanë ndodhur në atë pjesë.

Ne këtë, tani për tani po mundohemi ta ruajmë në procedurë, në koordinim me Policinë e Kosovës, ku ju duhet ta dini që në këtë pjesë përgjegjësinë e kanë të tjerët dhe duhet të na ndihmojnë. Ne, në ndërkohë po përpiqemi të gjejmë fonde për ta riaktivizuar dhe funksionalizuar këtë segment tepër të rëndësishëm të transportit hekurudhor të vendit tonë.

KRYETARI: Pasi zëvendëskryeministri edhe ministrat janë këtu kërkoj, nga Zyra koordinuese e Qeverisë që pyetjet t'i dërgojnë me rregull në ministritë e Kabinetit qeveritar.

Deputetja Nurishahe Hulaj, pyetje për ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Zenun Pajaziti. Deputete, e keni fjalën.

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit!

I nderuari ministër Pajaziti,

Çështja: Qytetarët e Republikës së Kosovës kanë arsye të domosdoshme që të pajisen me dokumentacione zyrtare të Republikës së Kosovës dhe për këtë qasja e tyre në shërbimet ekzistuese është shumë e vështirësuar për të nxjerrë dokumentacionin si letërnjoftimin, pasaportën e të tjera. Pritja në rend është e gjatë 4 gjer në 7 orë. Pyetja është: A keni planifikuar shërbime shtesë me qëllim që t'ju mundësohet qytetarëve qasja më e lehtë në procedurat administrative të nxjerrjes së dokumentacioneve zyrtare? Ju faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën.

MINISTRI ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit, deputetë,

Zonja Hulaj, ne po hymë në vitin e dytë tani të reformave të përgjithshme në gjendjen civile. Siç e dini, edhe këtu në foltore kam treguar se viti i parë ka qenë viti i nxjerrjes së dokumenteve të reja, viti i dytë është projektuar si vit i reformave në shërbime dhe në krijimin e një infrastrukture krejt tjetër për sa i përket dhënies së shërbimeve për qytetarë.

Ne e kemi kryer një projekt që ka të bëjë me krijimin e një agjencie për regjistrin civil në përgjithësi. Do të fuzionohen të gjitha departamentet që kanë të bëjnë me dokumentet dhe shërbimet për qytetarë në mekanizëm të vetëm dhe aktualisht jemi duke punuar në segmente të veçanta, në instalimin e softuerëve të caktuar që kanë të bëjnë me shpejtimin e disa procedurave për sa i përket bartjes së të dhënave nga vendi ku aplikon një qytetar, deri te Qendra e prodhimit të dokumenteve. Ky është një proces që për ne është mjaft i vështirë për shkak se kemi ekspertizë jo të mjaftueshme dhe kapacitete, infrastrukturë më të vjetër. Megjithatë, faza e parë është kryer. Edhe këtë vit mendojmë që ky proces deri me instalimin e plotë nuk do të mund të përfundohet deri në valën kur qytetarët tanë, sidomos ata që janë jashtë vendit, do të vinë në numër më të madh, kështu që kemi paraparë që prej 1 qershorit të bëjmë një projekt, sikur në vitin e kaluar, që është me orar shtesë të punës sa për ta zbutur, sidomos valën e madhe të qytetarëve tanë që janë jashtë vendit për t'i pajisur ata me dokumente. Ndërsa, ne do të vazhdojmë me reformat dhe deri në fund të vitit ne mendojmë që forma e aplikimit jo që do të jetë vetëm në kornizën e afatit ligjor për të gjithë qytetarët, por ne mendojmë që ta shkurtojmë dukshëm atë afat ligjor dhe mendojmë që, po ashtu, do të kemi gjatë këtij viti një numër më të madh të qytetarëve që do të pajisen me letërnjoftim.. Ju e dini që tash është edhe kusht që gjithë qytetarët të pajisen edhe me letërnjoftime para se ata ta kenë pasaportën dhe kjo po shkakton po ashtu një vonesë të madhe te qytetarët.

Ju e dini, po ashtu, para disa ditësh ne kemi instaluar edhe certifikatat e reja të dizajnuara rishtas. Nuk kemi tash të bëjmë me certifikata të rëndomta, por kemi instaluar dokumente me elemente të larta të sigurisë, pra certifikata të cilat nuk munden në raste të këqija të falsifikohen nga dikush. Pra, ky është një proces i gjerë i reformave, i cili po ashtu kërkon durim dhe mirëkuptim. Gjithçka kemi planifikuar. Besojmë që kryesisht gjatë verës të jemi sa më të efektshëm për qytetarët. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Deputete, ke pyetje shtesë. Urdhëro!

NURISHAHE HULAJ: Po! Zoti ministër, të gjithë atyre që kanë punuar në shërbimet për dhënien e dokumentacioneve për qytetarët, a iu është bërë kompensimi material për orët shtesë të punës që kanë punuar me një angazhim maksimal deri më tani?

KRYETARI: Zoti ministër!

MINISTRI ZENUN PAJAZITI: Po, në një nga mbledhjet e kaluara të Qeverisë ne kemi miratuar një vendim. Ka qenë fjala për një muaj pagesë e tyre shtesë. Ne, siç e dini, për shkak të nevojave kemi vazhduar një muaj më shumë se sa që kemi paraparë në plan dhe do të vazhdojë prapë, nëse e miraton Qeveria, do të kemi prapë një plan të tillë për një afat të caktuar kohor.

KRYETARI: Faleminderit!
Deputetja Gjylnaze Sylja, pyetje për ministrin e Arsimit, zotin Enver Hoxhaj.
Deputete, mund ta parashtroni pyetjen.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit!
Të nderuar deputetë,
Pyetja ime ka të bëjë me fenomenin e analfabetizmit në Kosovë, një fenomen shumë shqetësues, i cili më shumë është i përhapur në viset rurale dhe në mesin e vajzave të reja. Deri më tani, me këtë fenomen kryesisht janë marrë organizatat joqeveritare dhe mendoj se Ministria për Arsim, Shkencë dhe Teknologji duhet më shumë të përqendrohet në zgjidhjen e këtij problemi. Prandaj, zoti ministër, pyetja ime është se sa është niveli i analfabetizmit në Kosovë në mesin e të dy gjinive dhe grupmoshave, sa është zvogëluar vitin e fundit dhe kur do të zhduket? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Zoti ministër, e ke fjalën.

MINISTRI ENVER HOXHAI: I nderuar zoti Kryetar,
Zoti zëvendëskryeministër,
Të nderuar kolegë ministra,
Të respektuar deputetë,
E nderuara zonja deputete,
Realisht, për shifra dhe për statistikën në Kosovë është vështirë të flitet, kështu që unë do të synoj që të jem vërtet shumë direkt në përgjigje.

Ne, si Ministri e Arsimit nuk kemi shifra të sakta se sa njerëz janë të përfshirë nga fenomeni i analfabetizmit meqë dihet që në Kosovë nuk ka numërim të popullatës dhe është vështirë të konstatohet shifra e saktë. Ajo se çfarë mund t'ju them është se gjatë vitit 2008 dhe 2009 janë në përfshirje e sipër në programe të ndryshme rreth 1280 vetë dhe sidomos është fjala për gjininë femërore në zonat rurale.

Po ashtu, dua t'ju informoj që gjatë vitit 2008 kemi iniciuar një studim, i cili ka titull: - Drejt Lisbonës dhe merret me kategorinë e gjinisë femërore të femrës rurale dhe të shkallës së saj të analfabetizmit, studim i cili është prezantuar në vitin 2009 dhe ky do të shërbejë si një strategji në rrafshin afatshkurtër se si të eliminohet ky fenomen.

Dua, po ashtu, t'ju informoj që viti 2008 ka qenë i deklaruar si vit i gjithëpërfshirjes në arsim, prandaj kemi bërë përpjekje maksimale që t'i përfshijmë të gjithë në arsim. Mirëpo, e kemi edhe një situatë të tillë ku një pjesë e madhe e njerëzve të cilët sot ballafaqohen me fenomenin e mungesës së shkrim-leximit, i vuajnë pasojat e një kohe të kaluar, ku ne si Ministri e Arsimit nuk ballafaqohemi vetëm me fenomenin e atyre që janë në sistemin shkollor, por të atyre që nuk janë në sistemin shkollor.

Prandaj, për vitin 2010 prioritet do ta kemi arsimin tërë jetësor, do të ketë buxhet dhe zhdukja e fenomenit të analfabetizmit do të jetë prioritet mbi prioritetet meqë deri më tash, përveç Ligjit për arsimin për të rritur, nuk ka pasur një strategji. Ne, fillimisht e kemi hartuar strategjinë dhe tash jemi në eliminim e sipër të një fenomeni të tillë.

Dua vetëm t'ju informoj se sot zhdukja e analfabetizmit nuk është qëllim në vete, do të thotë nuk është vetëm ideja që njerëzit të mësojnë shkrim-lexim, por si të jenë të gatshëm që vërtet të involvohen në ekonominë e tregut. Prandaj, gjatë këtij vitit po punojmë që një pjesë e madhe e njerëzve jo vetëm ta mësojnë shkri-leximin, por të kualifikohen edhe për ekonomi të tregut.

KRYETARI: Faleminderit!

Deputete, ke pyetje shtesë? E keni fjalën, deputete Sylja.

GJYLNAZE SYLA: Zoti ministër, me Ligjin për arsimin fillor dhe të mesëm, arsimi i detyruar, neni 7 përfshin moshën prej 6 deri 15, pos kësaj në dispozitën ligjore 7.3 thuhet se MASHT-i mund të nxjerrë udhëzime për të parandaluar anomalitë që mund të lindin lidhur me kërkesat e arsimit të detyruar. A keni nxjerrë një udhëzim të tillë, a nuk mendoni se është ironike të flitet për qeverisjen elektronike ose për Silicon Valley, për teknologjinë më të avancuar në botë, derisa kemi njerëz që nuk dinë shkrim-lexim.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Një udhëzim i tillë administrativ është nxjerrë nga pararendësit në Ministrinë e Arsimit, nga ish ministrat, për çka i falënderoj për punën që e kanë bërë. Mirëpo, nëse flasim për fenomenin e braktisjes të nxënësve nga shkolla, ne i kemi aktualisht 1280 vetë që e kanë braktisur shkollën fillore dhe, realisht, ky është një shqetësim shumë i madh. Shqetësimet që i kemi ne si Ministri e Arsimit është që i kemi në Kosovë 1 milionë njerëz që janë pasojë e 100 vjetëve të fundit, që janë të pakualifikuar dhe unë synova që të jem shumë i saktë me statistika. Shqetësimi ynë është çfarë të bëjmë me ata të cilët s'kanë qenë asnjëherë pjesë e sistemit shkollor ose të cilët për shkak të okupimit, të situatës që e kemi pasur, në vitet '90 e kanë ndërprerë shkollimit dhe vetëm përmes arsimit tërë jetësor dhe arsimit për të rritur ne mund ta luftojmë këtë fenomen të tillë.

Sa i përket braktisjes dhe gjithëpërfshirjes, i kemi marrë të gjitha masat që në arsimin fillor realisht ta kemi një gjithëpërfshirje shumë më të lartë. Ndërsa, dua t'ju informoj që më 1 shtator të vitit 2010, arsimi i mesëm në Republikën e Kosovës do të jetë obligativ. Ne do ta sjellim Ligjin për arsimin fillor dhe të mesëm në Kuvendin e Kosovës dhe shpresoj që deputetët e Kuvendit të Kosovës do ta mbështesin iniciativën e Ministrisë që arsimi i mesëm të shndërrohet në arsim obligativ.

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputetja Donika Kadaj-Bujupi, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçin. Kryeministri nuk është këtu. Doni ta bëni pyetjen, deputete?

DONIKA KADAJ - BUJUPI: Kryetar, Kryeministri nuk është këtu, po është ministri Ahmet Shala dhe pyetja ime e radhës është për të, prandaj kërkoj që të vazhdohet më tutje në pyetjen e gjashtë dhe ta bëj pyetjen për ministrin Shala, pasi është këtu. Kam të drejtë?

KRYETARI: Keni të drejtë.

DONIKA KADAJ - BUJUPI: Faleminderit!

I nderuar ministër,

Organizata bujqësore “Dubrava” në Istog është privatizuar në kohën kur ju ishit nënkryetar i Bordit të AKM-së. Cilat asete dhe prona të “Dubravës” janë privatizuar, nga kush dhe a i ka përmbushur pronari i ri obligimet e marra me tender?

KRYETARI: Po, pyetjen e bëri, ministër, mendoj që mund t’i përgjigjeni. Administrata e Qeverisë ka faj, nuk di a Qeverisë apo e Ministrisë, por jo e Kuvendit.

MINISTRI AHMET SHALA: Çdo informacion për këtë mund ta merrni në Agjencionin Kosovar të Privatizimit, i cili është autoriteti i juaj, i kësaj dhome të nderuar, kështu që do t’ju kisha drejtuar që çdo pyetje në të ardhmen sa i përket kësaj, e merrni nga Agjensioni Kosovar i Privatizimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputete, ke pyetje shtesë? Urdhëro!

DONIKA KADAJ - BUJUPI: Po! I nderuar ministër, nuk mund t’i pastroni duart aq lehtë, sepse keni qenë përgjegjës për këtë çështje. Sot jeni ministër edhe ju i raportoni këtij Kuvendi. Prandaj, pyetja ju shtrohet juve dhe kërkoj që të më përgjigjeni me shkrim, pasi që sot nuk jeni i përgatitur.

KRYETARI: Sigurisht, ministri do ta ketë parasysh kërkesën tuaj.

Deputetja Edita Tahiri, pyetje për ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Zenun Pajaziti. Deputete, mund ta parashtroni pyetjen.

EDITA TAHIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përsëritet të gjithëve,

Çështja të cilën desha ta shtroj është se në Kosovë ende po lëshohen dokumente dhe pasaporta të Serbisë. Një nga këto zyra për shërbime të tilla thuhet se është prezente mu në afërsi të Prishtinës, në zonën industriale dhe sipas disa qytetarëve që janë ankuar, ai objekt është duke u ruajtur edhe nga Policia e Kosovës. Pyetja është: A jeni në dijeni për funksionimin e zyrave të tilla dhe kur do të ndërpritet kjo praktikë opstruktive për sovranitetin e shtetit të Kosovës?

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Policia e Kosovës ka evidencuar jo vetëm në regjionin e Prishtinës, por në gjithë territorin e Kosovës disa zyra të cilat janë të vendosura në lokalitetet ku graviton komuniteti i pakicës serbe, të cilat zyra lëshojnë dokumente të ndryshëm për qytetarë. Po ashtu, Policia e Kosovës ka identifikuar edhe një numër zyrash tjera që ofrojnë shërbime të ndryshme postare, shërbime të tjera që janë jo nga institucionet e Kosovës. Policia e Kosovës nuk është në shërbim të asnjë zyre të tillë në Kosovë. Përkundrazi, ne e kemi

alarmuar sidomos Komisionin Evropian për zyrat të cilat lëshojnë dokumente ose pranojnë aplikime për dokumente, pasaporta ose dokumente tjera të shtetit serb.

Institucionet e Kosovës i njohin vetëm dokumentet që lëshohen nga institucionet e Kosovës dhe të gjitha dokumentet e tjera që lëshohen në territorin e Kosovës janë dokumente jolegjitime dhe ne do të vazhdojmë t'i trajtojmë ashtu. Për sa i përket funksionimit të këtyre zyrave, ne po ashtu kemi alarmuar te partnerët tanë funksionimin e tyre. Siç e dini, ne përveç mundësisë së evidencimit dhe marrjes së informatave të sakta për funksionimin e këtyre zyrave, kemi kapacitete të mjaftueshme brenda policisë të pengojmë funksionimin e tyre brenda vetëm pak orësh, por ne nuk dëshirojmë që të bëjmë veprime të cilat mund të nxisin reagime të ndryshme politike. Gjithçka do të bëjmë me partnerët në mënyrë që të pamundësohet funksionimi i zyrave të cilat lëshojnë dokumente që nuk janë të institucioneve të Kosovës.

Po ashtu, ndërkohë ne po bëjmë gjithçka që t'i lëshojmë dokumentet tona dhe t'ju them me kënaqësi se është në rritje numri i qytetarëve serbë që kërkojnë dokumentet të gjendjes civile të Kosovës, edhe letërnjoftime, edhe pasaporta dhe patentshofer. Kohëve të fundit kemi shtuar zyrtarë tanë në disa lokalitete për t'iu dalë në ndihmë këtyre kërkesave të qytetarëve serbë dhe të qytetarëve tjerë pakicë dhe trendet janë shumë pozitive. Mendoj që qytetarët serbë nuk do të kenë nevojë së shpejti të marrin dokumente nga zyra tjera për shkak se legjitimiteti i dokumenteve tona secilën herë po rritet dhe lëvizja e tyre e lirë do të jetë shumë e kushtëzuar nga posedimi i dokumenteve legale të institucioneve të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Keni pyetje shtesë, deputete?

EDITA TAHIRI: Zoti ministër, Ministria e juaj është pjesë e ekzekutivit. Pra, Kosova ka qeveri, është organ ekzekutiv dhe ne kemi tashmë Kushtetutën e Kosovës, të cilën ky Parlament e ka miratuar. Si do të kishit definuar ju, në këtë rast, situatën në të cilën gjendet Ministria e Brendshme, kur brenda shtetit të Kosovës në mënyrë ilegale jepen pasaportat e një shteti tjetër, e aq më shumë që ka qenë okupator.

KRYETARI: Urdhëro, ministër!

MINISTRI ZENUN PAJAZITI: Më lejoni që t'ju them edhe njëherë që të gjitha zgjidhjet për telashet që i kemi në këtë fazë të hershme të pavarësisë, nuk do t'ju bëjmë të gjitha këtyre çështjeve vetëm zgjidhje policore. Përkundrazi, ne po pretendojmë që respektimin e ligjeve e të Kushtetutës ta sjellim në mënyrë normale për gjithë qytetarët. Secilën herë më shumë është në rritje numri i qytetarëve serbë që i respektojnë institucionet tona dhe, në këtë rast, edhe zyrat që lëshojnë dokumente civile dhe të tjera të shtetit të Kosovës. Jam i sigurt që ky trend është në rritje shumë të madhe, sidomos në këtë vit, dhe po ashtu jam i sigurt që do të bëjmë edhe veprime shumë shpejt edhe për ndalimin e veprimeve ilegale, çfarëdo qofshin ato, në territorin e Kosovës në përputhje me ligjet dhe kushtetutën tonë.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputeti Emrush Xhemajli, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala. Deputet, fjala është për ju.

EMRUSH XHEMAJLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përsëritje të gjithëve,

I respektuari ministër,

Pyetja ime ka të bëjë me privatizimin. Pak më herët thatë se ju nuk përziheni në këtë punë, por sipas Ligjit për ndërmarrjet publike, ju jeni anëtar i Komisionit për Privatizimin e Ndërmarrjeve Publike. Kështu që keni të bëni edhe mirë me këtë punë, por pyetja ime është kështu: Zyrtarë të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave në mënyrë të përsëritur janë duke thënë se është iniciuar procedura për privatizimin e PTK-së. Ku e keni bazuar nga pikëpamja ligjore fillimin e procedurave të privatizimit të PTK-së?

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën.

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar Kryetar,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuari deputet,

Janë dy procese të privatizimit që janë në Kosovë tani duke ecur dhe udhëhiqen nga dy institucione, nëse mund të them. Ndërmarrjet shoqërore vazhdojnë dhe do vazhdojnë të privatizohen nën autoritetin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit, që është autoritet i vetëm i përzgjedhur, e që i përgjigjet këtij Parlamenti për ndërmarrjet shoqërore, qoftë procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, qoftë procesin e likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore.

Ndërmarrjet publike nga 15 qershori, përkatësisht nga dita e hyrjes në fuqi, kalojnë në kompetencë të Qeverisë së Kosovës, të udhëhequr nga një grup ndërministror, prej 5 anëtarëve, që kryesohet nga ministri i Ekonomisë dhe Financave. Ky grup ndërministror i ka propozuar Qeverisë së Kosovës që të fillojnë procedurat për privatizimin e Postës, të KEK-ut dhe për koncesionimin, përkatësisht partneritetin publiko-privat me Aeroportin, që është në kuadër të kompetencave konform Ligjit mbi ndërmarrjet publike. Mund të shtrohen debate se a duhet ligj i veçantë për këtë, apo s'duhet ligj i veçantë. Ne konsiderojmë dhe e kam dhënë edhe një përgjigje, që me Kushtetutë të Republikës së Kosovës dhe me Ligjin mbi ndërmarrjet publike, Qeveria e Kosovës përmes një tenderi ndërkombëtar dhe me propozimin e Grupit ndërministror, ka të drejtë të fillojë procedurat për privatizimin e ndërmarrjeve publike, të të gjithave. Për t'u angazhuar që të bëjë në mënyrë sa më profesionale këtë çështje, Qeveria e Kosovës ka aprovuar, natyrisht, pas propozimit të Grupit ndërministror, ndërmarrje konsulente. Tenderi për ndërmarrjen konsulente për udhëheqjen e privatizimit të Postës ende nuk është hapur, do të hapet këto ditë, ndërsa tenderi për grupin konsulent për KEK-un është në proces e sipër të vlerësimit të ofertave.

Pra, ekziston baza ligjore në Ligjin mbi ndërmarrjet publike, i cili jep mundësi, ai ligj është aprovuar në këtë Parlament, i jep mundësi Qeverisë së Kosovës që të përmbyllë procesin e privatizimit të ndërmarrjeve publike në bazë të këtij ligji. Është i konsultuar ky ligj edhe me institucionet ndërkombëtare dhe besoj që baza ligjore ekziston. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputet, ke pyetje shtesë?

EMRUSH XHEMAJLI: Po. Në Kuvendin e Kosovës është marrë leja për fillimin e procedurave për privatizimin e rrjetit dhe të shpërndarjes. Fjala është për KEK-un, po asnjëherë nuk është bërë fjalë për të gjitha llojet e privatizimit të ndërmarrjeve publike aty,

me një leje të vetme. Për secilin ndërmarrje veç e veç merret leje nga Kuvendi dhe kjo nuk është bërë në Kuvendin e Kosovës lidhur me Postën, për PTK-në është fjala, kështu që sipas Ligjit për ndërmarrjet publike, konkretisht neni 9 i këtij ligji, e ndalon këtë formë qysh e keni praktikuar, do me thënë që paushall të shkohet në këtë formë. Duhet veç e veç të punohet, sepse neni 3.1 thotë qartë se ndërmarrjet publike qendrore janë pronë e Republikës së Kosovës dhe dihet mirë se si funksionon krejt kjo.

KRYETARI: Regjia, ia vazhdoni fjalën edhe 30 sekonda.

EMRUSH XHEMAJLI: Në ligj thuhet, neni 9, se aksionet në një ndërmarrje qendrore publike mund të shiten nga Qeveria, mund të shiten, por me kusht që ky vendim të miratohet me shumicë të thjeshtë votash në Kuvendin e Kosovës. Ju lutem, t'i interpretoni drejt gjërat. Ju keni kërkuar leje për fillimin e procedurave të privatizimit në KEK, kjo është kryer, por nuk është marrë leje për fillimin e procedimit për ndërmarrjet e tjera publike.

KRYETARI: Faleminderit, deputet Xhemajli!
Ministër, e keni fjalën.

MINISTRI AHMET SHALA: Konsideroj, deputet Xhemajli, që jemi komplet në të njëjtën valë. Neni 9 e thotë dhe ne jemi të detyruar të vijmë ta aprovojmë ose të marrim leje në një fazë të caktuar në të cilën jemi të përgatitur për t'ju ofruar diçka. Kompania konsulente ende nuk është përzgjedhur dhe ne ende nuk i kemi përzgjedhur modalitetet se si ta privatizojmë Postën. Në momentin kur ne i kemi modalitetet e qarta, do të vijmë në këtë Parlament konfrom nenit 9 dhe të marrim, natyrisht, aprovimin tuaj, të cilin jam i sigurt që ju do ta shqyrtoni me shumë kujdes.

Gjatë procesit do të kemi konsultime me grupe parlamentare dhe me ekspertë të tjerë dhe nuk do të bëhet asgjë pa aprovimin e këtij parlamenti. Shumë e qartë.

KRYETARI: Vazhdojmë! Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin e Ekonomisë, zotin Ahmet Shala, apo për ministrin e Tregtisë, zotin Lutfi Zharku. Po kërkon, njëri prej tyre të përgjigjet. Mirë, vazhdoni pyetjen.

RIZA SMAKA: Faleminderit, zotëri Kryetar!

Të nderuar ministra dhe deputetë,

I nderuar ministër Shala,

Në Kosovë kemi një numër të konsiderueshëm të shoqërive aksionare. Në radhë të parë, bankat janë shoqëri aksionare me përgjegjësi të kufizuar edhe transaksionet biznesore në këto organizata biznesore kryekëput bëhen, do të duhej të bëheshin nëpërmjet indosanenteve dhe të këtyre letrave komerciale. Ato do të duhej të bëheshin në bursë. Kosova nuk ka bursë, ka mund të ketë bursë edhe mund të ketë bursë, asnjë problem juridikë jo se jo, as politik, as teknik, nuk ka ekzistuar, nuk ekziston si pengesë. Vetëm projektligji të miratohej këtu, të bëhej ligj edhe të mundësohej. Pa transaksione të letrave komerciale, nuk ka ekonomi të tregut. Pa ekonomi të tregut, s'ka sistem ekonomik valid. Ju pyes zoti ministër...

KRYETARI: Ahmet, cili po e merrni fjalën, cili ministër po e merr fjalën? Mirë, Ahmet. Urdhëro, zoti Shala.

MINISTRI AHMET SHALA:

I nderuari profesor, i nderuari deputet Smaka, sigurisht që ekzistimi i një burse, përkatësisht i një vendi në të cilin bëhet shitblerja e aksioneve, është një punë e cila do të ndodhë në Kosovë një ditë. Legjislacioni përkatës, zhvillimi ekonomik i Kosovës dhe infrastruktura ligjore ende nuk është në një fazë të pjekurisë, nëse mund të them, legjislative dhe administrative për të udhëhequr një bursë. Bursat në regjion shihet që kanë pësuar goxha ndryshime dhe mbase në këtë situatë të krizës ekonomike mbase ka qenë edhe fat që nuk është krijuar ndoshta një bursë e tillë në Kosovë.

Kapacitetet, qofshin administrative, qofshin legjislative, qoftë zhvillimi ekonomik në Kosovë, konsideroj ende është në një fazë initiale për të qenë një bursë konkurrencte që atrakton letra me vlerë për transaksione.

Sigurisht që Banka Qendrore e Kosovës, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, në konsultim të përhershëm edhe me biznesin dhe me institucionet përkatëse do të zhvillojë strategjinë e vet për të zgjedhur momentin e duhur për përgatitjen e një legjislacioni që do ta krijojë edhe këtë mundësi. Se a do të mbijetojë ajo, a s' do të mbijetojë, varet nga shumë rrethana tjera për të cilat jam i sigurt që ju keni mjaft njohuri. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputet, ke pyetje shtesë?

RIZA SMAKA: Veç një pasazh, se sa është bursa e rëndësishme. Kur është themeluar bursa e Nju Jorkut, një ven, një sit ka kushtuar 5 dollarë, aktualisht kushton 1 milion dollarë, ani pse Brokëri nuk ka kohë brenda 12 orëve të ulet 5 minuta. Prandaj, unë apeloj që të përgatitet projektligji, sepse mund të bëhet ajo punë edhe duhet të bëhet. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Zoti ministër, a do të përgjigjesh? Në rregull, mirë. Vazhdojmë. Deputetja Kosara Nikoliq, pyetje për ministrin e Bujqësisë, të Pylltarisë dhe të Zhvillimit Rural, zotin Idriz Vehapi. Deputete, mund ta parashtroni pyetjen.

KOSARA NIKOLIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče, Poštovani ministre, Obraćam vam se prvenstveno u ime manjinskih zajednica, a pitanje obuhvata i sve građane Kosova koji se bave poljoprivredom. Šta Ministarstvo za poljoprivredu, šumarstvo i razvoj svela preduzima u vezi prolećne setve, koja je na pragu i kako misli da pomogne poljoprivrednicima za seme i đubriva, kada u budžetu za 2009. godinu nema subvencija za to, a poznato je koliko stanovnika Kosova isključivo preživljava samo od onoga što stavi u ambare. Hvala!

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI IDRIZ VEHAPI: I nderuar zoti Kryetar, Kabinet qeveritar, Të nderuar deputetë, E nderuara deputete, Është e vërtetë se në buxhetin e Kosovës për pagesa direkte, mjete nuk janë shumë të ndara. Ndërkaq, për informimin tuaj, me kërkesë të Ministrisë së Bujqësisë vazhdojnë të mbesin të liruara nga TVSH-ja dhe doganat të gjitha imputet bujqësore, plehërat, farërat, mekanizmi bujqësor, do me thënë të gjitha këto janë të liruara prej doganave dhe TVSH-së.

Ndërkaq, vendet në regjion paguajnë për sipërfaqe tokës së mbjellë, sepse ndërhyrja direkte në çmimet e farërave dhe të plehrave pasi që këto tani importohen prej kompanive private, është vërtet problem për t'u realizuar në aspektin teknik, sepse edhe mundësitë për keqpërdorime pastaj janë shumë të mëdha. Ndërkaq, ne në të ardhmen duhet të veprojmë sikurse vendet në regjion. Për momentin, si ministri mjetet të cilat i kemi për pagesa direkte, i orientojmë në mbjelljen e kulturave shumëvjeçare. Mendojmë se në aspektin ekonomik leverdia është më e madhe. Kjo është përgjigja ime për pyetjen tuaj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputete, ke pyetje shtesë?

KOSARA NIKOLIĆ: Hvala, gospodine ministre!

Ja razumem to što ste vi izneli, ali smatram da ipak na skupoću koja je iparitet i koja se odnosi između žitarica i đubriva da se ipak mora imati razumevanja na individualne poljoprivredne proizvođača i pomoći im na takav način. Jer, mnogo je bitno koliko će tih žitarica staviti u hambare od kojih celo stanovništvo Kosova živi.

KRYETARI: Deputete, faleminderit për pyetjen dhe nënpyetjen.

Ministër, ke përgjigje në pyetjen shtesë ose koment. Mirë, faleminderit!

Vazhdojmë. Deputetja Kaqusha Jashari, pyetje për ministrin e Arsimit, zotin Enver Hoxhaj. Deputete, mund ta bëni pyetjen.

KAQUSHA JASHARI: Faleminderit!

Kjo pyetje ka qenë e seancës së kaluar, por ministri nuk ka qenë këtu.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka sjellë vendimin për akademikë, mësimdhënës në Universitetin e Prishtinës, që kanë mbushur moshën 65 vjeçare, që t'ju vazhdohet kontrata e punës deri në përfundimin e vitit akademik. Kjo strukturë është në pritje të vazhdohet kontrata deri në moshën 70 vjeçare. Pyetja për ministrin është: A ekziston propozimi konkret nga Ministria ose Qeveria që kjo çështje të rregullohet me ligj?

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit!

I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar deputetë,

E nderuara zonja deputete Jashari,

Dua t'ju informoj që vitin e kaluar, në mbledhje të Qeverisë, Ministria e Arsimit ka kërkuar nga Qeveria që të mbështetet qëndrimi, jo vendimi, po të mbështetet qëndrimi që koha e pensionimit të profesorëve në Universitet të Prishtinës të jetë mosha 70 vjeçare dhe një qëndrim i tillë është miratuar në mbledhje të Qeverisë.

Së dyti, ky qëndrim është propozuar që të integrohet në Ligjin për shërbyesit civilë që e kemi. Gjatë javës së ardhshme do të vjen në Qeveri e mandej nga Qeveria do të vjen në Kuvend të Kosovës dhe i lus deputetët e Kuvendit të Kosovës që ta mbështesin një iniciativë të tillë.

Së treti, ligji parasheh që mësimdhënësit e të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës në arsimin fillor, në arsimin e mesën dhe në arsimin e lartë të mos jenë shërbyes civilë, po të jenë nëpunës shtetërorë profesionalë, si është edhe në vende të tjera dhe besoj që një gjë e tillë do të mbështetet edhe nga vetë Kuvendi i Kosovës. Do të thotë, ne si Ministri e

Arsimit e kemi bërë punën tonë dhe besoj që Kuvendi i Kosovës do ta mbështetë një iniciativë të tillë.

Po ashtu, dua t'ju informoj që ky qëndrim që është prezantuar në Qeveri, i është përcjellë edhe Universitetit të Prishtinës për mos pensionimin e atyre të cilët i mbushin 65 vjet ose i kanë mbushur 65 vjet deri sa të miratohet ligji në Kuvendin e Kosovës.

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shtesë? Jo. faleminderit!
Deputetja Njomza Emini, pyetje për ministrin e Arsimit, zotin Enver Hoxhaj.

NJOMZA EMINI: Faleminderit, Kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Kabinet qeveritar,

Si dhe kolegë deputetë,

Çështja: Në shkollimin fillor dhe të mesëm hallkat e dokumenteve kyçe që hyjnë në punën e mësimdhënies dhe mësimnxënies plan-programet, standardet dhe tekstet shkollore nuk janë funksionale. Atëherë, pyetja është kjo: Çfarë ka ndërmarrë konkretisht Ministria e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë për rishikimin e plan-programeve, të standardeve dhe të teksteve shkollore në nivelin e ulët, të mesëm dhe të lartë. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit!

I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar deputetë,

E nderuara zonja deputete,

Ju falënderoj për një pyetje të tillë. Dua t'ju informoj që viti 2009 është i definuar për Ministrinë e Arsimit si vit i cilësisë dhe kemi tri prioritete kryesore. Prioriteti i parë, rishikimi i Kurrikulës ose i plan-programeve, i dyti është rikualifikimi i arsimtarëve dhe zhvillimi profesional i mësimdhënësve në nivelin fillor dhe të mesëm dhe, së treti, është vendosja e standardeve të reja për tekstet shkollore, të cilën gjë veçse e kemi përfunduar, ekziston vetëm një dokument i gatshëm për atë se çfarë standarde duhet të përdoren me rastin e shkrimit të teksteve shkollore.

Kur është fjala tek Kurrikula ose plan-programet, në gjuhën shqipe përdoren të dy nocionet. Dua t'ju informoj që e kemi themeluar Këshillin shtetëror për Kurrikulë dhe standarde dhe vlerësim, i cili është duke bërë punën e tij. Po ashtu, gjatë këtij viti do të përfundojë procesi i rishikimit të kornizës së Kurrikulit të Kosovës dhe përveç kornizës duhet të përfundojë edhe procesi i rishikimit të plan-programeve tematike për secilën lëndë veç e veç. Dua vetëm të reflektoj para jush tri qëndrimet e Ministrisë që duhet të merren parasysh nga ekspertët gjatë kësaj kohe.

Nën një, sugjerimi jonë i parë është që të kemi shkolla të integruara. Sot debati është në botë se si nxënësit të mos jenë të mbingarkuar me lëndë të shumta, mos t'i kenë 15 lëndë, 17 lëndë.

Së dyti, ne mendojmë që për arsimin bazik përparësi duhet t'iu jepet gjuhëve dhe matematikës, e që shumica e profesioneve burojnë nga gjuhët dhe matematika. Po ashtu, të fillohet me mësimin e gjuhës angleze nga viti 2010, nga 1 shtatori, nga klasa e parë.

Dhe së treti, kur është fjala tek shkolla e mesme, qëndrimi ynë si Ministri është që të kemi plan-programe fleksibile, meqë sot nuk dihet se kush çfarë profesion do të ushtron në të ardhme, do të thotë gjimnazet të kenë lëndë nga shkollat profesionale dhe shkollat profesionale të kenë lëndë nga gjimnazet ose nga shkollat e përgjithshme. Në rastin konkret, kjo i bien sa më shumë gjuhë në shkollat e mesme profesionale, sa më shumë IT në shkollat e përgjithshme.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Deputete, ke pyetje shtesë?
Fjalën e ka deputetja Njomza Emini.

NJOMZA EMINI: Faleminderit! Ministër, ju i shpjeguat tri qëndrime që i keni, mirëpo në shumicën e shkollave të nivelit të ulët dhe të mesëm, do të thotë, janë në shpërputhje dhe jo funksionale në pikëpamje të objektivave dhe të qëllimeve që nxënësit do t'i arrinin në fund të çdo viti shkollor. Dihet se maturën, do të thotë, nxënësit më shumë se gjysma e atyre nuk kanë arritur ta kalojnë testin e maturës. Atëherë, ku qëndron problemi, te mësimdhënia apo te nxënësit.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Mendoj që sa i përket plan-programeve dhe provimit të maturës, definitivisht rezultati i provimit të maturës mund të jetë edhe pasqyrim i asaj se sa zbatohen plan-programet në shkollat tona. Mirëpo, dua t'ju informoj që shumica e nxënësve të cilët nuk kanë qenë në gjendje ta kalojnë provimin e maturës, kanë qenë zakonisht nga shkollat profesionale. Gjendja në shkollat profesionale në Republikën e Kosovës ka qenë që s'ka pasur fare plan-programe. Tek në vitin 2008 kemi arritur që t'i zhvillojmë plan-programet e para për këto shkolla dhe unë besoj që sivjet rezultati do të jetë shumë më i mirë.

Po ashtu, dua t'ju informoj edhe sa i përket pragut të dhënies së provimit të maturës. Ju e dini që vitin e kaluar ne e kemi kaluar Ligjin për maturë dhe pragu i maturës në Kosovë është 50 pyetje nga 100 pyetje përderisa në vendet e rajonit është 35 – 40 pyetje. Kjo flet që realisht sistemi ynë operon me standarde evropiane. Kuptohet që shpeshherë nxënësit mund ta paguajnë një çmim të tillë, por ne jemi shumë të përkushtuar që testi kombëtar i maturës të jetë një instrument i vlerësimit të jashtëm të nxënësve dhe t'i mobilizojë nxënësit për mësimdhënie sa më efektive.

Plan-programet janë një pjesë e përgjigjes, mirëpo çështja e maturës është më komplekse se sa duket. Dua, po ashtu, t'ju informoj që në arsimin e lartë kemi procesin e akreditimit, i cili është po ashtu vlerësim i jashtëm. Ndërsa, në vitin 2010 do të dalim me profesione të rregulluara, që duhet të ketë provime shtetërore për profesione të caktuara që duhet të ushtrohen në Kosovë, për shembull, për kontabilistë, për avokat dhe për të tjerë, po janë çështje të cilat do t'i definojmë përmes ligjeve që do të vinë në Kuvend të Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit!
Deputeti Zafir Berisha, pyetje për ministrin e Kulturës, të Rinisë dhe të Sporteve, zotin Valton Beqiri. Ministri nuk është këtu. Doni ta lexoni pyetjen? Mirë, faleminderit!
Kalojmë, atëherë. Pyetja e fundit, edhe pse pak përtej kohe, po deputetin Driton Talin s'mund ta lëmë pa bërë pyetje. Pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Athmet Shala.

DRITON TALIN: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë do ta citoj Ligjin për ndërmarrjet publike në pyetjen time, se po shihet që ministri nuk e ka lexuar. E pamë këtë edhe në pyetjen e deputetit Rustemaj dhe të deputetit Xhemajli, sidoqoftë.

Çështja: Sipas Ligjit për ndërmarrjet publike të gjitha ndërmarrjet publike duhet të përgatisin, të miratojnë dhe të zbatojnë një kod të detyrueshëm të etikës dhe qeverisjes korporative. Ky është neni 35, zoti ministër, nëse s'e ke lexuar Ligjin për ndërmarrjet publike.

Pyetje: A është realizuar ky obligim ligjor nga ana e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe ndërmarrjeve publike, sepse deri më tani, të paktën, nuk e keni publikuar as në Web-faqen e ndërmarrjeve publike, por as të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave. T'i lehtësova pak mundimet. Nëse jo, pse jo, duke marrë parasysh mënyrën se si qeverisen ndërmarrjet publike. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, a e keni kuptuar pyetjen, se ai nuk bëri pyetje, bëri ligj, po megjithatë, urdhëro!

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, Driton, për citimin e nenit 35. Sigurisht që procesi i menaxhimit të ndërmarrjeve publike është jo i lehtë dhe kushdo që pretendon të kuptojë që ai proces i lehtë, konsideroj që mashtrohet. Gjithsesi, konsideroj që hapa përmirësimi janë bërë, dhe se njësia që tani është në formim e sipër, ka vetëm 5 veta për monitorim. Ne me ligj kemi kërkuar të kemi 12 dhe besoj që me..., po përpiqemi të bëjmë gjithçka që është e mundur që ndërmarrjet publike t'i respektojnë kodet dhe ligjet. Sigurisht, për çdo mospërputhje me ligjin, ndërmarrjet publike udhëhiqen nga një bord dhe ai bord është përgjegjës para ligjit së bashku me ekzekutivin.

Sa i përket Web-sajtit, nëse e kuptova pyetjen tënde mirë, jemi në proces të..., sepse ekziston një ndërmarrje publike, në fakt, por e cila është në përmirësim e sipër. Se kualiteti i saj është në nivel të duhur apo jo, mund të debatojmë sa të duash. Është në proces të përmirësimit, besoj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Deputet ke pyetje shtesë.

DRITON TALI: Zoti ministër,
Sinqerisht, lexoj ligjet, lexoj obligimet të cilat dalin nga ligjet, se kështu me të vërtetë nuk ka kuptim. Ti nuk u përgjigje në pyetje. Ligji për ndërmarrjet publike, neni 35.1, ta lexova, neni 35.4 në mënyrë decisive thotë: Ministria është e autorizuar..., Ministria nënkuptohet MEF-i (Ministria e Ekonomisë dhe Financave) dhe ka detyrim për të shpallur një model të kodit të etikës dhe qeverisjes korporative për shfrytëzim nga ndërmarrjet publike dhe secila NP duhet, do me thanë ndërmarrje publike, të sigurojë që kodi i saj të jetë në përputhje me këtë model, e të tjera, e të tjera. Pra, është obligim dhe ky ligj ka hy në fuqi, siç e dini, më 15 qershor 2008. Do të thotë nuk kemi një muaj, por është rreth 1 vit. Prandaj, kjo s'do mend se s'ke kod të etikës dhe qeverisjes korporative andaj KEK-u nënshkruan marrëveshje me Kompaninë e Vojin Lazareviqit (bashkëpunëtorit të ngushtë të Radovan Karaxhiqit) dhe Damir Fazliqit të famshëm, dhe hyhet atje në biznese të pista apo të dyshimta, për shkak se s'ke kod të etikës dhe të qeverisjes korporative me të cilën t'i do mund të kontrollosh ...

KRYETARI: Urdhëro, ministër!

MINISTRI AHMET SHALA: Tash e kuptova pyetjen në fakt, sepse në fillim ishe shumë i paqartë. Kodin e etikës e kanë të gjitha ndërmarrjet dhe ua kemi dërguar. Faleminderit shumë!

(Reagime të deputetit Tali: nuk është e vërtetë, kjo që po thoni është dezinformatë, ju lutem mos e dezinformoni opinionin ministër... mos i dezinformoni qytetarët se nuk ...)

KRYETARI: Deputet, të lutem, e ke bërë edhe pyetjen shtesë, nuk kemi debat. E përfunduam pyetjen. I nderuar deputet, e ke bërë pyetjen, e ke bërë pyetjen shtesë dhe një pyetje e përgjigje, s'ka më shumë. Debat nuk është. Nëse doni të bëni debat, bëni kërkesën për debat. Nëse doni mocion, bëni kërkesën për mocion. Këto kanë qenë pyetje dhe pyetjet e kanë kohën e caktuar. Faleminderit!

Kalojmë në pikën e tretë. Por, para se të kalojmë në pikën e tretë, është mirë që për shkak të numrit të madh të pyetjeve, pyetjet që janë të muajit mars, të kalojnë në botim, kurse pyetjet e muajit prill të mbesin për seancën e radhës. Ju e dini se koha për pyetje parlamentare është 50 minuta. Për 50 minuta kanë mundësi më së shumti të shkojnë me rregull 15 – 20 pyetje më së shumti. Ju e dini se kësaj radhe i kemi 47 pyetje.

Pika e tretë e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 2004/50 për veprimtarinë private në shëndetësi

Komisioni për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie Sociale, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës së Kuvendit ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për veprimtarinë private në shëndetësi.

Komisioni ka hartuar raportin dhe ka rekomanduar që i njëjti të shqyrtohet në seancën plenare.

Radha e diskutuesve është, kryetari i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, zoti Sadik Idriz e ka fjalën.

SADIK IDRIZ: Hvala, predsedniče!

Poštovani poslanici,

Članovi kabineta,

Govoriću u ime Komisije, a istovremeno i u ime Grupe „7+“.

Komisija za zdravstvo, rad i socijalno staranje je u skladu sa članom 53. Poslovnika o radu Skupštine Republike Kosovo izvršila nadgledanje sprovođenja Zakona o privatnoj delatnosti u zdravstvu L-2004/50. Cilj ovog nadgledanja je bio da se utvrdi nivo sprovođenja ovog zakona u praksi bazirajući se na podatke dobijene sa terena i utvrdi koliko Vlada, odnosno Ministarstvo zdravstva ispunjava obaveze koje proizilaze iz Zakona o privatnoj delatnosti u zdravstvu.

Znamo da je zdravstveni sektor jedan od najznačajnijih oblasti za svako društvo. Kosovo se nalazi u fazi tranzicije i suočava se sa posebnim poteškoćama i čini napore za uspostavljanje jednog zdravstvenog sistema koji ispunjava potrebe građana.

Privatna zdravstvena delatnost je jedna značajna zdravstvena grana na Kosovu i čini ogromne napore kako bi tranzicija u tom sektoru bila što uspešnija.

Komisija je nakon višemesečnog rada pripremila izveštaj koji izražava ocenu sprovođenja pomenutog zakona, uključujući preporuke i mere koje je potrebno preduzeti. Mislim da je Komisija uradila jedan veoma kvalitetan izveštaj, koji je bio dostupan svim poslanicima.

Takođe, članovi komisije će u okviru svojih parlamentarnih grupa dati svoj doprinos objašnjenju ovog izveštaja.

Komisija je imala svoju metodologiju rada. Najpre je formirala radnu grupu u sastavu: Qamile Morina, kao izvestilac, te članovi: Armend Zemaj, Rita Hajzeraj, Mimoza Ahmetaj i Gjylnaze Syla. Mislim da je to bila jedna Komisija sastavljena gotovo od svih parlamentarnih grupa i da je dala svoj doprinos.

U periodu juli 2008 - februar 2009. godine, Radna grupa je obavila mnoge posete na terenu kako bi se upoznala sa realizacijom i sprovođenjem ovog zakona. Nakon toga, Komisija je organizovala javnu debatu kako bi dobila što više informacija od svih zainteresovanih strana.

Ovom prilikom se zahvaljujem svim članovima komisije, a posebno članovima Radne grupe koji su dali doprinos da se kvalitetnije obavi zadatak koji im je bilo poveren.

U svim fazama procesa monitorisanja, Radna grupa je imala podršku od strane Nacionalnog Demokratskog Instituta NDI, na čemu se takođe zahvaljujem. Zahvaljujem se i osoblju za podršku Komisije na stručnoj i tehničkoj podršci.

U međuvremenu je Ministarstvo zdravstva dostavilo svoje komentare, koje će Komisija svakako uzeti u razmatranje u daljim aktivnostima.

Komisija je na osnovu poseta na terenu, kojih je bilo više, takođe na osnovu kontakata sa privatnim institucijama nije mogla da obidje sve normalno, i nakon debate donela svoje zaključke, takodje je dala i svoje preporuke koje će biti upućene Vladi, odnosno Ministarstva zdravlja.

Radna grupa je postigla da prikupi dovoljno podataka o nivou sprovođenja zakona, na osnovu analiza sa poseta na terenu. Radna grupa je procenila nivo sprovođenja zakona, identifikovala je probleme i predložila je u formi preporuka konkretne mere koje treba da se preduzmu radi izmene stanja. U izveštaju su dati zaključci i preporuke, koje jasno ne bi trebalo možda da pročitam. Pozivam da se ovaj Izveštaj prihvati, a ostali članovi Komisije da daju svoj doprinos u toku rada. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka ministri i Shëndetësisë, zoti Alush Gashi.

ALUSH GASHI: I nderuar, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë, ministra,

I nderuar zoti kryetar i komisionit,

I nderuar raportues i ardhshëm,

Ju përgëzoj për përzgjedhje të kujdesshme të ligjit për monitorim. Ju falënderoj për qasjen konstruktive gjatë procesit të mbikëqyrjes. Në veçanti ju jemi mirënjohës për rekomandimet e dhëna të cilat, ndërkohë i kemi funksionalizuar.

Falënderoj anëtarët e Komisionit për Shëndetësi, të cilët me pyetje, dëshmi publike, debat plenar dhe vizita, kanë mbështetur Ministrinë e Shëndetësisë në reforma të filluara, të cilat janë të thella, marrin kohë dhe kërkojnë konsensus nacional.

Lidhur me raportin e komisionit funksional, ashtu siç thatë edhe ju, zoti kryetar i komisionit, Ministria e Shëndetësisë i ka dhënë komentet e veta në çdo pikë dhe lus Kuvendin që këtë material, i cili u është shpërndarë të gjithë deputetëve, ta radhisë në transkriptin e këtij raportimi të seancës së sotme.

Me këtë rast, theksoj rëndësinë e bashkëbisedimit që kemi pasur me Komisionin për Shëndetësi para një jave lidhur me këtë raport, si dhe shumë çështje tjera, me të cilat ballafaqohet shëndetësia e Republikës së vendit tonë.

Zbatimi i Ligjit për veprimtarinë private shëndetësore ka qenë një prej prioriteteve të Ministrisë së Shëndetësisë që nga fillimi i mandatit. Edhe përkundër vështirësive të ndryshme, kemi arritur rezultate të cilat nuk kontestohen as nga kundërshtarët politikë. Kemi arritur që aplikuesit të mos presin më shumë seç është paraparë me ligj për vlerësim dhe kemi arritur që këtë proces ta përmbyllim në tërësi.

Gjatë kësaj pune intensive dhe dialogut me të gjitha palët, kemi ardhur në përfundim se Ligji për veprimtarinë private në shëndetësi duhet të rihartohet dhe këtë e kemi bërë me dokumentin që ia kemi dërguar Kuvendit për agjendën legjislative të vitit 2009, andaj ky ligj në Kuvendin e Republikës do të plotësohet.

Më lejoni me këtë rast vetëm ta ritheksoj rëndësinë e reformave legjislative në shëndetësi. Kemi filluar reformat dhe në këtë vit do t'ua sjellim:

- Projektligjin për plotësim dhe ndryshim të Ligjit për duhanin;
- Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për produktet medicinale;
- Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për shëndetësi;
- Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për sigurime shëndetësore;
- Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veprimtari private në shëndetësi.

Pra, kështu me radhë, si dhe 11 udhëzime administrative për çështjet në fjalë. Por, lidhur me raportin, Ligji për veprimtarinë private shëndetësore është në agjendën legjislative për vitin 2009, grupi punues është duke punuar dhe Kuvendi do ta ketë me kohë.

Ligji për veprimtarinë private në shëndetësi, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës në shtator të vitit 2004, në përgjithësi ka kontribuar në konsolidimin e veprimtarisë private, si dhe në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore. Duke qenë të ndërgjegjshëm gjithnjë që në vendin tonë ky ka qenë fillim i ndërtimit të institucioneve private shëndetësore dhe si një fillim, ministrat e mëparshëm, Qeveria dhe Kuvendi kanë pasur vështirësi në fillim të një procesi. Kemi gjetur shumë institucione të cilat kanë qenë të palicencuara, të cilat kanë pritur me vite për të bërë vlerësimin dhe gjatë kësaj kohe kemi arritur që këtë proces, në këtë fazë ta përmbyllim dhe ai që aplikon, nuk pret më gjatë seç është e paraparë me ligj, e ligji thotë që të ketë përgjigje për vlerësim brenda 30 ditësh.

Deri më tani ju e keni në raport dhe komente, kanë aplikuar më tepër se 850 institucione private shëndetësore. Pasi që të gjitha të dhënat lidhur me këtë raport, të cilin e çmojmë shumë, sjell raportin, rekomandimet e legjislacionit të mëparshëm, të cilët i kam gjetur në Ministrinë e Shëndetësisë në fazën përfundimtare të zbatimit të tyre, janë shumë të mirëseardhura për Ministrinë e Shëndetësisë, sepse përmirësojnë gjendjen shëndetësore të qytetarëve të vendit tonë.

Më lejoni që shkurtimisht vetëm t'i theksoj disa elemente, të cilat kanë krijuar dhe krijojnë vështirësi në punën e përditshme. Ushtrimi i njëkohshëm i veprimtarisë private dhe shëndetësore, veprimtarisë shëndetësore publike dhe asaj private për profesionistët, me të vërtetë është bërë problem. Mu për atë, në agjendën legjislative të këtij viti do t'ua sjellim Ligjin për shëndetësinë dhe Ligjin për praksën, veprimtarinë private. Të dy grupet janë duke punuar krahas, sepse ka ide, që ndoshta Kuvendit këto dy projektligje t'i ofrohen si një ligj për shëndetësi. Se si do të vendoset, a do të vazhdohet në këtë formë, bie fjala që një drejtor i një institucioni publik të jetë drejtor i institucionit privat të njëjtës lëmi, që në kohën kur ai duhet të jetë në spital, se ka kontratë me orar të plotë të punës, ai është në sallën e Kuvendit se ka kontratë të plotë me Kuvendin. Në kohën kur ai duhet të jetë në institucionin publik, ai gjendet duke punuar në institucionin privat dhe shumë e shumë çështje tjera, shpresojmë se përgjigjen më të mirë do ta japë Kuvendi.

Për të gjitha këto çështje të cilat shpesh janë të pakuptueshme për qytetarët e vendit, se si është e mundshme që në të njëjtën kohë të jetë në dy vende, ligjet aktuale mundësojnë që gjysmë orari të punës ta kenë në institucionin privat.

Kësaj radhe ndoshta nuk është mirë të merremi me emra konkretë të të cilët gjatë inspektimeve të atyre profesionistëve shumë të nderuar, në institucionet e tyre private kemi gjetur produkte të institucioneve publike. Janë vështirësitë që, në ditën kur fillon punën një aparaturë të cilën e kemi pritur një kohë të gjatë, ajo pas një jave pëson defekte, por aparatura e të njëjtit profesionist në institucionin e tij privat funksionon, e kështu me radhë. Pra, këto janë çështje për të cilat ne e kemi filluar një debat të qetë në kuadër të institucioneve shëndetësore. Debatin e kemi iniciuar edhe në Komisionin Parlamentar për Shëndetësi dhe së shpejti do ta zgjerojmë edhe te Shoqëria Civile dhe qytetarët e vendit. Është çështje se si do të vendosë Kuvendi.

Vendet fqinje kanë bërë ndarjen në mes të institucioneve private dhe publike. Vendi ynë duhet të vendosë gjatë këtij viti për këtë çështje. Një prej problemeve tjera lidhur me zbatimin e Ligjit, i cili ka shumë mangësi dhe mu për atë jemi duke e përgatitur ligjin e ri të cilin do ta sjellim në Kuvend, është numri i vogël i inspektorëve shëndetësorë.

Në vendin tonë janë më se 1500 institucione shëndetësore publike dhe private. Ministrinë e kam gjetur me tre inspektorë shëndetësorë dhe ish- ministri Sadik Idriz e di dhe kemi arritur që gjatë kësaj kohe këtë numër ta rrisim 100%, që do të thotë 6...

KRYESUESI: Ia zgjatni diskutimin edhe 2 minuta ministrit!

...Por, hulumtimi, të cilin e kemi kërkuar, tregon që për vendin tonë nevojiten së paku 12 inspektorë shëndetësorë. Çështje tjetër, e cila mund të jetë banale, është se këto komisione për vlerësim me ligjin e ri të financave publike nuk paguhen, ndërsa këta zyrtarë vijnë nga institucionet private shëndetësore, nga asociacioni i mjekëve, nga komunat e Kosovës e tjera, kështu që nuk kanë detyrim që pas orarit të punës ta kryejnë

këtë detyrë për vlerësim të institucioneve. Dhe, një prej problemeve tjera të cilat janë reale në punë të përditshme të vlerësimit të institucioneve shëndetësore është se komisionet shpesh nga institucionet private shëndetësore gjatë licencimit kërkojnë standarde më të larta se sa që i kërkojmë nga institucionet publike.

Unë falënderoj komisionin për rekomandimet. Lus që komentet tona të merren në konsideratë dhe jam i gatshëm të përgjigjem në pyetjet eventuale të deputetëve. Ju faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Sipas radhës, fjalën e kanë përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike është paraqitur Mimoza Ahmetaj.

MIMOZA AHMETAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

KRYESUESI: Unë s' po ju kuptoj pse nuk po dilni në foltore, kur e keni fjalën në emër të Grupit Parlamentar.

MIMOZA AHMETAJ: Të dal?

KRYESUESI: Sipas dëshirës.

MIMOZA AHMETAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Raporti ka për qëllim t'i nxjerrë në pah mangësitë e ligjit. Gjithashtu, këtu kemi parasysh edhe problemet me të cilat ballafaqohen dhe janë ballafaquar mjekët gjatë aplikimit për licencë të punës të institucioneve private shëndetësore, ashtu edhe zyrtarët qeveritarë në ministri gjatë trajtimit të një aplikacioni për licencë dhe licencimit të një institucioni privat shëndetësor.

Synimi është që të gjithë së bashku ta avancojmë dhe përmirësojmë punën e institucioneve private në shërbim të pacientit, duke e përmirësuar infrastrukturën ligjore.

Monitorimi i Ligjit për veprimtari private shëndetësore është bërë në gjithsej 8 institucione shëndetësore private, një numër mjaft i vogël në krahasim me numrin e përgjithshëm që llogaritet të jetë 1000, numër total i institucioneve private në Kosovë, qoftë të licencuara dhe të pa licencuara. Llogaritet se deri tash janë diku mbi 800 institucione të cilat janë licencuar. Vizitat janë bërë kryesisht nëpër klinikat apo institucionet private në Prishtinë dhe Prizren, pra kryesisht në vendbanimet urbane.

Nga e gjithë ajo që e kemi parë në terren, del se shumica e klinikave nuk i plotësojnë tërësisht kushtet e parapara me ligj. Ajo që e bën Ligjin vështirë të aplikueshëm, në shumicën e rasteve është mungesa e sistemit informativ shëndetësor, të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, të çmimoreve unike të shërbimeve shëndetësore, të cilat janë çështje jetike që ndërlidhen me këtë ligj dhe me shëndetësinë në tërësi.

Me një fjalë, cilësia kryesore që do ta determinojë cilësinë e shërbimeve mjekësore private ose publike do të jetë provizioni nga fondet e sigurimeve shëndetësore që i

kontrakton shërbimet shëndetësore nën ndikimin e ligjeve të ekonomisë së tregut. Po ashtu, krijimi i Odës së Mjekëve do ta shkarkonte nga obligimet Ministrinë e Shëndetësisë dhe njëkohësisht do ta ndihmonte atë në shumë gjëra.

Unë përgëzoj Ministrinë për licencimin e klinikave që për vite kanë vepruar të palicencuara edhe pse i kanë plotësuar kushtet, si dhe mbylljen e klinikave private, që për vite të tëra kanë vepruar në kundërshtim me ligjin.

Në ditët e sotme nuk pritet për licencim më gjatë se 30 ditë, nga dita e aplikimit, ashtu siç tha edhe ministri. Pra, po e përmend një fakt të rëndësishëm, që nga vizita jonë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe debatin që e kemi pasur me zyrtarë, domethënë, kjo ka qenë diku më 21 korrik të vitit 2008, deri më sot janë licencuar 64 institucione private shëndetësore dhe janë refuzuar 4 institucione private.

Ajo që rezulton pas debatit publik dhe vizitave në institucione, është se Ministria do të duhej ta ndryshojë ligjin, në mënyrë që t'i adaptohet rrethanave të reja të krijuara, sepse ligji në fjalë më tepër merret me çështje teknike se sa me çështjet juridike të organizimit të një institucioni.

Mbyllja e zyrave rajonale po ashtu është argument që e përforcon ndryshimin e Ligjit të institucioneve private shëndetësore. Çështja e menaxhimit të financave publike, pagesa e anëtarëve të bordit, të pjesëmarrjes së sindikalistëve në borde, çështja e emërtimeve dhe e problemeve që dalin me formën si të emërtohen institucionet private shëndetësore, a janë ambulanca, a janë klinika, a janë spitale ditore, spitale me qëndrim më të gjatë e të tjera, janë disa çështje që e imponojnë ndryshimin e Ligjit të praksës private?

Çështja është se ligji a duhet të fuzionohet me Ligjin themelor të shëndetësisë apo duhet të mbetet ligj i ndarë nga ligji bazë i shëndetësisë? Unë, fare në fund, dua të theksoj përkushtimin e Qeverisë së Kosovës, më saktë të Ministrisë së Shëndetësisë, që ende pa u debatuar raporti në seancë plenare, e ka parë të arsyeshme që t'i shqyrtojë vërejtjet e bëra në raport dhe na është përgjigjur zyrtarisht në formë të shkruar për secilën vërejtje të bërë një nga një. Pra, në emër të Grupit Parlamentar, ju ftoj që këtë raport ta votojmë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputetja Nurishahe Hulaaj.

NURISHAHE HULAJ: Ju faleminderit, kryesues i Kuvendit të Republikës së Kosovës!

Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, kryesisht iu ka përmbajtur planit të punës gjatë vitit 2008, ku në objektive qendrore ka pasur mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, që projektohen edhe në planin e vitit 2009 të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale. Pikërisht, ne e kemi, pra, raportin e mbikëqyrjes së Ligjit për praksën private L-2004/50 dhe për këtë e falënderojmë grupin punues që ka bërë një angazhim maksimal që ne të kemi vlerësimet përfundimtare me rekomandime për shëndetësinë në përgjithësi dhe sistemin dhe strukturimin e saj.

Baza ligjore e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për mbikëqyrjen e ligjeve, e në rastin konkret të Ligjit për veprimtarinë private në shëndetësi, është në Rregullën 53 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Mbikëqyrja e Ligjit për veprimtarinë private në shëndetësi L-2004/50 ka ofruar vlerësimin e shkallës së zbatimit në praktikë të Ligjit të praksës private. Raporti i mbikëqyrjes së Ligjit për praksën private bazohet në takimet e zhvilluara në Ministrinë e Shëndetësisë, në Kuvendin Komunal të Prizrenit dhe në Kuvendin Komunal të Prishtinës, si dhe vizitat e realizuara në 8 institucione private shëndetësore, 6 të licencuara dhe 2 të palicencuara.

Gjatë periudhës së mbikëqyrjes 21 korrik 2008, që ka filluar, e deri më 2 dhjetor 2009, gjithashtu është mbajtur dëgjimi publik më 4 shkurt 2009 në Kuvendin e Kosovës, me pjesëmarrje të përfaqësuesve të veprimtarive shumë sektoriale, private, publike, që gjatë dëgjimit publik kanë dhënë kontributin e tyre në mënyrën më të mirë të mundshme, me qëllim që në të ardhmen të kemi ligj më të avancuar dhe më lehtë të zbatohet në praktikë, që është në radhë në programin e punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2009 për ndryshim dhe plotësim. Arsyeja është e plotë. Do t'i them disa çështje të rëndësishme për pakot e ligjeve të shëndetësisë.

Në mandatin e parë të Kuvendit dhe atë të dytë, ka qenë një kohë e gjatë e miratimit dhe nënshkrimit të këtyre ligjeve. Ka pasur pako të ligjeve për shëndetësi që kanë pritur 16 muaj për nënshkrim nga PSSP-ja, prej miratimit në Kuvend dhe deri te ky nënshkrim, andaj, edhe me vonesë ka filluar zbatimi i këtyre ligjeve.

Periudha e mbikëqyrjes paksa ka qenë e zgjatur, ku edhe gjatë asaj kohe kanë ndodhur dhe janë realizuar shumë obligime nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë ndaj zbatimit të ligjit në fjalë. Informatat e detyrave të realizuara i kemi marrë edhe me shkrim nga ministri i Shëndetësisë, që kundrejt rekomandimeve që i ka dhënë grupi punues i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, një pjesë e konsiderueshme e këtyre rekomandimeve janë realizuar, që tregojnë edhe raportin, respektivisht komentet e raportit të Ministrisë së Shëndetësisë në mbikëqyrjen e Ligjit të praksës private. Por, mbetet ende për t'u dëshiruar shumë, që të kemi reformim në sistemin shëndetësor në vazhdim me dinamikë më të shprehur, e cila varet edhe nga përkrahja qeveritare e rregulluar edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 92, pika 3 dhe neni 94, pika 3.

Në bazë të ligjit, paraqiten problematika në nxjerrjen e udhëzimeve administrative. Kjo vlen edhe për ligjet tjera, e jo vetëm për këtë ligj, për të cilët nuk mungon puna e komisioneve dhe e bordeve në Ministrinë e Shëndetësisë, por çdo udhëzim administrativ që kërkon zbatim, kërkon edhe implikime buxhetore. Konsideroj se në kornizën afatmesme 2009-2011 të Buxhetit të Republikës së Kosovës nuk ka të planifikuar linjë të veçantë të ndarjes së mjeteve për zbatimin e ligjeve, prandaj edhe paraqiten vështirësi gjatë zbatimit.

Sistemi shëndetësor është shumë kompleks dhe kërkon mbështetje qeveritare për reformim, me qëllim që të kemi të realizuar Fondin e Sigurimeve Shëndetësore që të gjithë ne kemi avokuar dhe kemi sensibilizuar edhe Parlamentin që ta kemi përpara dhe që është fuqia kryesore e cila do ta determinojë cilësinë e shërbimit shëndetësor privat dhe publik, do të mundësojë kontraktimin e shërbimeve mjekësore nën ndikimin e ligjeve të ekonomisë së tregut. Pra, Ministria e Shëndetësisë, për këtë kemi informata, edhe në raport ka formuar grupin punues që është në procedurë të mëtejme që ne ta kemi Ligjin për Fondin e Sigurimeve Shëndetësore.

Përmes Fondit të Sigurimeve Shëndetësore mundësohet edhe matja e realizimit të indikatorëve të:

1. Shërbimeve shëndetësore sipas normativave dhe standardeve.
2. Resurseve - personel shëndetësor, në raport me banorët.
3. Resurseve financiare- çmimeve, që janë shumë të nevojshme. Nuk mund të ketë çmime në shëndetësi pa normativa dhe standarde.
4. Prioritetet publiko-private që konsideroj se duhet të jenë të barabarta në normativa dhe standarde të shërbimeve shëndetësore.
5. Sistemi informativ shëndetësor edhe përkundër angazhimeve të Ministrisë së Shëndetësisë, ende ka mbetur për t'u punuar që të përkryhet i plotë me qenë se është një segment shumë i rëndësishëm ku mbliidhen të gjitha të dhënat e sistemit shëndetësor, me qenë se ende kemi fragmentarizim në të dhëna, sepse të dhënat janë shumë të rëndësishme për një analizë të plotë shëndetësore për t'i dhënë kahe të mëtejme zhvillimeve dhe sistemit shëndetësor në Kosovë.

Faktet flasin vetë. Në të dhënat që kemi pasur gjatë një takimi pune në javën e kaluar me ministrin e Shëndetësisë, të cilin e ka ftuar Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe e falënderojmë shumë për të dhënat dhe informatat që na i ka dhënë, edhe gojore, edhe elektronike, disa fakte flasin. Për shembull: 12 centë në ditë për një banor të Kosovës, 3.70 centë për një muaj për një banor të Kosovës, 45 euro për kokë banori në vit dhe kjo nuk do koment. Do të thotë, kërkohet një zhvillim më i fuqishëm ekonomik dhe një buxhet më i lartë për Ministrinë e Shëndetësisë që në 3 deri në 5 vjetët e ardhshëm, konsideroj dhe në bazë të informatave të Ministrisë së Shëndetësisë, do të jetë diku 10% për Ministrinë e Shëndetësisë buxheti që do të ndikojë në mirëqenien e qytetarëve të Kosovës.

Do të kaloj edhe në një segment tjetër. Problemet tjera që ndikojnë në shëndetin qytetarëve, direkt apo indirekt, e që duhet të interferohen edhe Qeveria dhe ministrinë përkatëse për t'i zgjidhur këto probleme. Nën një, uji. Ne në Kosovë kemi ujë higjienik, por ende nuk kemi ujë cilësor. Mjedisi nuk i plotëson ende kriteret për zonë ekologjike. Ushqimi, kemi të dhënat e analizuar që 55% e sëmundjeve ngjitëse janë si pasojë e ujit dhe e ushqimit të kontaminuar. Rekreacioni për stil të shëndoshë të jetës. Të gjitha këto janë shtesë që nuk i përkasin vetëm Ministrisë së Shëndetësisë, por edhe Qeverisë dhe ministrive tjera përkatëse.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah raportin e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale. Gjithashtu, përkrah edhe komentet e Ministrisë së Shëndetësisë, në raportin nr. 3, 1831-L/2004/50, të datës 14.4.2009, dërguar përmes elektronikës, që Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale i ka kërkuar në takimin e punës më 8.4.2009, me ministrin e Shëndetësisë dhe të njëjtin përmes procedurave të Kuvendit, më 15.4.2009. Dhe, ky koment i Raportit të ministrin të Shëndetësisë për mbikëqyrjen e Ligjit të praksës private i bashkëngjitet raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për veprimtarinë private në shëndetësi dhe kjo me një analizë ... të komentit dhe të raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, do të qesë një prodhim që del, që shumë rekomandime, pjesa e konsiderueshme e tyre që janë dhënë në

raport të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale janë realizuar, sepse ka qenë një periudhë e gjatë e kohës së mbikëqyrjes.

Pra, Grupi Parlamentar e përkrah dhe unë si anëtare e Komisionit plotësisht e përkrah dhe do të japim kontributin tonë në të gjitha pakot e ligjeve që do të vijnë për ndryshim dhe plotësim që i përmendi ministri Gashi. Pra, do ta japim kontributin tonë në Komisionin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Kuvendin e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete. Fjalën e ka, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Demaliaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Lidhur me çështjet profesionale që u theksuan deri me tash për vlerësimin e punës së komisionit, nuk kisha shtuar diçka më tepër, mirëpo si grup parlamentar e përkrahim punën që e ka bërë Komisioni Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Në këtë rast kisha pasur dëshirë të ndalem vetëm te disa shembuj përkatës lidhur me mundësinë e implementimit të ligjeve të shëndetësisë që kanë dalë konkretisht nga Parlamenti i Kosovës. Mundësia e implementimit të tyre është shumë e vështirë, sepse kolapsi në shëndetësi nuk ka ardhur vetëm si çështje financiare, por edhe të kolizionit të kompetencave ligjore që ka sot kjo ministri me shumë përgjegjësi që lidhen me ministrinë tjera. E tha ministri më herët se Komisioni për licencimin e subjekteve private shëndetësore nuk di a është shfuqizuar një akt nënligjor i Ministrisë, sepse përpos vendit të punës që kanë pasur inspektorët shëndetësorë, kanë pasur të drejtë që edhe honorar të marrin, të paguhen financiarisht edhe për pjesën tjetër gjatë procedurave të licencimit të subjekteve private shëndetësore. Mirëpo, është edhe një kolizion tjetër aty, sepse është një katërfishim i përgjegjësisë, duke përfshirë inspektorët shëndetësorë, inspektorët e punës, inspektorët komunalë, asociacionin i komunave të Kosovës, që është shumë i jashtëligjshëm në këtë rast, sepse një organ alternativ që sot nuk i duhet aspak Kosovës, këto kanë ekzistuar në periudhën e komunizmit, asociacioni i komunave siç kanë qenë këshillat ekzekutive, të hyjnë dhe të marrin pjesë në licencimin e subjekteve private shëndetësore. Pra, nuk di interes i kujt ka qenë të futen këto në këtë ligj dhe, në këtë rast më së pakti kur vjen çështja e licencimit të subjekteve private shëndetësore, është punë e Ministrisë.

Vetëm kualifikimet e mjekëve lidhur me çështjen e asaj klinike a poliklinike apo si spital apo çka do të jetë, mund të jetë çështje, sepse pjesa tjetër është çështje teknike që e prezanton shumë mirë Ligji i sigurisë në punë, të mbrojtjes së shëndetit të të punësuarit dhe të ambientit të punës. Kështu që, në këtë rast e përshëndesim punën që e ka bërë komisioni edhe do ta votojmë raportin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, Demaliaj. Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputetja Gjylnaze Sylja.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, i nderuar kryesues! Po filloj me një vërejtje ndaj jush. Sipas Rregullores së Punës së Kuvendit, pas kryetarit të komisionit, flasin shefat e grupeve, e kështu me radhë. Me gjithë respektin ndaj ministrit, është dashur të zbatoni Rregulloren e Punës.

I nderuar ministër,
E nderuara ministre,
Deputetë të nderuar,

Sot po diskutojmë për një çështje shumë të rëndësishme, për sektorin privat shëndetësor. Megjithatë, cilido nga sektorët, edhe ai publik, por edhe ndoshta në të ardhmen i përzier, është jetik për Kosovën, sidomos në periudhën e tranzicionit nëpër të cilën po kalojmë. Prandaj, funksionalizimi i mirëfilltë i cilido nga këta sektorë, ka rëndësi për vetë shëndetin e popullatës, por edhe për ekonominë, sepse vlerësimi do të bëhet në bazë të shëndetit të popullatës për çdo euro të shpenzuar.

Në Kosovë rregullimi i sektorit për veprimtarinë private është rregulluar me ligjin 2004/50, i cili është aprovuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2004, prandaj Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale ka filluar mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji në korrik të vitit 2008 dhe ka përfunduar në shkurt 2009.

Punën e vet Komisioni e ka përqendruar ashtu siç është i hartuar dhe vetë ligji, do të thotë në punën dhe përgjegjësitë të cilat i ka Ministria e Shëndetësisë, pastaj niveli komunal, por edhe vetë institucionet private shëndetësore, si dhe mekanizmat ligjorë të nevojshëm për zbatimin e këtij ligji, sikur që janë: Bordi për licencim, Këshilli, pastaj Inspeksioni dhe mekanizmat tjerë.

Raporti është përmbledhje e të dhënave të marra nga terreni, të identifikimit të problemeve dhe të rekomandimeve, por edhe të konkluzioneve që dalin nga identifikimi i problemeve. Unë këto probleme do t'i ndajë në tri nivele, në ato në Ministrinë e Shëndetësisë, në institucionet shëndetësore private dhe pastaj në ato komunale.

Sa i përket Ministrisë së Shëndetësisë, janë identifikuar 16 probleme, të cilat tani po i përmbledh në katër grupe. Grupi i parë ka të bëjë me mungesën e zbatimit, gjegjësisht të nxjerrjes së akteve nënligjore, të obligueshme nga Ministria e Shëndetësisë, si ajo për përvojën punës, që duhet të kenë profesionistët në sektorin privat, pastaj aktet nënligjore për standardet e domosdoshme për kujdesin shëndetësor, për përcaktimin e detyrave dhe të përgjegjësiave të organeve mbikëqyrëse, për kompensimin material të anëtarëve të Bordit, Rregulloren për punën e Bordit dhe komisioneve.

Sidomos problem në zbatimin e këtij ligji ka qenë mospagesa e anëtarëve të Bordit për licencim edhe pse, sipas ligjit, bordi financohet nga të hyrat e veta dhe nga burimet shitesë të Ministrisë. Sipas zyrtarëve të Ministrisë, bordi vitin e kaluar ka pasur të hyra vetjake prej 160.000 euro. Në qoftë se kanë qenë këto të hyra, atëherë është dashur të gjendet edhe mënyra për pagesën e anëtarëve të bordit.

Një ndër problemet që janë identifikuar, janë edhe afatet kohore. Unë e dëgjova ministrin me vëmendje dhe tha se tani nuk ka vonesa në përgjigjen e aplikuesve. Megjithatë, në kohën kur komisioni ka bërë mbikëqyrjen e këtij ligji, ka pasur vonesa edhe me vite në dhënien e përgjigjes për licencimin e institucioneve private shëndetësore. Nganjëherë ka pasur edhe pëlqim për vazhdimin e punës, gjë që nuk ekziston në ligj, do të thotë jo licencë, por pëlqim.

Shuarja e zyrove rajonale të autoriteteve shëndetësore ka shkaktuar shuarjen e komisioneve për vlerësim, që si pasojë pastaj ka shkaktuar pengesa të mëdha në zhvillimin e aktiviteteve të bordit. Këtë e ka treguar edhe vetë zyrtari nga Ministria e

Shëndetësisë, i cili ka thënë se për shkak të shuarjes së këtyre komisioneve, nuk ka pasur aktivitet të bordit për 7 deri në 8 muaj. Gjithashtu, kjo ka ndikuar në vlerësimin e përmbushjes së kushteve teknike dhe profesionale për licencimin e institucioneve private.

Grupi i dytë i problemeve ka të bëjë me mungesën e politikave dhe të planit strategjik zhvillimor për sektorin privat, mungesën e planit të rrjetit të institucioneve. Sipas ligjit, plani duhet të përmbajë numrin dhe kapacitetin e institucioneve private dhe këtu duhet të futen në marrëdhënie kontraktuale me Fondin e Sigurimeve Shëndetësore, i cili po ashtu nuk ekziston. Prandaj, sot kemi diku më shumë se 800 institucione private, më se 600 të licencuara, por mungon planifikimi i rrjetit të këtyre institucioneve, e me këtë do të thotë edhe një plan i mirëfilltë për zhvillimit e sektorit privat.

Grupi i tretë i problemeve ndërlidhet me mosthemelimin e një shtylle shumë të rëndësishme të sistemit shëndetësor, të Këshillit të Përgjithshëm Profesional. Kjo po shkakton mungesën e përpilimit të listës unike të çmimeve të shërbimeve shëndetësore dhe, një tjetër është se nuk ka sistem unik të informimit shëndetësor.

Grupi i katërt i problemeve, janë problemet e identifikuar nga vetë institucionet shëndetësore private, gjegjësisht mospërmbushja e obligimeve ligjore që kanë këto institucione. Janë identifikuar 8 probleme që kanë të bëjnë, pra, me ushtrimin e veprimtarisë së këtyre institucioneve, pa licencë të lëshuar nga bordi, mungesën e plotësisht të kushteve të përgjithshme minimale për hapësirën, personelin dhe pajisjen mjekësore. Shumë institucione nuk kanë pasur rregulloren dhe statusin operativ, nuk janë të lidhura, pra, me sistemin unik të informatave shëndetësore, edhe pse ky sistem nuk ekziston, nuk i kanë të ruajtur dokumentacionin dhe regjistrat mjekësor, nuk raportojnë për aktivitetet në institucionet përkatëse dhe nuk kanë çmimore të harmonizuara të shërbimeve shëndetësore. Dhe, një tjetër problem është menaxhimi adekuat i mbeturinave, sipas standardeve.

Nga të gjitha këto probleme që i përmenda, Komisioni ka nxjerrë konkluzionin dhe është konkluzion gjegjësisht imi nga këto se ligji nuk po zbatohet plotësisht, por pjesërisht dhe se duhet të nxjerrë rekomandime, të cilat Ministria e Shëndetësisë duhet t'i marrë parasysh. Këto rekomandime janë me numër 22, prandaj sikurse problemet, do t'i ndajë edhe rekomandimet. Në grupin e parë përfshihen të gjitha ato akte nënligjore të cilat i përmenda, të cilat nuk i ka nxjerrë Ministria, e që duhet, që kanë të bëjnë me përcaktimin e kushteve të punës të profesionistëve, përvojën e tyre, standardet, kujdesin shëndetësor, komisionet, bordin etj.

Në grupin e dytë të rekomandimeve janë, gjithashtu: politikat, strategjia zhvillimore për sektorin e shëndetësisë private, plani i rrjetit, themelimi i Këshillit të Përgjithshëm Profesional, themelimi i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore. Gjithashtu, Ministria e Shëndetësisë duhet të ndalojë ushtrimin e institucioneve private pa licencë, të ngritë sistemin unik shëndetësor dhe të respektojë afatet kohore sipas ligjit.

Ndërsa, sa i përket grupit të tretë, duhet të them se më tepër ka të bëjë me rekomandime që lidhen me institucionet private shëndetësore. Do të thotë, nuk mund të punojnë institucionet private shëndetësore pa licencë, duhet t'i plotësojnë kushtet e përgjithshme minimale për hapësirën, personelin dhe pajisjen, duhet ta kenë rregulloren dhe statusin, duhet t'u raportojnë institucioneve përkatëse, duhet të kenë çmimoren e harmonizuar dhe të bëjnë menaxhimin adekuat të mbeturinave, sipas standardeve.

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështet raportin. Megjithatë, për hir të kontributit, për funksionalizimin e mirë të sistemit shëndetësor, Grupi Parlamentar i Aleancës ka mendim tjetër sa i përket komisionit. E para është se një debat i madh është zhvilluar se e duhet ndarë sektori në publik dhe privat.

Grupi Parlamentar i Aleancës mendon se shërbimet shëndetësore janë unike, një, ndërsa prona mundet të jetë private ose publike ose edhe e përzier, prandaj mendojmë se në Ligjin bazik për shëndetësi duhet gjithashtu të përfshihet sektori privat, e jo të ketë një ligj të veçantë, i cili do të përfshijë vetëm sektorin privat.

Derisa nuk rregullohet çështja e financimit, gjegjësisht e pagesës së shërbimeve shëndetësore, themelimi i fondit, gjithashtu nuk duhet ndarë shëndetësia. Mos harroni se nuk ka stimulim në institucionet shëndetësore publike dhe se shumica e profesionistëve mund të ikin në sektorin privat.

Gjithashtu, delegimi i përgjegjësiwe operative duhet të bëhet tek Oda e Mjekëve. Në udhëzimet administrative duhet të ketë edhe emërime të tjera, për arsye se është për spitalet, por nuk ekziston licencimi për klinikat. Kushtet për veprimtari shëndetësore, kushtet higjieniko-sanitare duhet të bëhen ose të vlerësohen nga Institucioni Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, ndërsa nga kjo nxjerrim në fund se raporti i Komisionit është një tregues shumë i rëndësishëm...

KRYESUESI: Ju faleminderit edhe për vërejtjen. Meqenëse e thatë, po ju përsëris që sipas Rregullores, kryesuesi ka të drejtë t'ia japë fjalën ministrit edhe kur çështjen nuk e ka ngritur Qeveria. Shihni Kreun XI, pika 5 b) e Rregullores. Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, fjalën e ka deputetja Qamile Morina.

QAMILE MORINA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ministra,

Deputetë të nderuar,

Lidhja Demokratike e Dardanisë ka qenë pjesë e Grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për veprimtari private shëndetësore, si dhe ka marrë pjesë në hartimin e këtij raporti, andaj rekomandimet si të tilla i mbështesim.

Qasja e shumicës së anëtarëve të Grupit punues gjatë mbikëqyrjes së këtij ligji ka qenë mjaft konstruktive, duke pasur parasysh që sektori shëndetësor është sa i rëndësishëm, po aq i ndjeshëm dhe, fatkeqësisht, është sektor i lënë në margjinat e interesave kombëtare.

Gjithashtu, duhet theksuar se Komisioni nuk është udhëhequr nga dëshira për të gjetur të meta në punën e institucioneve relevante, por nga dëshira për të ndihmuar në sigurimin e shërbimeve cilësore shëndetësore për qytetarët tonë në këtë sektor, e që zbatimi i ligjit synon këtë qëllim.

Aktiviteti mbikëqyrës i këtij grupi punues filloi në korrik të vitit të kaluar, shumë më herët se skandalet mediatike që i patëm lidhur me këtë sektor. Në raport janë të paraqitura: mbledhja e informatave nga institucionet kompetente, vlerësimi i të dhënave dhe gjetjet faktike dhe për të gjitha këto janë nxjerrë rekomandimet.

Ligji për veprimtari private shëndetësore është ligj bazë mjaft i mirë për kushtet e tanishme, i cili legalizon, mbikëqyrë dhe rregullon institucionet private shëndetësore dhe ka për qëllim përparimin, përmirësimin e gjendjes shëndetësore të qytetarëve të Kosovës. Natyrisht, nuk ka ligj të përkryer dhe rishikimi periodik i legjislacionit duhet të jetë pjesë e programit të punës së Ministrisë së Shëndetësisë.

Në strategjinë legjislativë për këtë vit është paraparë ndryshimi i Ligjit për veprimtarinë shëndetësore. Ne jemi të vetëdijshëm që çfarëdo ndryshimi në këtë ligj, pa reformë të rëndësishme në sistemin shëndetësor, do të rezultojë me ndryshime apo modifikime kozmetike të këtij ligji, pa ndryshim përmbajtësor. Ne do të përqendrohemi me vërejtjet tona drejtuar obligimeve dhe detyrave ligjore që ka Ministria e Shëndetësisë në zbatimin e ligjit, ngase mendojmë se zbatimi efektiv i këtij ligji me institucionet private shëndetësore në masë të madhe varet nga zbatimi i ligjit në nivel qendror, që do të thotë nga Ministria e Shëndetësisë.

Ne duhet t'i adresojmë problemet kryesore duke mos hyrë në detale. Ligji shumë qartë i përcakton tri nga shtyllat kryesore të fushëveprimit të ligjit: krijimin e parakushteve për zbatimin efektiv të ligjit, procesin e licencimit, mbikëqyrjen e institucioneve private shëndetësore.

Problemet e identifikuara në krijimin e parakushteve për veprimtarinë private shëndetësore efektive kanë të bëjnë me mospërmbushjen e obligimit ligjor nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë që të hartojë politikën dhe strategjinë zhvillimore për sektorin privat. Mungesa e nxjerrjes së akteve nënligjore të parapara me ligj, si dhe përpilimi i çmimoreve të harmonizuara të shërbimeve shëndetësore.

Sa i përket licencimit të institucioneve private, ai bëhet në dy nivele dhe atë nga Komisioni për vlerësimin e përmbushjes së kushteve minimale tekniko-profesionale dhe licencimi dhe bordi i licencimit.

Komisioni për vlerësim do të duhej të përbëhej nga 5 anëtarë të profileve të ndryshme, me qëllim të vlerësimit të përmbushjes së kushteve teknike dhe profesionale për licencim. Në bazë të raportit të Komisionit për vlerësim, Bordi i licencimit do të vendoste për lejimin e apo refuzimin e licencës. Shuarja e këtyre komisioneve vlerësuese është bërë me vendimin e Ministrisë së Shëndetësisë, që është në kundërshtim me ligjin si dhe rëndon dhe dëmton procesin e licencimit.

Ky amputim i kapaciteteve të licencimit ka efekte negative si: stërzgjatën e afatit kohor nga koha e aplikimit dhe licencimit, gjë për të cilën ka pasur shumë vërejtje nga përfaqësuesit e institucioneve private që me vite presin për licencim, si dhe keqkuptime të shumë institucioneve private shëndetësore që aplikojnë dhe vazhdojnë të punojnë ende pa u licencuar, e ashtuquajtura “heshtje administrative” që është në kundërshtim me ligjin, ngase neni 4.3 përcakton qartë se institucionet private të kujdesit shëndetësor, nuk do të ushtrojnë veprimtari shëndetësore nëse nuk e kanë licencën e lëshuar nga bordi. Gjithashtu, shuarja e komisioneve të vlerësimit mund të jetë edhe arsye e lëshimeve të identifikuara, në kuptim të licencimit të institucioneve private shëndetësore, të cilat nuk i plotësojnë kushtet minimale teknike profesionale, e janë të licencuara.

Mbikëqyrja e institucioneve, si publike, ashtu edhe private do të duhej të bëhej në pajtim me dispozitat e Ligjit për shëndetësi, si dhe të Ligjit për veprimtari private shëndetësore. Fatkeqësisht, niveli i mbikëqyrjes së institucioneve private shëndetësore është i ulët dhe

shqetësues, e kryesisht kryhet vetëm për kontrollin e respektimit të ligjshmërisë që bëhet nga Inspektorati shëndetësor, kurse fare nuk bëhet mbikëqyrja profesionale dhe standardet e cilësisë.

Arsyetimet e përfaqësuesve të Ministrisë të Shëndetësisë për vështirësi të mbikëqyrjes së institucioneve private shëndetësore janë mungesa e kapaciteteve mbikëqyrëse, ngase janë vetëm 6 inspektorë shëndetësorë. Ne konsiderojmë se ligji përcakton qartë, që përveç Inspektoratit shëndetësor si organ mbikëqyrës, ligji gjithashtu përcakton edhe organet tjera mbikëqyrëse: si Bordi i licencimit, autoritetet shëndetësore të Ministrisë përgjegjëse për komunën përkatëse, drejtoritë komunale të shëndetësisë, Inspektorati sanitar, dhe se detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre organeve mbikëqyrës përcaktohen me akt të veçantë nënligjor, i cili mungon.

Gjithashtu, ligji parasheh që në rasate të veçanta Ministria mund të mbrojë profesionistë të dalluar shëndetësorë për mbikëqyrje kur e sheh të arsyeshme, që do të thotë aktivizimi dhe funksionimi i të gjitha këtyre organeve mbikëqyrëse, me detyra dhe përgjegjësi të qarta, do të ngriheshin kapacitete mbikëqyrëse që nuk do të lejonin që ky sektor të mbetet jashtë kontrollit si e kemi tani. Dhe, së fundi, që nuk mund të lë pa e përmendur, është një e metë shqetësuese që është vërejtur te shumica e institucioneve private, është mungesa e dokumentacionit shëndetësor dhe e evidencës.

Ministria e Shëndetësisë duhet të gjejë mënyrë, të inkurajojë dhe të bëjë presion pozitiv tek institucionet private, por edhe ato publike që kryejnë veprimtari të kujdesit shëndetësor në pajtim me ligjin, të obligohen të udhëheqin dokumentacionin shëndetësor dhe evidencën dhe t'ia përcjellin raportet periodike Ministrisë së Shëndetësisë, siç parashihet me ligj dhe siç parashihet në çdo sistem shëndetësor të mirëfilltë.

Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë konsideron se Ligji për veprimtarinë private në shëndetësi ka pengesa të mëdha në zbatim, për çka duhet të ndërmerren masa konkrete për ndryshim të gjendjes dhe se ky raport dhe rekomandimet që dalin prej tij do të shërbejnë për përmirësimin e kushteve në zbatimin e Ligjit për veprimtarinë shëndetësore.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete! Grupi “7+”, e ka shfrytëzuar kohën. Në emër të Grupit Parlamentar SLS, Radmilla Vujović.

RADMILA VUJOVIĆ: Uvaženi zemeniče,
Ministri, dame i gospodo poslanici,

Ja neću da ponavljam ono što su kolege do sada rekle, jer su rekle dosta, i pojasnile su po pitanju izveštaja. SLS će sigurno podržati razmatranje izveštaja o nadzoru nad sprovođenjem Zakona br.2004/50 po privatnoj delatnosti u zdravstvu. Hvala!

KRYESUESI: Hvala!

Grupi Parlamentar “Zajedno”, deputetja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa,

Pozdravljam Predsedništvo i sve kolege poslanike,

Mi smo danas pred sobom imali izveštaj Komisije za zdravstvo, rad i socijalna pitanja od 16. marta 2009. godine. Pažljivo smo razmotrili ovaj izveštaj. Danas smo čuli dosta od kolega povodom Zakona o privatnoj delatnosti u zdravstvu. Znamo da je bio na terenu obilazak i možemo kao grupa da kažemo, što je i stavljeno u izveštaju da je neophodan

bazičan zakon i to Zakon o zdravstvenom osiguroanju, gde mi moramo više kao država i društvo da imamo fondove, neophodan Fond zdravstvenog osiguranja.

Iz ovog fonda proističe i cirkulacija i poslovanje svih institucija u okviru Ministarstva zdravstva, kao što su institucije, kako mi kažemo društvene, javne, privatne. I u ovom zakonu videli smo na terenu da su uočene velike nepravilnosti koje su zapravo, ja mogu da kažem da su ove nepravilnosti stvorili bazični zakoni koje smo ovde doneli, a Ministarstvo dalje nije analiziralo ove zakone i nije donelo podzakonske akte, gde bi se formulisalo dalje kretanje delatnosti u privatnoj delatnosti u zdravstvu na terenu.

Ja smatram da je Komisija uradila dobro svoj zadatak i ostaje na Ministarstvu da prepozna i da napravi koordinaciju između Borda, između Inspeksijske službe i rada svih subjekata, da prepozna sve subjekte na terenu i da napravi podzakonska akta koja su neophodna da bi ova delatnost, ili da kažem sve te ordinacije mogle da fiksionišu u zakonskoj formi. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Konstatoh që në emër të grupeve parlamentare janë kryer diskutimet. Tani sipas radhës së të paraqiturve, fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje, të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Duke pasur parasysh që po flasim për një ligj të një rëndësie të veçantë, që në fillim dua të them se jemi të kënaqur me rekomandimet që kanë ardhur nga Komisioni për Shëndetësi dhe nga Grupi punues dhe po e realizojmë një objektiv që e kanë pasur komisionet funksionale për t'i monitoruar ligjet dhe për të parë zbatimin e ligjeve në praktikë. Mirëpo, si deputet i Kuvendit i kam disa shqetësime rreth rekomandimeve të cilat janë nxjerrë nga komisioni funksional dhe, sidomos pas rekomandimeve që kanë ardhur nga Ministria e Shëndetësisë. Para vetes e kam raportin dhe e kam lexuar komplet raportin dhe e kam një shqetësim, sepse nuk kam parë një plan të veprimit. Pra, nuk kam parë që është nxjerrë një plan me nenet përkatëse të ligjit dhe që do të na bënte më të qartë në Kuvend ta kuptojmë drejt se ajo që po rekomandohet, a ekziston apo nuk ekziston.

Nga ajo që pashë nga rekomandimet e komisionit funksional dhe nga konkluzionet që i ka nxjerrë komisioni funksional, në pikat e përgjithshme flet për zbatimin e ligjit, për të cilin e falënderojmë dhe e kuptojmë që Ligji për veprimtarinë shëndetësore private nuk është duke u zbatuar në Kosovë, mirëpo duhet të heqim një dilemë në këtë Kuvend që të mos aprovojmë 20 rekomandime, në qoftë se këto rekomandime apo këto udhëzime administrative i ka Ministria e Shëndetësisë aktualisht, sepse po e sjellim në dilemë të madhe Kuvendin që të aprovojë rekomandime e më pastaj këto të mos zbatohen kurrë në praktikë. Ju e dini se kjo ka ndodhur me rastin e aprovimeve të rekomandimeve nën legjislaturën e kaluar për pensionistët në Kosovë dhe sot e asaj dite asnjëherë nuk janë implementuar ato rekomandime.

Unë po i përmend vetëm disa. Përmendet neni 2, paragrafi 2.1, pika c) për kushtet dhe përvojën e nevojshme të punës së profesionistëve në shëndetësi. Në raportin që e kemi nga Ministria e Shëndetësisë dhe nga ajo që kemi mundur tani t'i shohim disa nga udhëzimet administrative që i ka Ministria e Shëndetësisë, kjo çështje është e përfunduar. Prandaj, nuk do të ishte në rregull që ne ta aprovojmë një rekomandim për

një udhëzim administrativ i cili është në fuqi dhe mund t'i aprovojmë rekomandimet, nëse mund të thuhet që ligji nuk është duke u zbatuar për shkak të asaj që udhëzimi administrativ, që është paraparë të nxirret nga ministria përkatëse, nuk është nxjerrë apo është nxjerrë në kundërshtim me ligjin në fuqi.

Mandej, po e përmend çështjen e funksionimit të institucioneve shëndetësore pa licencë. Është shumë mirë dhe është rekomandim i qëndrueshëm i komisionit funksional që në Kosovë veprojnë institucione shëndetësore pa licencë dhe, natyrisht, është dhënë rekomandim që Ministria e Shëndetësisë përdor autoritetin e vet për t'i mbyllur këto institucione pa licencë. Por, ndoshta ka qenë e rrugës që të përcaktohet një datë, saktë që t'i jepet rekomandim i qartë apo të merret vendim i qartë që Ministria e Shëndetësisë nuk duhet të lejojë asnjë institucion shëndetësor të punojë pa licencë në Kosovë, duke marrë parasysh që kërkesa për licencë po vonohet për shkak të mosfunksionimit, mosfunksionalizmit të Bordit dhe çështje tjera edhe pse na e pamë në raport që Bordi është duke funksionuar dhe brenda afatit të paraparë janë duke përfunduar lejet për licenca për ato institucione shëndetësore të cilat kërkojnë.

Çështje tjetër, është kërkuar në rekomandim që të jetë sigurimi shëndetësor. Por, ne duhet ta kuptojmë, tash është në rregull dhe është çështje shumë e rëndësishme për Kosovën dhe institucionet e saj, mirëpo ne e kuptojmë që ende nuk e kemi Ligjin bazë për sigurimet shëndetësore. Pra, përderisa nuk e kemi ligjin bazë për sigurimet shëndetësore, të cilat po i presim që në këtë legjislaturë t'i aprovojmë, atëherë do të binim në dilemë të madhe që t'i japim rekomandim Qeverisë së Kosovës apo ministrisë, në këtë rast, ministrisë përkatëse të nxjerrë qoftë një udhëzim apo të marrë një vendim për këtë siguri pa e pasur Ligjin bazë për sigurimet shëndetësore. Domethënë, i japim detyra pa pasur mundësi për t' i realizuar në praktikë ministria përkatëse dhe, natyrisht, ky rekomandim do të mbetet në sirtar.

E njëjta çështje vlen edhe për çështjen e instalimit të rrjetit, sepse nuk e kemi Ligjin për planifikim, e kështu me radhë, mirëpo unë kisha kërkuar që si deputet, ndoshta është mirë t'i harmonizojmë rekomandimet që i kemi bërë si komision funksional me rekomandimet që kanë ardhur nga Ministria e Shëndetësisë për çështjet të cilat janë përfunduar dhe rekomandimet të cilat i aprovojmë si Kuvend. Natyrisht, kërkojmë përgjegjësi që këto të implementohen në praktikë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Sipas radhës, fjalën e ka deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Unë e vlerësoj praktikën e Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

që vërtet të fillojë monitorimin e zbatimit të ligjeve, e kur është fjala për shëndetësinë, është një fushë tejet e rëndësishme.

Nga raporti i Komisionit, takimet me zyrtarët e Ministrisë së Shëndetësisë, të drejtorive komunale për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, vizitat në terren, në ambulancat dhe spitalet private, shihet qartë se Ligji për veprimtarinë private në shëndetësi në masë të madhe nuk zbatohet. Vërehen lëshime serioze substanciale si nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë gjatë licencimit, mospërmbyshja e kriterëve të domosdoshme profesionale, teknike dhe administrative nga ana e institucioneve private shëndetësore. Andaj, të gjitha

këto defekte në funksionimin e hallkave të sistemit institucional, të mekanizmave të Ministrisë së Shëndetësisë, të komisioneve, të bordeve e të tjera, kanë ndikuar në masë të madhe që edhe institucionet private shëndetësore mos ta respektojnë, gjegjësisht mos ta zbatojnë Ligjin për veprimtarinë private në shëndetësi.

Unë do të ndalem në të dhënat faktike që anëtarët e Komisionit për shëndetësi dhe mirëqenie sociale i kanë paraqitur në këtë raport të tyre.

Obligimet e parapara me Ligj i kanë ndarë, do të thotë, nën a) obligimet e Ministrisë së Shëndetësisë. Së pari, obligimet e Ministrisë së Shëndetësisë dihen dhe Ministria e Shëndetësisë ka obligime kushtetuese dhe ligjore që ato obligime t'i zbatojë. Kjo është një vërejtje për kolegët e Komisionit. Por, edhe me këto obligime të parapara të Ministrisë së Shëndetësisë, thotë neni 2, pika 1, pika c) të nxirret akt nënligjor për përvojën e punës për profesionistët e kujdesit shëndetësorë në sektorin privat. Ky është obligim i shëndetësisë, i Ministrisë së Shëndetësisë dhe nuk ka nevojë që raportet herëve tjera të ngarkohen me informata, që e potencoi edhe deputeti Hyseni, që vetëm janë obligime ligjore dhe institucionet relevante shtetërore janë të obliguara që t'i respektojnë.

Pastaj, të bashkëpunojnë me Ministrinë komunat dhe institucionet e tjera të cilat në mënyra të ndryshme janë të përfshira në zhvillimin e sektorit privat në shëndetësi. Edhe kjo tashmë është gjë e ditur.

Te obligimet e institucioneve private shëndetësore: “T’u përmbahen detyrimeve ligjore lidhur me shërbimet shëndetësore që vlejnë për institucionet publike shëndetësore”. Një institucion që nuk u përmbahet këtyre obligimeve, atëherë është Ministria që duhet të japë përgjigjen adekuate konform rregullativave dhe legjislacionit në fuqi.

Unë kam vërejtje të çmimoreve, sepse është bërë polemikë dhe është një debat i hapur sa i takon çmimoreve dhe unë mendoj që Ministria e Shëndetësisë duhet të marrë hapa konkret dhe urgjentisht të fillojë ta harmonizojë një çmimore unike për shërbimet shëndetësore që do të vlenin për tërë territorin e Republikës së Kosovës, duke përfshirë të tri sistemet shëndetësore në vend, qoftë ai primar, sekondar apo edhe terciar.

Te zbatueshmëria e ligjit: “Problemet e identifikuar në Ministrinë e Shëndetësisë”. Edhe këto janë citime të legjislacionit aktual në fuqi që Ministria e Shëndetësisë ka obligim t'i respektojë dhe t'i zbatojë. Mungon, thotë, akti nënligjor për kushtet dhe përvojën e nevojshme të punës së profesionistëve të kujdesit shëndetësor në sektorin privat. Këto gjëra rregullohen me akte nënligjore, me udhëzime administrative dhe mund të caktohen, do të thotë, fushat e caktuara ku mungojnë, ku ekziston vakuumi ligjor për këtë çështje. Qeveria e Republikës së Kosovës që 14 muaj e ka marrë mandatin. Do të thotë, na u ka dashur një vit e gjysmë që ta bëjmë incizimin e këtyre defekteve në mos funksionimin dhe në mos zbatimin e këtij ligji. Por, këtu dëmtohet shumë edhe cilësia e shërbimeve shëndetësore, po dëmtohet edhe pacienti kosovar.

Pastaj, te problemet e identifikuar në institucionet private shëndetësore. Do të thotë këto janë të gjeturat faktike që i ka bërë Komisioni. Institucionet private të kujdesit shëndetësorë ushtrojnë veprimtaritë shëndetësore pa licencë të lëshuar nga bordi. Kjo nuk guxon të ndodhë dhe kësaj duhet t'i jepet përgjigje njëherë e mirë.

Pastaj, shumica e institucioneve private nuk i plotësojnë kushtet e përgjithshme minimale të institucioneve lidhur me hapësirën, personelin, pajisjen mjekësore e të tjera. Do të

thotë, mosrespektimi edhe i kushteve të hapësirës teknike, pajisja e të tjera, po ndikojnë drejtpërdrejt në ofrimin e shërbimeve shëndetësore cilësore.

Pastaj, shumica e institucioneve private shëndetësore nuk kanë të ruajtura dokumentacionet dhe regjistrat mjekësorë. Kjo është e pafalshme. Si guxon që një pacient të operohet në një institucion privat shëndetësor dhe mos të ketë ekzaminimet laboratorike, diagnozën dhe terapinë. Sepse, pacienti mund të pësojë dhe kush do të japë përgjegjësi. A funksionon shteti këtu dhe cilat janë hallkat ndërinstitucionale.

Nganjëherë edhe kolegët e Komisionit për Shëndetësi nga pozita raportojnë thuaja se në shëndetësi çdo gjë është duke shkuar si duhet dhe nuk ka asnjë problem. Dhe këtu po vërehen diskrepanca sepse ne marrim vesh nga pak nga sistemi shëndetësor dhe qytetarët e pacientët po edhe mediat që çdo ditë na i hapin sytë me gjendjen në shëndetësi.

Te rekomandimet: “Ministria e Shëndetësisë miratoi planin e rrjetit të institucioneve”. Këto janë kritere që dalin edhe nga Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe çdo shtet normal duhet ta bëjë këtë punë dhe ky është një rekomandim për mua shumë latent. Ministria e Shëndetësisë themeloi Fondin e Sigurimeve Shëndetësore. Jo Ministria e Shëndetësisë! Kuvendi i Republikës së Kosovës, duhet ta rishqyrtojë Ligjin për sigurimet shëndetësore dhe konform atij ligji atëherë Ministria duhet të marrë hapa.

Pastaj, te rekomandimet e tjera: “Institucionet private shëndetësore të mos licencohen pa përmbushjen e kushteve të përgjithshme minimale të institucioneve”. Tani, zoti ministër, kush guxon që një institucion privat shëndetësor ta licencojë pa i plotësuar kushtet. Do të thotë, këto janë fare mirë të rregulluara. Edhe pse ka mangësi ky ligj aktual që është në fuqi, jemi të obliguar edhe kur ligji nuk është mbase konform trendeve të kohës, ai që është dhe ato akte ligjore që janë në fuqi, duhet të respektohen. Nëse institucioni privat shëndetësor nuk i respekton, janë masat tjera konform po këtij legjislacioni në fuqi.

Zoti ministër, ju keni bërë përpjekje tani edhe me rishqyrtimin edhe të Ligjit bazik, po edhe të këtij ligji, por edhe të Ligjit për sigurimet shëndetësore. Unë, duke i parë të gjeturat e këtij raporti, po edhe komentet tuaja, si deputet dhe si qytetar i Kosovës më intereson, a keni filluar një strategji të re konkrete, apo e keni pasur një plan të punës kur keni ardhur si ministër dhe kur Qeveria, pjesë e së cilës jeni ju, e ka marrë mandatin. Sepse, emërimi nga ana e Kryeministrit i një superkëshilltari që ta nxjerrë gjëja Kosovën dhe sistemin shëndetësor të Kosovës nga kjo krizë, po ju demanton juve që çdo gjë në shëndetësi është okej, por edhe vetë Kryeministrin e Qeverisë së Kosovës. Andaj, në këtë kuptim, unë ju inkurajoj që të merrni hapa konkretë, sepse jeni në gjysmën e mandatit qeverisës dhe gjendja në shëndetësi askush nuk mund të thotë se është e mirë, bile – bile statistikatat e fundit dhe raportet që vijnë edhe nga mekanizma vendorë relevantë, por edhe nga profesionistët shëndetësorë, po edhe punëtorët e kujdesit parësor shëndetësorë, që sot përmes mediave prapë kërcënojnë me grevë, ua keni premtuar ato 44 euro të shkreta dhe ende nuk po implementohen, fjala e Kryetarit, e Kryeministrit, e ministrit, jeni përfaqësues institucional, ka përgjegjësi dhe i ka pasojat e veta dhe të gjitha këto prolongime, moszbatueshmëria e legjislacionit në fuqi është duke degraduar dita-ditës sistemin shëndetësor të vendit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Ligji për praksën private apo për veprimtarinë private shëndetësore që nga viti 2004 është parë qartë nga monitorimi ynë që ka hasur në vështirësi në implementimin e tij. Këtë e them nga fakti për dy apo tri arsye që do t'i ceku tani me radhë.

Vështirësitë që janë hasur gjatë kësaj periudhe kanë pasur të bëjnë kryesisht me këto çështje duke marrë parasysh numrin e madh të institucioneve që kanë aplikuar për një kohë të shkurtër për licencim. Domethënë, sipas shënimeve që kemi marrë nga Ministria e Shëndetësisë, kemi pasur 850 aplikime për licencim, që i bie nga dy institucione për çdo ditë pune. Organizimi kompleks dhe gjithëpërfshirës i aktivitetit të vlerësimit nga ana e komisioneve vlerësuese dhe, ajo që e ceku edhe ministri, çështja e pazgjidhur e pagesave të mëditjeve për komisione.

Unë mendoj që vështirësia kryesore dhe që do ta përcjellë nëse nuk ndryshohet ligji, është ndarja apo ushtrimi i njëkohshëm i veprimtarisë private shëndetësore dhe të asaj publike për profesionistët shëndetësorë. Pse e them këtë? Sepse, duke llogaritur që ne kemi 850 institucione të licencuara së paku me nga 2 mjekë, në përgjithësi i bie diku 1.700 mjekë që duhet të jenë njëkohësisht në dy vende pune, zotëri ministër, dhe ndoshta kjo do të jetë një pyetje e cila edhe kërkon përgjigje.

Përpos ligjit, ka edhe mjaft udhëzime administrative për veprimtarinë private në shëndetësi, por ato duhet respektuar. Në rend të parë, unë mendoj nga ata që përfshihen në veprimtarinë private, profesionistët shëndetësorë, por këtu duke mos anashkaluar edhe vetë qytetarët e Republikës së Kosovës. Pse e them këtë? Ligjet i kritikojnë edhe individët që vetë ata janë përgjegjës për zbatimin dhe përmirësimin e tyre. Në dëgjimin e fundit publik që ka pasur Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, unë gjatë marrjes apo shikimit të udhëzimeve administrative e kam parë se një mjek profesionist, i cili kritikonte Ministrinë e Shëndetësisë, ishte vetë hartues i Udhëzimit administrativ për kujdesin spitalor. Dhe, kritikata e tij binin ndesh me atë që vetë ishte edhe hartues.

Të nderuar kolegë deputetë,

Në këtë Kuvend ka mjek apo familjar të ngushtë që kanë përvoja edhe me ordinancat e veta private dhe unë nuk i kam dëgjuar të kontribuojnë rreth avancimit edhe të këtij Ligji të praksës private, sepse ata vetë do të kontribuonin njëjtë edhe në ngritjen e buxhetit përmes pagesave të tatimeve. Asnjëherë, ndoshta edhe këtë pyetje do t'ia drejtoj Kryeministrit, a keni ju ndonjë deklaram së paku moral rreth shërbimeve të ofruara, të çmimeve që përdoren në ordinancat e veta dhe, fundja, le të na tregojnë se si mund të përmirësojmë praksën private edhe gjatë hartimeve të ligjeve dhe të udhëzimeve administrative.

Vetëm Inspektorati që punon në Ministrinë e Shëndetësisë nuk është në gjendje dhe atë e dimë edhe ne që nuk është në gjendje ta mbulojë gjithë këtë veprimtari, duke marrë parasysh 850 ordinanca, spitale dhe shumë të tjera që veprojnë në territorin e Republikës së Kosovës.

Qytetari duhet ta marrë faturën me çka identifikohet shërbimi dhe lartësia e pagesa e këtij shërbimi. Po flas për atë që quhet çmimorja e unifikuar, që edhe ne nuk e kemi hasur gjatë monitorimit të ligjit në asnjë institucion të cilat ofrojnë se janë të licencuara, por edhe ato të pa licencuara.

Sa prej mjekëve kanë marrë kritika profesionale nga kolegët e vet për punë jo profesionale? Këtë, së paku unë, ndoshta jam gabim, por shumë pak e kam dëgjuar apo mos të them fare dhe sa janë në gjendje që 3 zyrtarë apo 6 zyrtarë të Ministrisë së Shëndetësisë ta bëjnë këtë për qindra-mijëra mjekë në Kosovë.

Këtë e them, sepse e di që ekziston ai kodi etik, apo betimi që bëhet i Hipokratit. Këtë nuk do ta thosha për hapjen e ndonjë konflikti në mes mjekëve, por për respektim dhe vlerësim të punës profesionale në dobi të qytetarëve dhe nga vetë mjekët.

E thashë edhe një herë, një nga faktorët kyç për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore dhe çrrënjësjes së korrupsionit në shëndetësi, është ndarja e praksës private nga ajo publike.

Konsideroj se qytetarët e Republikës së Kosovës, nën përkujdesjen publike shëndetësore duhet të kenë shërbime më të mira shëndetësore, me personel të mjaftueshëm dhe profesional, si dhe barna e material të mjaftueshëm shpenzues medicinal, jo të keqpërdoret apo nga ato që dëgjuam, që shumë herë pajisjet medicinale, barnat e ofruara nga institucionet publike gjenden edhe në ato që ushtrojnë veprimtari private. Është koha që të gjithë, sidomos mjekët të orientohen në njërën drejtim të ofrimit të shërbimeve, ose të praksës private, ose në atë publike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Zemaj. Zoti ministër e ka kërkuar fjalën.

MINISTRI ALUSH GASHI: Faleminderit, i nderuari kryesues! Mendoj se ka qenë vendim i drejtë i Komisionit për Shëndetësi që ta monitorojë këtë ligj kaq të rëndësishëm. Rekomandimet dhe në veçanti debati konstruktiv ku kjo temë shikohet si interes nacional dhe në debatin e sotëm pa ngjyrimë politike, është një mbështetje e fuqishme për reformat që i kemi filluar.

Pajtohem me të gjithë diskutuesit se derisa ligji të jetë në fuqi, ne do ta zbatojmë me përpikëri. Për disa çështje të cilat këtu u biseduan, janë të rëndësishme. Ndoshta është faji i Ministrisë që nuk u kemi informuar më drejtpërdrejt si deputetë të interesuar, sepse ato udhëzime administrative, akte nënligjore ekzistojnë. Prandaj, jam shumë i inkurajuar sot me interesimin dhe mbështetjen që ju i jepni procesit të reformave. Ne kemi program konkret si ministri. Viti i parë, se kjo zoti kryesues, del nga tema, por më lejoni vetëm gjysmë minute, ka qenë përkushtim për ndalje të degradimit në shëndetësi dhe këtë punë e kemi arritur me shumë mund. I kemi bërë të gjitha përgatitjet për reformë legjislative, janë formuar grupet, kemi dhënë agjendën legjislative, e ka miratuar Qeveria dhe Kuvendi atë agjendë dhe ne do ta zbatojmë me përpikëri. Rreth kësaj i kemi të gjitha studimet vendore dhe ndërkombëtare për 4-5 çështje të rëndësishme për shëndetësi të çdo vendi, e po ashtu edhe të vendit tonë. Dhe, tash problemin e kemi në koston për realizim të këtyre projekteve. Ne kemi Master- planin e shëndetësisë për Republikën e Kosovës, për 3 nivele. Kostoja buxhetore është e tillë, sa është shumë vështirë ta sjellim në Kuvend. Master-planin duhet ta miratojë Kuvendi. Ju do ta keni. E kemi të punuar me Bankën Botërore. Kemi pasur 2 debate publike për te dhe para se të ofrohet këtu, problemet qëndrojnë në kostot buxhetore të atij master-plani.

Më lejoni vetëm me 2-3 fjali. Rrjetin e sistemit primar e lavdërojnë ekspertët ndërkombëtarë. Është arritur ndërtimi i një rrjeti shumë të mirë të mjekësisë primare. Po ashtu, edhe të mjekësisë sekondare. Problemi qëndron me Prishtinën. Prishtina është i vetmi qytet apo kryeqytet, i cili nuk ka spital të qytetit. Numri më i vogël i shtretërve që

rekomandohet nga ekspertë të Bankës Botërore, por që nuk kundërshtohet as nga Organizata Botërore Shëndetësore, as nga institucionet e Unionit Evropian, të cilat janë duke na ndihmuar ta bëjmë rishikimin funksional të tërë sistemit, që do të jetë së paku 600 deri në 900 shtretër. 600 a 900 shtretër kërkojnë një rritje të të punësuarve enorm. Them enorm, sepse ky Kuvend nuk ka pasur fuqi të m'i lejojë 16 punëtorë për shëndetin mendor në buxhetin e vitit 2009 dhe është dashur që të shuhen 3 punkte të shëndetit mendor për 16 punëtorë. Nëse duhet kostoja buxhetore për spitalin e Prishtinës, spitalin e Shtëpcës, spitalin e Graçanicës, integrimin e spitalit të veriut, fillimin e punës në spitalin e jugut në Mitrovicë, numri më i vogël i të punësuarve që duhet të lejojë ky Kuvend, është 1450. Ju s'keni pasur forcë të m'i lejoni 16. Jo që s'keni dashur, por numrat ishin vështirësi.

E kemi përgatitur revidimin e të gjitha strategjive sektoriale. Do t'ua sjellim, por kostoja për implementimin e tyre, të nderuar zonja e zotërinj deputetë, është e tillë që ne si Kuvend kemi për të pasur shumë vështirësi ta realizojmë. Kjo nuk do të thotë se ne nuk do t'i kryejmë punët aq sa ka mundësi.

Një prej problemeve që duket shumë banale, është pagesa e komisioneve. Njerëzit që punojnë jashtë orarit të punës. Këtu është formuar perceptio se kur paguhet ajo kostoja për licencë, nga ajo paguhet punëtorët. Jo! Ligji që është në fuqi për menaxhimin e financave publike, nuk lejon të preket një cent. Andaj, e kemi vështirësi reale se si do ta vazhdojmë që njerëzit të mos presin më tepër se sa është e paraparë me ligj. Ju them se 6 muaj janë duke punuar falas, në lutje. Ajo çka sot dëgjova gati dy herë apo një herë e gjysmë nga deputetët, është se nuk ka komisione për vlerësim. Jo, komisionet për vlerësim janë dhe prej kësaj është edhe bordi. Një deputet i nderuar i AKR-së e theksoi me të drejtë se vlerësimin për këtë punë nga 5 anëtarë, 4 janë që s'janë punëtorë shëndetësorë. Nuk janë në kuadër të Ministrisë, prandaj është pak problem se si t'i motivojmë që të punojnë vullnetarisht.

Dhe, një çështje për të cilën ishte një debat shumë i rëndë medial, ju kujtohet, në vjeshtë, ka qenë debati publik për çmime. Dhe, më vjen mirë që tash deputetët i kërkojnë çmimet. Ne kemi përgatitur një çmimore të përkohshme, e cila do të na ndihmojë që këto sigurime private shëndetësore të cilat bëjnë pagesa, njerëzit i blejnë dhe nuk është sekret. Shumicën e shërbimeve që ata ua japin, ndodhë në spitale publike, të cilat nuk faturojnë. Çmimoren do t'ua sjellim, e kemi të gatshme.

Është shumë interesant se përgatitja e ekspertëve ka dërguar një porosi shumë interesante sa i përket çmimeve. Nën një, janë marrë modelet se dituria është në sistemin terciar, domethënë Qendër Klinike Universitare. Duhet intervenimet të kushtojnë më së shumti, apo shërbimet. Dhe, kur është analizuar, ekspertët kanë ardhur në përfundim se këta po i ngritin çmimet si institucion publik për të shkuar në institucion privat. Unë nuk e di a është ashtu, por udhëzimi për ekspertë është që institucioni publik të jetë jo profitabil, por të mbulohet një pjesë e shpenzimeve të cilat i kemi.

Nuk është më sekret konflikti i interesit i atyre që janë drejtorë në spitalin publik dhe drejtorë në spitalin privat. Dhe, ata janë, zonja e zotërinj, që janë më të shpeshtit në medime elektronike dhe private. Në një ditë kur është alarmuar krejt vendi se ekziston vetëm një anestetik brenda dite, Departamenti i Farmacisë me Qendrën, me njeriun kryesor që e kanë, kanë konstatuar se janë 14. Në kohën kur deklarohet se nuk ka film për një CT apo një rëntgen, kur të njëjtën kohë ne kemi lejuar që të jepet CT dhe të bëhet ekzaminimi, konstatohet se ka pasur ekzaminime. Prandaj, të gjitha këto ne na shtyjnë që

të lusim komisionin, grupin punues për shëndetësi, i cili nesër në ora 10 e ka edhe debatin publik për këtë ligj, që sa më parë në Kuvend ta sjellë Ligjin për shëndetësi dhe Kuvendi të vendosë a do të vazhdojmë me këtë sistem, ku punëtorët e institucioneve shëndetësore publike kanë të drejtë gjysmë orari të punojnë apo do ta bëjmë këtë ndarje, apo do të ketë edhe një model i tretë, i cili është në vendet e avancuara.

Mua më vjen shumë mirë për entuziazmin e deputetëve që ne të kemi një sistem shëndetësor informativ digjital. Jo, nuk e kemi. Jo. Ky Kuvend për vitin 2009 i ka lejuar 200.000 euro për sistemin informativ shëndetësor. Mos m'i kërkonit të hollat që s'mi keni dhënë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Fjalën e ka deputetja Edita Tahiri.

EDITA TAHIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Deputetë të nderuar,
Ministra,

Po më vjen mirë që prej kohës kur kemi diskutuar për gjendjen në shëndetësi, situata është parë në mënyrë serioze dhe janë marrë masa edhe nga vetë Kuvendi i Kosovës, por edhe nga ana e Ministrisë dhe e ministrit për të bërë përpjekje për tejkalimin e gjendjes. Gjendja natyrisht ende nuk është ndryshuar. Problemet e evidentuara në sektorin privat kanë qenë shumë të rënda, disa madje ishin edhe skandaloze, të cilat në atë kohë nuk u menaxhuan me një qasje të duhur institucionale dhe po më vjen mirë që tash po hetoj një qasje, do të thosha më serioze në kuptimin e vendosjes së një rendi në këtë kaos të tregut të shërbimeve shëndetësore private.

Ma merr mendja se me faktin që ishin licencuar në bazë të raportit të Qeverisë mbi 85% të veprimtarive private, del se gjendja është e përmirësuar dhe mendoj se veprimtaria e Ministrisë, por edhe e Parlamentit duhet të shkojë drejt nivelit të efikasitetit për mbikëqyrjen e punës së këtyre institucioneve si në kuptimin e pengimit apo të ndëshkimit të veprimtarive eventuale ilegale, ashtu edhe në kuptimin e kërimit të cilësisë së nevojshme për dhënie të shërbimeve të mira qytetarëve të Kosovës.

Mirëpo, ajo që unë në fakt u motivova që të flas, ishte vetë fjalimi i ministrit, i cili mbase në bazë të të dhënave duket se e njuh mirë problemin e korrupsionit, që po ndodhë brenda sektorit të shëndetësisë në përgjithësi, dhe ashtu siç ai e definoi, mendoj se një prej problemeve është këmbimi i interesave publike në dobi të interesave private dhe, në anën tjetër, nga fjalimi i ministrit u pa që i di edhe emrat e njerëzve.

Unë pyes së pari ministrin, pse duhet të vonohet me emra. Kur duhet institucionet e Kosovës t'i adresojnë problemet në esencë dhe unë mendoj se pas një qeverisje një vit e gjysmë, ka ardhur koha që të flasim edhe me emra. Në qoftë se dukurive që dëmtojnë qeverisjen e Kosovës nuk iu jepet adresa e duhur, nuk ma merr mendja se mund të kemi rritje të efikasitetit apo mirëqeverisje në nivelin dhe formën që e dëshirojmë ne. Prandaj, në këtë rast kisha dashur që ministri të jetë më konkret, jo vetëm në emërimin e individëve, por në anën tjetër edhe në veprim, sepse ministri dhe ministria janë instanca e fundit dhe ekzekutive. Pra, ministri s'mund t'i kërkojë dikujt tjetër ndihmë për këtë punë, përveç se vetë të veprojnë. Për shembull, rasti që e përmendi tash, që paska pasur anestetikë, s'ka pasur e të tjera. Nëse dihen këto gjëra, duhet të merren masa ndëshkimi. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë,

Është një punë e mirë e komisionit në monitorimin e këtij ligji. Unë do të përqendrohem vetëm në disa çështje të cilat ndoshta më tepër do t'i shtroj në çështjet e pyetjeve për ministrin se sa në komente. Në faqen 12 të këtij raporti, zoti ministër, keni probleme të identifikuar në institucionet private të shëndetësisë. Unë po preku vetëm disa prej këtyre çështjeve. E para thotë, "Institucionet private të kujdesit shëndetësorë ushtrojnë veprimtari shëndetësore pa licencë të lëshuar nga bordi". Cilat janë veprimet e Ministrisë dhe sa prej këtyre institucioneve private, të cilat kanë punuar pa licencë dhe vazhdojnë edhe sot e kësaj dite të punojnë, pa licencë, cilat veprime i ka ndërmarrë Ministria ndaj tyre dhe ku është gjendja.

E dyta, "Shumica e institucioneve private nuk i plotësojnë kushtet e përgjithshme minimale të institucioneve lidhur me hapësirën, personelin dhe pajisjen mjekësore". Zoti ministër dhe të gjithë ata që janë të involvuar në zbatimin e këtij ligji, edhe këtu - cilat janë veprimet konkrete të Ministrisë dhe a do të duhej që të gjitha këto të mbylleshin dhe dikush të përgjigjej, sepse ju keni parasysh që një numër i pacientëve kanë pësuar fatalisht për shkak se shumica e institucioneve private nuk i plotësojnë kushtet e përgjithshme. Keni të bëni me raste të ndryshme të cilat janë paraqitur.

Shumica e institucioneve private shëndetësore nuk i kanë të ruajtura dokumentacionin dhe regjistrat mjekësorë, ndërkaq Ligji e obligon jo vetëm gjatë kohës kur është funksional institucioni privat shëndetësor, por edhe pasi që të mbyllet institucioni privat shëndetësor, t'i ruajë. Shumica e institucioneve private nuk kanë siguruar menaxhimin e përshtatshëm të mbeturinave, e tjera.

Ajo që mua më intereson dhe besoj edhe të tjerëve, është se cilat janë veprimet e Ministrisë, kush dhe sa janë përgjigjur para ligjit përkitazi me to. Dhe, nëse është identifikuar një numër kaq i madh i problemeve në shëndetësinë private, atëherë besoj se Ministria do të duhej të raportonte para Kuvendit për të gjitha ato të gjetura dhe të gjitha pasojat për ata që i kanë shkelur ligjet.

Ju përmendet disa herë në fjalën tuaj, zoti ministër, se "për shumë çështje janë përgatitur, i kemi përgatitur, janë në përgatitje e sipër..." Natyrisht, qytetarit nuk i intereson shumë se çka përgatisim ne si Kuvend ose Qeveria. Qytetarit i intereson në praktikë se cili është ndryshimi dhe cili është veprimi konkret.

Dhe, në fund, do ta përmbyll me nevojën e domosdoshme urgjente që të ndërtohet Ligji për sigurime shëndetësore, sepse jemi vend i vetëm që, merreni me mend, i kemi të siguruara automjetet, ndërkaq shëndetin tonë nuk e kemi të siguar dhe është momenti i fundit kur Ministria do të duhej të mendonte për hartimin e këtij ligji, në mënyrë që edhe qytetarët e Kosovës, edhe qytetarët e këtij vendi të kenë sigurime shëndetësore, të cilat gjithsesi do ta lehtësonin gjendjen e tyre.

Dhe, për fund, zoti ministër, ju e dini këtë gjendje në shëndetësinë private. Në momentet kur ne kemi mjaft mjekë të cilët janë edhe drejtorë të shtëpive të shëndetit ose të klinikave dhe njëkohësisht janë pronarë të institucioneve të tilla, a do të duhej dhe a duhet që Ministria të ndërmarrë veprime gjithnjë në mbështetje të ligjit sa u përket shkeljeve ligjore që ndodhin nga ata. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ministri do një përgjigje ta japë. Ke të drejtë!

MINISTRI ALUSH GASHI: Faleminderit shumë!

Sa i përket asaj se çka ndërmerret me institucionet private shëndetësore të palicencuara? Ato mbyllen! Nëse Inspektorati Shëndetësor i Republikës së Kosovës konstaton që dikush është duke ushtruar veprimtari shëndetësore private pa licencë, atë e mbyll.

Ne kemi një vështirësi reale. Para se i interesuari për të hapur spital apo praksë private të vijë për të aplikuar për të, ai e regjistron biznesin në Ministri të Tregtisë e të Industrisë dhe ti nuk je në dijeni kur ai e fillon, ku e fillon? Për këtë ka përvoja të ndryshme. Organizata Botërore e Shëndetësisë, në një prej rekomandimeve ka rekomanduar themelimin e Njesisë së Inteligjencës pranë Ministrisë së Shëndetësisë për hulumtim të këtyre rasteve. Unë mund t'ua jap raportin e vitit 2008 për të gjitha institucionet shëndetësore private që janë licencuar, sa dënime janë shqiptuar, cila është lartësia e tyre, cila është procedura. Këtu janë po ashtu edhe ato për vitin 2009 dhe këtu i kemi të gjitha.

Sa u përket kushteve, unë pajtohem me ju, pajtohem edhe me Komisionin se ata kanë një qasje më të butë, sepse janë të ndërgjegjshëm se këto institucione të cilat deri sot kanë vepruar pa licencë, është mirë të vihen në sistem me kushte optimale dhe pas asaj, gjatë inspektimit, të ngrihen kapacitetet. Do të thotë, të ngrihet hapësira. Këtë çështje edhe unë e kam ngritur. Nëse duhet hapësira ose lartësia e murit të jetë 2 metra e 60 centimetra dhe nëse e kanë licencuar me 2.40, unë s'e kam refuzuar atë licencë. Me ligj ishte dashur të kërkohej 2.60, por qëllimi është që ata të hyjnë së pari në sistem.

Një gjë është shumë inkurajuese se pas fillimit të inspektimeve intensive vitin e kaluar, pas pyetjeve parlamentare në Kuvend, pas debatit si dhe pas fillimit të veprimit të institucioneve tjera juridike, është rritur dukshëm numri i të interesuarve për licencim. E njëjta gjë është edhe për regjistrimin e barnave, ku në vit i kemi pasur të regjistruara vetëm 300 produkte, tash kjo ka kaluar pesëfishin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër! Fjalën e ka deputetja Brovina.

FLORA BROVINA: Ju faleminderit!

Përsëritje kryesues,

Ministra,

Kolegë dhe kolege,

Shumë gjëra tanimë u thanë edhe nga ana e ministrit, edhe nga diskutuesit. Sektori privat shëndetësor është pjesë e shëndetësisë dhe me këtë nuk thashë asgjë e veçantë. E veçantë është se sektorin privat e shohim me një sy tjetër nga sektori publik dhe kjo është një e metë e trashëguar nga sistemi politik i kaluar, kur nuk kishim dy sektorë.

Ky sektor, në rend të parë sektori privat, pra, zgjon dhe sjell konkurrencën pozitive në shëndetësi. Sa më i zhvilluar të jetë sektori privat në një vend, konkurrenca është më e madhe dhe e nxit sektorin publik që të zhvillohet domosdo. Dhe kjo, natyrisht, shkon në favor të pacientit.

Raporti i Komisionit dhe përgjigja që e dha ministri dhe që u theksua se shumë rekomandime janë realizuar nga ana e Ministrisë, tregon se sa i rëndësishëm është monitorimi i ligjeve në përgjithësi për zbatimin e tyre. Madje, ky shembull është një shembull shkollor, ku shihet se vetëm gjatë periudhës së monitorimit dhe para nxjerrjes

së konkluzioneve nga ana e Komisionit, ka filluar zbatimi i tyre, i vërejtjeve që janë thënë në kontakt me institucionet shëndetësore, për shembull, vetë licencimi i institucioneve private. Sektorit privat në shëndetësi u pa, i mungon strategjia e zhvillimit. Në anën tjetër, shihet se këtij sektori i mungon politika e zhvillimit dhe këto janë shumë të rëndësishme.

Një çështje tjetër, që nuk u tha dhe nuk është theksuar në konkluzione, është çështja e partneritetit publiko-privat në shëndetësi, e që është një domosdoshmëri.

Së pari, të gjithë e dimë se kjo është formë e leverdishme edhe për shkak të kostos që mund ta zbusë, sepse shëndetësia ka nevoja shumë të mëdha për materiale, për një zhvillim më të mirë. Që të ndërrohet infrastruktura më e qëndrueshme dhe të kemi një efikasitet më të mirë, ne duhet të lejojmë edhe sektorin ose partneritetin publiko-privat. Kjo është një përvojë që shtetet edhe në regjion, po edhe tjerat më të zhvilluara, e kanë, madje po tregohet shumë e suksesshme.

Mund të ekzistojnë metoda për kontrollimin e kësaj, sepse këtu u dhanë shumë vërejtje për njerëzit që punojnë në sektorin publik dhe njëkohësisht punojnë edhe në sektorin privat. Kjo është një çështje tjetër. Partneriteti nuk do të thotë që ai të punojë në dy sektorë, por të lidhë marrëdhënie në mes sektorit privat dhe sektorit publik. Kjo, natyrisht, nënkupton edhe shumë lëmi, jo vetëm në shfrytëzimin e objekteve, që ju zoti ministër e thatë se shumë objekte ju kanë mbetur pa kuadër për shkak të mungesës së mjeteve. Pse mos t'i ofrohet partneriteti sektorit publik që t'i shfrytëzojë këto kuadro në mënyrë të leverdishme.

E dyta, ky partneritet do të mundësonte investime në sektorë në përgjithësi. Do të mundësonte arsimin dhe trajnimin e kapaciteteve dhe të shërbimeve, që e thashë, të ndërlidhura. Besoj se kjo do të merret parasysh edhe në konkluzione, por do të merret parasysh edhe në ndryshimin e Ligjit për shëndetësi dhe ndryshimin e Ligjit për shëndetin privat. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Diskutuesi i fundit në emër të Komisionit është zoti Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Hvala!

Ja se zahvaljujem svim diskutantima, sa jednom napomenom da se ovde raspravlja o Izveštaju komisija, a ne o kompletnom zdravstvenom sektoru i to je znači za drugu priliku, za interpelaciju, za izveštaj o godišnjem radu Vlade i ministarstva.

Kolega Bahri Hyseni je našao neke primedbe u vezi ovih naših preporuka. Mislim da se one baziraju i skoro kod svake preporuke dato je na koji se član zakona odnosi, odnosno ako se odnosi na administrativno uputstvo. Ove preporuke se ne odnose samo na Ministarstvo. Jedan dobar deo se odnosi na zdravstvene privatne institucije, koje treba da ispune one svoje obaveze koje imaju i koje dobijaju prilikom licenciranja. Znači, od 1 do 16 su preporuke koje se odnose na Ministarstvo, a od 17 do 22 su preporuke koje se odnose na privatne zdravstvene institucije.

Inače, privatni sektor je suočen od početka sa problemom. Kada je donet zakon i kada smo doneli prva administrativna uputstva, imali smo problema i sa opštinama koje nisu htele da delegiraju svoje članove u komisije. Recimo, imali smo primer Prištine, koja je odbijala gotovo godinu dana da da svoje članove u komisiji. Prizren, Podujevo, jer je to bilo od prilike, smatrali su da mogu da menadžiraju sami, da sami vrše licenciranje

institucija u primarnom sektoru, a zakon je drugačije regulisao i to je oduzelo puno vremena u početku.

Takodje, želim da kažem da će Komisija u daljem radu dati svoj doprinos, jer u ovoj godini samo iz zdravstva imamo 7 zakona, odnosno neke su izmene postojećih zakona.

Znači, mi ćemo dati svoj doprinos posebno i u ovom zakonu koji smo monitorisali. Napominjem da neke stvari su se u međuvremenu promenile zato što je početak monitorisanja bio u julu prošle godine, a u međuvremenu su neke stvari odradjene i mi nismo mogli da, ako je nešto pomenuto u našim preporukama, uradjeno i to je pozitivno. Ne znači to da mi sada trebamo da menjamo svakoga dana u hodu. Znači, naš je cilj da se sa ovim preporukama upozna i Ministarstvo i oni koji su odgovorni, odnosno na koga se odnose ove preporuke.

Nešto što je jedno administrativno uputstvo, koje sam ja potpisao u odlasku, znači kao ministar, a koje se odnosi na licenciranje bolnica i u tom administrativnom uputstvu je predviđeno da se ne mogu licencirati bolnice ukoliko privatne bolnice nisu udaljene kilometar i po od ovih postojećih bolnica. Mislim da je to jedna zapreka i da to stvara probleme onima koji već imaju privatne bolnice, odnosno koji imaju zgrade u blizini kilometar i po od bolnice. Mislim da bi trebalo da se prometi, jer ja sam to potpisao i sigurno da nisam pogledao da to stoji, mada u zakonu o privatnoj delatnosti postoji mogućnost da ove javne bolnice izdaju pod zakup privatnicima, znači svoje prostorije, a ovo je u suprotnosti sa tim. Znači, to je bilo jedan apel Ministarstvu.

U svakom slučaju, mislim da je nadgledanje ovog zakona imalo svoj efekat i da će imati svoje rezultate na institucije na koje se odnose. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit!

Kam një kërkesë. Meqenëse sipas procedurës duhet ta votojmë raportin për ta miratuar, kryetarët e grupeve parlamentare ose zëvendësit e tyre pasi që ta shpallim pauzën, i kisha lutur që të shkojnë në zyrën e kryetarit për një konsultë të shkurtër, bashkë me deputetin Koci.

Tani, sipas Rregullores, po e qesim në votim për ta miratuar Raportin e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për zbatimin e Ligjit për veprimtarinë private në shëndetësi.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tani:

Konstatohet se me 63 vota “për” miratohet Raporti i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për zbatimin e Ligjit për veprimtarinë private në shëndetësi.

Tani do të kemi një pauzë deri në orën 14,20 minuta. Faleminderit!

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Të nderuar deputetë, kuorum për të vazhduar seancën kemi. Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar apo të konfiskuar

Në bazë të Rregullës 35 pika 1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministren e Drejtësisë, zonjën Nekibe Kelmendi, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin. Ju kisha lutur për qetësi, nëse bën. Zonja ministre, e keni fjalën!

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: I nderuari, kryesues i seancës parlamentare.

Të nderuar deputetë,

Ministria e Drejtësisë për vitin 2009 ka në strategjinë legislative hartimin e Projektligjit për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar apo të konfiskuar, prandaj sot para jush kam nderin ta prezantoj këtë projektligj, për të cilin do të jap një ekspozitë të shkurtër.

Hartimi dhe miratimi i këtij projektligji ka rëndësi të veçantë, meqë për po thuaj një dekadë ka pasur vakum juridik në fushën e menaxhimit të pasurisë së sekuestruar apo të konfiskuar, të cilat janë të parapara me Kodin penal dhe me ligje të tjera, të cilat shqiptohen përveç dënimit të caktuar, pra shqiptohen si masa të veçanta.

Fushëveprimi dhe qëllimi i Projektligjit është themelimi i Agjencisë për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar apo të konfiskuar, që do të veprojë si Agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. Njëherësh, me këtë ligj përcaktohen edhe detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë.

Agjencia ruan dhe menaxhon pasurinë e sekuestruar apo të konfiskuar në bashkëpunim me prokurorinë, gjykatën apo organet tjera kompetente të cilat zbatojnë ligjet në fuqi.

Përfundim nga menaxhimi, sipas këtij projektligji, bën pasuria e konfiskuar për realizimin dhe mbledhjen e detyrimeve tatimore. Agjencia i raporton ministrit për punën e vet dy herë në vit apo më shpesh, nëse këtë e kërkon ministri. Agjencioni gjatë ushtrimit të përgjegjësisë të veta ndihmon ekzekutimin e vendimeve për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë, mundëson shitjen e asaj pasurie dhe rregullon procedurat për mënyrën e veprimit me të hollat e realizuara pas shitjes së pasurisë. Rregullon shkëmbimin e informatave me personat fizikë, të cilëve u është sekuestruar apo konfiskuar pasuria.

Me këtë projektligj është përcaktuar edhe nxjerrja e udhëzimit administrativ, si akt nënligjor që e nxjerr ministri i Drejtësisë.

Ky projektligj për nga struktura nuk është voluminoz, ka gjithsej 4 kapituj të zbërthyer në 13 nene.

Projektligji është në harmoni me ligjet evropiane.

Kostoja financiare e Projektligjit është 1.200.000 euro, por me zbatimin e tij shumë shpejt do t'i nxjerrë këto shpenzime, sepse të hyrat që do të realizohen me shitjen e pasurisë së sekuestruar apo të konfiskuar do të depozitohen në xhirollogarinë bankare të Agjencisë në Autoritetin Qendror Bankar të Kosovës.

Në fund të kësaj ekspozije, lus deputetët që këtë projektligj ta miratojnë në lexim të parë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja ministre!

Pas prezantimit të Projektligjit, sipas Rregullores, e hapim debatin. Në fillim grupet parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, do të shprehet deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë do të flas edhe në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

E kemi shqyrtuar me vëmendje edhe dje në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi Projektligjin për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar dhe me rastin e shqyrtimit kemi konstatuar se është një projektligj i një rëndësie të veçantë sepse për herë të parë në Kosovë do të themelohet një Agjenci që do të mbikëqyrë apo menaxhojë pasurinë e cila sekuestrohet apo konfiskohet pas ndonjë vendimi të formës së prerë nga organet e drejtësisë.

Nga ajo që kemi parë në ligj, konsiderojmë se ligji është i hartuar mirë, e ka një përmbajtje të qartë juridike. Mirëpo, megjithatë konsiderojmë se Ligjit i mungojnë ndoshta edhe çështjet procedurale, nuk janë rregulluar, duke marrë parasysh që për herë të parë po e themelojmë një agjenci, flet më tepër vetëm për themelimin e agjencisë, pa i qartësuar ndoshta çështjet procedurale.

Komisioni për legjislacion, si dhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka pasur një shqetësim rreth deklaratës financiare, duke marrë parasysh që ne e kemi një deklaratë financiare për këtë projektligj, mirëpo projektligji ka implikime buxhetore dhe as në këtë mandat, as në të ardhmen nuk është në buxhetin e ministrisë përkatëse, nuk është paraparë buxhet për implementimin e këtij ligji. Dhe, natyrisht, ne kemi implementuar edhe ligje të tjera, kemi aprovuar edhe ligje të tjera në parim, të cilat kanë pasur implikime buxhetore dhe nuk e kanë pasur të qartë deklaratën financiare dhe në këtë rast jemi të mendimit edhe si grup parlamentar dhe si komision për legjislacion, të kalojë në parim projektligji, mirëpo kërkojmë që Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me Ministrinë për Ekonomi dhe Financa në rishikim të buxhetit gjithsesi të parasheh dhe të kërkojë që të ndahen mjete buxhetore për implementim, nëse aprovohet ligji edhe në leximin e dytë, sepse nuk janë të pakta ato mjete që parashihen diku mbi 1.200.000 euro. Dhe, si problem i veçantë është se nuk janë paraparë as në shpenzimet afatmesme, as në kornizën afatmesme të shpenzimeve. Dhe, kjo do të ishte pengesë serioze për implementimin në praktikë të projektligjit.

Çështje tjetër me interes është të përmendet fakti që në gjuhën shqipe është i hartuar mirë, mirëpo vërejtje ka shumë në gjuhën angleze. Ne i kemi nxjerrë disa edhe në bashkëpunim me Departamentin për standardizim, por ndoshta kjo në të ardhmen do të rregullohet.

Duke pasur parasysh edhe njëherë, që thashë, rëndësinë që e ka projektligji, ne si Grup Parlamentar dhe si Komision konsiderojmë që sot duhet të aprovohet në parim.

KRYESUESI: Faleminderit! Ishte deputeti dhe kryetari i Komisionit, Bahri Hyseni, që fjalën e kishte edhe në emër të Komisionit dhe të Grupit Parlamentar. Atëherë, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës fjalën e ka Myrvete Pantina.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Me Projektligjin për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar apo të konfiskuar synohet që të vendoset një kornizë adekuate ligjore që ka të bëjë me menaxhimin e pasurisë së sekuestruar apo të konfiskuar. Andaj, si i tillë, ky projektligj e ka rëndësinë e veçantë, meqenëse me të do të plotësohet vakuumi në infrastrukturën ligjore që ka për objekt rregullimin e këtij lëmi.

Në këtë projektligj, u përmend edhe më parë, themelohet Agjencia për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar apo të konfiskuar. Vlerësohet se me këtë projektligj do të realizohen të hyra nga shitja e pasurisë së konfiskuar dhe të sekuestruar, të cilat do të deponohen në xhirollogarinë bankare të Agjencisë në Bankën Qendrore të Kosovës.

Mirëpo, sikur që tha edhe parafolesi, edhe unë e kam një dyshim se a do të mund të implementohet ky projektligj, meqenëse me buxhetin e aprovuar për vitin 2009 kostoja shtesë buxhetore e këtij projektligji nuk është aprovuar. Kostoja shtesë e këtij projektligji nuk është planifikuar dhe nuk është përfshirë as në kornizën afatmesme të shpenzimeve 2009-2011, por duhet që kostoja shtesë buxhetore për këtë projektligj të përfshihet me rastin e freskimit të kornizës afatmesme të shpenzimeve 2009-2011 brenda buxhetit të paraparë për sektorin e drejtësisë.

Ne kontributin tonë do ta japim në kuadër të komisioneve funksionale, por desha të cek se do të ishte mirë që mjetet që do të grumbullohen nga shitja e pasurisë së sekuestruar apo të konfiskuar për këto mjete të krijohet një fond i veçantë, i cili do të përdorej për qëllime humanitare.

Lidhja Demokratike e Kosovës, vërtet Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës mendon se ky projektligj duhet të miratohet në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zonja Pantina! Në emër të AKR-së, fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Jemi shumë të vetëdijshëm për nevojën për një ligj të tillë, por unë në emër të Grupit do të paraqes disa prej shqetësimeve dhe vërejtjeve tona sa i përket Projektligjit në fjalë.

Sikurse dihet, ne pothuaj se në masën më të madhe nuk kemi lejuar që të miratohen ligje në këtë Kuvend pa mbulesë buxhetore dhe ligji për të cilin po bëhet fjalë, që kushton mbi 1.000.000 euro, që brenda dy-tri vjetëve nuk ka dhe nuk parashihet as në kornizën afatmesme shpenzimet, është vërejtja jonë e parë dhe vërejtja kryesore që i bëhet kësaj. Së dyti, kemi parasysh edhe përzgjedhjen e kompetencave në mes të institucioneve, në këtë rast, të doganës dhe të policisë, në këtë agjenci, sepse edhe dogana ka një pjesë të përgjegjësisë në këtë.

Në këtë draftligj kryesisht flitet për krijimin e agjencisë, por më së paku për formën e menaxhimit të pasurisë së konfiskuar. Dhe, në këtë vend është bërë një modë, sikurse në

një kohë kur ishte tenderomania, tash është agjenciomania, që të krijohen agjenci të tilla, të cilat me të vërtetë në shumicën e rasteve nuk kanë arritur ta arsyetojnë as vetveten.

Si Grup Parlamentar jemi në favor të kalimit në hap të parë, por kërkojmë nga Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë, si autore të këtij projektligji, që të sjellin deklaratën se ku do të gjejnë mjete buxhetore dhe pastaj do të shohim të japim kontributin tonë të mëtutjeshëm.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, zoti Maloku.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Më lejoni të them në fillim se ky ligj e plotëson një zbrazësi në infrastrukturën ligjore të deritashme që është miratuar në këtë Kuvend. Është ligj më se i nevojshëm. Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së të jap mbështetjen në parim të këtij projektligji. Të vetmin shqetësim që e ka Grupi Parlamentar i AAK-së është në lidhje me Agjencionin për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar. Thuhet që me akt nënligjor, pra që e nxjerr ministri, themelohet ky agjencion, pra struktura funksionale. Citoj nenin 3, paragrafi 2 “Struktura funksionale dhe organizative e Agjencionit rregullohet me akt të veçantë nënligjor të cilin e nxjerr ministri”. Kjo ka të bëjë me strukturën funksionale dhe organizative të agjencionit. Nuk përmendet në ligj se si emërohen drejtuesit e agjencionit, a do të jetë drjetor, a do të jetë bord i cili e udhëheq agjencionin dhe a do të jetë i tërë agjencioni nën kompetencat e ministrit apo i përgjigjet Qeverisë ose Kuvendit. Pra, kjo nuk është qartësuar, sipas mendimit tonë, të Grupit Parlamentar të AAK-së në këtë projektligj. Ne i japim mbështetje si Grup Parlamentar në parim dhe ftoj, do të thotë, komisionin parlamentar funksional dhe Ministrinë që kjo çështje të qartësohet në fazën e shqyrtimit të këtij projektligji në komisionet funksionale. Faleminderit, kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Maloku! Fjalën e ka deputeti Adem Salihaj, në emër të LDD-së.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Projektligji që e kemi para vetës ka dy aspekte. Pra, aspektin e menaxhimit me pasurinë e sekuestruar dhe të konfiskuar, po edhe themelimin e Agjencionit që do të merrej me menaxhimin e kësaj pasurie. Do të thotë, ka dy aspekte dhe vetë titulli nuk përputhet aq shumë me përmbajtjen e ligjit. Mendoj se edhe në titull ka dhe do të ketë nevojë të bëhen ndryshime.

Aspekti tjetër është se vetë Agjencioni është shumë i padefinuar. Pra, struktura e tij është shumë e pa definuar dhe sado që parashihen – 17 njerëz që do të punonin në atë agjencion, asgjë këtu nuk kemi lidhur me strukturën e tij, lidhur me mënyrën e udhëheqjes, të menaxhimit dhe të gjitha aspektet tjera.

Përveç kësaj, u tha edhe nga shumë kolegë, ka probleme në aspektet buxhetore. Sipas këtij projektligji, ky ligj nëse miratohet, do të hynte në fuqi më 1 janar 2010, kurse në deklaratën për implikimet buxhetore thuhet se parashihet buxhet edhe për 6 muajt e fundit të këtij viti. Pra, ligji hyn në fuqi vitin e ardhshëm, parashihet buxhet për këtë vit, në fakt propozohet të ketë buxhet, duhet të ketë dhe nuk ka dhe që është problemi më i madh, nuk do të ketë buxhet as për dy vitet e ardhshme, sepse nuk parashihet në kornizën

afatmesme të shpenzimeve buxhetore. Dhe, nuk është ky i vetmi problem vetëm për këtë ligj, por kemi pasur, kemi aprovuar edhe ligje tjera që nuk kanë mbulesë buxhetore dhe besoj se do të kemi përsëri gjatë këtij viti edhe ligje tjera që nuk parashihen të financohen në kornizën afatmesme të shpenzimeve buxhetore. Pra, pa i zgjidhur këto probleme, mendoj se po bëjmë ndoshta një punë të kotë pa efekt që nuk do të japë rezultate të duhura dhe para se ta miratojmë, duhet të shohim me kujdes se vërtet a ia vlen që të aprovojmë ligje që nuk do të mund të aplikohen për shkak se organet ose agjencitë që do të aplikojnë këtë ligj nuk janë të formuara dhe nuk ka buxhet për to.

Pra, duhet t'i shohim të gjitha këto aspekte dhe mendoj, në anën tjetër, që si ligj është tepër i shkurtër dhe nuk i zbërthen sa duhet aspektet që i ka, edhe çështjen e menaxhimit, por edhe çështjen e themelimit të agjencisë, por megjithatë ne do ta përkrahim, në parim, sepse është i nevojshëm që të ekzistojë si ligj në Kosovë, me kusht që të bëhen përmirësime të nevojshme dhe me kusht që të sigurohet buxheti i nevojshëm për aplikimin e tij. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, fjalën e ka deputeti Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Nacrt zakona o upravljanju zaplenjenom i konfiskovanom imovinom po prvi puta zakonski reguliše jednu čitavu infrastrukturu koja se tiče upravljanja zaplenjenom i konfiskovanom imovinom. Ovo je izuzetno značajna oblast po gotovo u post-konfliktnim društvima kako je naše. Izraz „sekvistirana“ u naslovu zakona treba brisati i zameniti drugim adekvatnim izrazom po drugom službenom jeziku jer ne postoji ovaj izraz.

Svakako da će agencija koja će upravljati ovom imovinom preuzeti veoma složenu ali osetljivu oblast. Ja se neću baviti finansijskim implikacijama koje su složene, ali i nedovoljno jasno u zakonu predstavljeni, jer su se moje kolege njome dosta bavili.

Pošto se ova oblast, pošto u stvari ova oblast ne reguliše zakonodavstvom Evropske unije, time je na nama veća obaveza da se koristimo iskustvima u ovoj oblasti onih zemalja koje su imali slična iskustva i posledice kao mi.

Tekst nacrta zakona je opterećen sa dosta nejasnih izraza, ne samo jezičke, nego i sadržajne prirode. Bez obzira što nije glomazan, u daljoj proceduri mora se pojasniti i dopuniti. Mi ga, uz navedene primedbe koje će se ugraditi u daljoj proceduri, u ime Parlamentarne grupe „7+“ podržavamo. Hvala vam!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit parlamentar „Zajedno“ Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Ponovo pozdravljam sve prisutne! Imamo pred sobom Zakon o menadžiranju konfiskovane imovine. Svi smo ovde rekli da je novina Agencija za preuzimanje i za menadžment sa konfiskovanom imovinom. Mi kao Grupa smatramo da se pojedini subjekti ovde dupliraju, te mislimo da treba ovaj zakon da ide na doradu kako bi se definisale pojedine stavke, zakonske stavke, kao što je „preuzimanje“, kao što je „žiro račun agencije“, „formiranje agencije“, kao što je implementacija budžetska povećana za milion i 200 i mislimo da treba zakon da ide na doradu. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, Radmilla Vujoviq. Ju lutem, paraqituni me kohë, e jo pasi që t'ia jap fjalën tjetër kujt.

RADMILA VUJOVIĆ: Kao što rekoše i moje prethodne kolege, ovaj zakon treba podržati, Nacrt zakona treba podržati, tako da će i Parlamentarna grupa SLS u načelu podržati zakon a doprinos ćemo dati kroz funkcionalne komisije u kojima radimo.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Hajdin Abazi.

HAJDIN ABAZI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ky projektligj vërtet ka qenë i nevojshëm dhe e mbulon një sferë që ka qenë e pa rregulluar dhe pa një përkujdesje të mirëfilltë, sepse ne e dimë që kështu ka qenë gjendja reale, prandaj është për t'u përshëndetur ky ligj dhe për ta përkrahur me qëllim që të rregullohet njëherë e mirë kjo çështje që ka të bëjë me pasurinë e sekuestruar dhe nevojitet që ajo të menaxhohet në mënyrë të definuar dhe Projektligji pikërisht përpaket ta rregullojë këtë çështje.

Është e vërtetë, sikur që e theksuan edhe parafolësit, në këtë projektligj gati më tepër se gjysma i dedikohet vetë krijimit të Agjencionit, pastaj një pjesë flet edhe për menaxhimin e kësaj pasurie. Dhe, natyrisht, për t'u realizuar ky menaxhim i mirëfilltë i pasurisë së sekuestruar, në këtë projektligj ka edhe mungesa të shumta. Një pjesë nuk është definuar mirë se si do të shkojë kjo, por sikur lihen gjëra të hapura dhe në njëfarë mënyre ka vakum që duhet të rregullohet e të plotësohet.

Unë do ta theksoj këtu një çështje se nga Projektligji rezulton se kjo do të përpaket në këtë ligj, do të thotë, përkatësisht agjencioni do të përpaket t'i rregullojë vetëm ato probleme, përkatësisht ato pasuri të sekuestruara që nga tani e tutje. Mirëpo, ne e dimë që në realitetin tonë këtu kosovar sekuestrimi i pasurive është bërë edhe më herët, që nga viti 1912 e këndej dhe është një problem shumë i thellë dhe shumë serioz në shoqërinë kosovare. Nuk e di tani si do të duhej të shkojë, por do të ishte mirë që ndoshta të mendohet edhe në këtë aspekt se a mund të bëhet diçka që të rishikohet sepse ka njerëz që i kanë tapitë e pronave dhe që i kanë pasur, ua ka sekuestruar regjimi pushtues vetëm pse kanë qenë shqiptarë dhe jo me ndonjë pretekst tjetër dhe a do të mund të rregullohej në këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër kjo çështje, po mendoj se herët a vonë do të ballafaqohemi me këtë problem dhe do të duhej ta zgjidhim.

Një çështje tjetër që unë do të dëshiroja ta ngritja këtu dhe që lidhet drejtpërdrejt me këtë projektligj, është edhe çështja se si në të vërtetë do të menaxhohen mjetet, paratë që sigurohen nga shitja e pasurisë ose e mjeteve të sekuestruara. Në Projektligj vetëm thuhet se do të lihen në Bankën Qendrore të Kosovës, por nuk tregohet se ku do të jetë destinacioni i tyre. A do të mund ato të shkojnë në buxhetin e Kosovës apo si do të jetë fati i tyre. Kjo mbase do të duhej po ashtu të precizohej.

Megjithatë, unë e përkrah si projektligj dhe mendoj se ka qenë i nevojshëm dhe e plotëson një vakum në legjislacionin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Riza Smaka e ka fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuar zoti kryesues!

Ministra dhe deputetë,

Titulli i këtij projektligji nuk përkon me përmbajtjen, që do të thotë se ky më tepër apo kryesisht i referohet agjencionit, themelimit dhe organizimit, madje nuk organizohet sipas dispozitave plotësisht dhe ka shumë vakuume dhe dilema. Kjo është, një.

Dy, nuk mund të kontestohet fakti se shumë agjencione po themelohen, nuk po them pa nevojë, por gjithsesi shumë dhe sa më shumë agjencione, më shumë administratë, më shumë shpenzime dhe më pak efikasitet.

Sekuestrimi i pasurisë është bërë, bëhet dhe do të bëhet në konformitet me aktet ligjore, nga doganat, po e zëmë, nga policia, nga inspektorati, nga gjykata, nga organet e administratës publike me procedura të caktuara, qoftë paraprake, qoftë ekzekutive. Edhe sikundër të ishte menduar se ky agjencion t'i mbulonte të gjitha këto mallra të sekuestruara, atëherë pikëpyetje e madhe se ky numër që është dizajnuar në këtë dokument a do të mund ta mbulonte një pjesë krejt të vogël të kapaciteteve që do të duhej t'i mbulonte, sepse është e pamundur, se nuk ka gjykatë, po e zëmë, qoftë edhe kundërvajtëse, edhe këto themeloret, që nuk sekuestrojnë mallra të caktuara. Po e zëmë, pylltaria i merr 1000 kubikë trupa që i pret ilegalisht. Ato sekuestrohen dhe ato, dihet fare mirë, ka rregulla për këtë, nuk ka nevojë për agjencion, por ajo ekonomia e pylltarisë, përkatësisht ajo, si quhet, Drejtorati i pylltarisë i komunës përkatëse e sekuestron. Më pastaj, kur përfundon procedura, malli i sekuestruar do të duhej të shitej. Kjo nuk është rregulluar me këtë dokument. Në aukcion, do të thotë, aukcion – shitje publike. Më pastaj, nuk është precizuar, siç tha kolegu parafolës, se paraja ku do të shkonte. Ajo do të duhej të shkonte medoemos në buxhetin e Kosovës dhe me destinacion, varësisht se në qoftë se është malli nga pylltaria, që të shkonte me atë kodin për pylltari, për gjelbërimin, për pyllëzimin e tjera, e tjera. Masë e caktuar, po e zëmë, për çështje sociale, e tjera. Do të thotë, kjo fushë nuk është rregulluar, prandaj, flas në parim se ndoshta do të duhej që hartuesi apo ai që e ka dizajnuar fillimisht, që e ka sponzoruar, që t'i kishte përcaktuar këto pika orientuese dhe t'i kishte përcaktuar edhe normat, e më pastaj të kishim folë për normat, sepse ka shumë segmente që nuk janë rregulluar fare. Faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Rustem Mustafa.

RRUSTEM MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryesues!

Është bërë modë secili prej deputetëve, prej udhëheqësve të grupeve parlamentare të thotë se është i domosdoshëm, është i nevojshëm ligji. Unë kam dëshirë të shtroj nevojën më shumë për zbatueshmërinë e këtyre ligjeve, të kujdesemi se a do të mund t'i zbatojmë. Unë shoh vështirësi për zbatimin e ligjit, por në veçanti do të flas për agjencionin.

Me kujdes dhe me vëmendje e kam dëgjuar arsyetimin e Komisionit për Legjislacion në Grupin tonë Parlamentar dhe ekspertë tjerë, por ata nuk kanë mund të më bindin për domosdoshmërinë, për nevojën e krijimit të këtij agjencioni.

Unë besoj se ka mekanizma tjerë të shtetit, lëmi tjera ku mund ta kryejnë këtë punë. Është dogana, është Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme e tjera, por sidomos arsyetimi se me 17 njerëz agjencionin do ta bëjnë funksional, është shumë jo serioz. Unë po mundohem ta kuptoj mirë agjencionin për sekuestrim çka do të thotë dhe me kapacitet aq të vogël të njerëzve mos të mendojmë se do të mund ta bëjmë funksional një agjencion. Nuk besoj se mund të ndalet jo vetëm me 17 vetë, por as me 170 vetë të punësuar nëse ndërtojmë segment të ri për këtë qëllim.

Është edhe një punë tjetër nga ky Kuvend, kemi dalë me votën tonë, kemi krijuar shumë agjencione që as sot nuk janë funksionalizuar. Nuk po hyn në punë zbatimi i programit dhe i qëllimit për çka janë krijuar ato, kështu që unë vë në dyshim, po dyshoj në qëllimin se nuk po e kuptoj qëllimin pse të bëhet agjencion për këtë qëllim.

Si i tillë, unë e di, e pash atmosferën që është krijuar në Parlamentin tonë. Unë nuk do ta përkrah ligjin dhe nuk do ta votoj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar deputeti Adem Hajdaraj.

ADEM HAJDARAJ: Zotëri kryesues, Kabinet qeveritar dhe deputetë të nderuar, Unë desha të ndalem vetëm në titullin e këtij ligji, sepse i kemi shqyrtuar edhe në komisione – në komisionin funksional dhe tash edhe ne deputetët dhe në përgjithësi po them, por unë mendoj se titulli nuk është fort i qëlluar. Ka dy defekte, të them. Sa e di unë, sekuestrim dhe konfiskim nuk janë të njëjta kuptimet, kuptimisht, si nocione. Domethënë, ndryshojnë si nocione. Dhe, që të mos sqaroj tash se ç’është sekuestrimi dhe ç’është konfiskimi, kjo lidhëz këtu “apo” nuk e ka vendin. Do të thotë, duhet të jetë, sipas meje: Shqyrtimi i parë i Projektligjit për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, ose gjegjësisht “të konfiskuar” se nuk është këtu edhe nyja, domethënë mungon dhe nuk është mirë kjo “apo”. Gjithkund, në të gjitha ligjet thuhet “apo” sikur të mos kishte “ose” ose ndonjë lidhëz tjetër “a” e tjera, e tjera. Domethënë, ma merr mendja se nuk është si duhet dhe duhet të përmirësohet ky titull.

E dyta, kështu, në formë të përgjithshme po them se shumë e kemi praktikuar të marrim këtë formën “agjencioni”, “komisioni” e tjera. Të dimë se shqipja e ka “Agjenci” dhe “Komisi” dhe përdoren shumë më dendur dhe janë në fjalor “agjenci” e jo “agjencion”, që po përdoren gjithkund.

Prandaj, mendoj se do të duhej të shihet pak fjalori dhe të heqim këtë “agjencion – agjencion”. Bile, këtu është shkruar “agjension” dhe fjala “agjenci” shkruhet me “c”, edhe po të ishte “agjencion” do të ishte agjencion, po “agjenci” duhet të jetë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hajdaraj! Fjalën e ka deputeti Naim Rrustemi.

NAIM RRUSTEMI: I nderuar kryesues!

Unë do të ndalem në nenin 8 të këtij projektligji, nenin 8 pika 3 e cila saktësisht nuk e përcakton formën se si të shitet malli. Përpos, e thotë, shitjen e pasurisë në pajtim me ligjet në fuqi. Deri më tani ne kemi vetëm një udhëzim administrativ dhe ai është një udhëzim administrativ që e rregullon vetëm procedurën e shitjes me ankand publik, kështu që është mungesë e infrastrukturës ligjore që e rregullon shitjen.

I sugjeroj ministrisë dhe komisioneve përkatëse që të kenë parasysh dhe të jenë më përshtatshme me forma të shitjes së mallit të sekuestruar apo të konfiskuar, sepse është një zbrazësi ligjore në procedura të shitjes. Ne kemi ligje për blerje, për furnizim, por ligj për shitje nuk ka. Kjo gjë po rregullohet veç me ankand, e ankandi nuk është forma e vetme e shitjes. Kaq kisha unë.

KRYESUESI: Faleminderit! Të nderuar deputetë, tjerë të paraqitur nuk ka. Zonja ministre, dëshironi fjalën?

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: I falënderoj deputetët për vërejtjet dhe sugjerimet që i bënë këtij ligji.

Ne si Qeveri do të japim kontributin tonë në kuadër të komisionit funksional për përmirësimin dhe amendamentimin e këtij ligji.

Personalisht edhe unë kam pasur dilema a të themelohet Agjencioni apo Departamenti në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar.

Sa i përket këtyre organizatave që u përmendën, të gjitha ato, nëse themelojnë departamente në kuadër të vet për shitjen dhe menaxhimin e tyre, atëherë do të shkapërdërdej kjo.

Nga ana tjetër, përkrah edhe sugjerimin e deputetëve që mjetet e realizuara jo të derdhen në buxhetin e Kosovës, por të shfrytëzohen për qëllime humanitare apo për çështje sociale.

Sa i përket aplikimit të ligjit retroaktivisht, që njëri deputet e përmendi prej 1912 e këtej, ajo ka të bëjë thjeshtë me konfiskimin e pasurive të paluajtshme, por edhe të pasurive të luajtshme, të bëra në mënyra të ndryshme të kundërligjshme. Ajo do të vendoset me një ligj tjetër, me Ligjin për pronën.

Prandaj, me këto sugjerime, me amendamente, unë do t'ju lusja që ta miratoni këtë ligj dhe pranoj sugjerimin që me rishikimin e buxhetit të kërkohen mjete shtesë për implementimin e këtij ligji, në të kundërtën, atëherë do të ndryshohen dispozitat kalimtare dhe do të thuhet se ky ligj fillon së zbatuari nga 1 janar të vitit 2010, kur miratohet buxheti i Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zonja ministre!

Konstatohet se në sallë janë 77 deputetë. Tani duhet ta votojmë Ligjin për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar apo të konfiskuar, në parim.

Ftoj deputetët dhe regjinë që të bëhen gati për votim. Votojmë tani:

Konstatohet se me 64 vota “për”, 7 vota abstenim dhe 6 vota “kundër” u miratua ligji. Ju faleminderit!

Në bazë të Rregullores së Punës, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional,
- Komisioni për Buxhet dhe Financa,
- Komisioni për Komunitete dhe
- Komisioni për Integritet Evropian.

Komisionet duhet që brenda 2 muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandimet.

Vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike**

Në bazë të Rregullës 35 pika 1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim, të këtij projektligji.

Ftoj ministrin e Punëve të Brendshme, zotëri Zenun Pajazitin, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektligjin. Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Më lejoni të prezantoj para jush Projektligjin për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike, të sponsorizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Hartimi i këtij projektligji, pra i Projektligjit për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike ka filluar të punohet që nga marsi i vitit 2008. Në hartimin e këtij projektligji kanë marrë pjesë, përpos anëtarëve dhe ekspertëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme, edhe shumë anëtarë të organizatave tjera mbështetëse, të partnerëve tanë e tjerë, të cilët meritojnë falënderimin tonë.

Ky projektligj ka një rëndësi të veçantë për Kosovën dhe qytetarët e saj, prandaj edhe shihet rëndësia që i kemi dhënë me prioritet këtë vit. Fushëveprimi i këtij projektligji është ruajtja e rendit dhe qetësisë publike. Nevoja për këtë projektligj është e madhe për faktin se miratimi i një ligji të tillë është në dobi, në radhë të parë, të qetarëve të Republikës së Kosovës, meqenëse do të vendosej ligjshmëria dhe drejtësia në procedimin e kundërvajtjeve që kanë të bëjnë me qetësinë publike në përgjithësi.

Ne konsiderojmë se rregullimi i kësaj fushe me legjislacion të tillë do të ketë ndikim pozitiv në rritjen e sigurisë së qytetarëve të Republikës së Kosovës, pastaj të punës dhe të jetës normale, të lirisë së lëvizjes së qytetarëve nëpër rrugë dhe vende tjera publike, mos pengimi i realizimit të të drejtave dhe obligimeve të tyre si dhe siguri i përgjithshëm i njerëzve dhe i pronës së tyre, si dhe të organeve të ndryshme shtetërore, e tjera.

Arsyet për hartimin e këtij projektligji janë vendosja e rregullave ligjore duke përcaktuar kundërvajtjet kundër atyre që atakojnë rendin dhe qetësinë publike, si dhe rregullimin e ndëshkimeve për kryerësit e kundërvajtjeve.

Projektligji ka për qëllim që të adresojë të gjitha çështjet të cilat kanë të bëjnë me ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike, si dhe përcaktimin e veprimeve apo mosveprimeve që paraqesin cenimin e rendit dhe të qetësisë në vende publike apo në hapësirat private, si dhe sanksionet për këto sjellje.

Projektligji është në përputhje të plotë me standardet dhe legjislacionin e BE-së.

Projektligji për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike për vitet 2009/2011 nuk do të ketë ndikim buxhetor të drejtpërdrejtë në buxhetin e vendit. Konsiderojmë se ky projektligj do të krijojë një stabilitet legjislativ për veprimtarinë të cilën e rregullon.

Nga këto që i thashë më lartë, kërkoj që të procedohet më tej në procedurat e Kuvendit ky projektligj. Ju faleminderit për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Tani, pas prezantimit, hap debatin për diskutim, në parim. Sipas radhitjes, kryetari ose raportuesi i Komisionit funksional për Punë të Brendshme dhe Siguri. Fjalën e ka deputeti Rustem Mustafa.

RRUSTEM MUSTAFA: Kryesues i nderuar,
Komisionit i ka ardhur ligji me kohë dhe ka mbajtur mbledhje me 14 prill 2009. E ka shqyrtuar Projektligjin për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike dhe ka vendosur që Kuvendit t'i rekomandojë që ta miratojë në lexim të parë. Komisioni edhe gjatë procedurës së mëtejshme do të punojë në amendamentimin e këtij ligji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, fjalën e kanë kryetarët e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike është paraqitur Zafir Berisha.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe unë mendoj, si kryetar i Komisionit, se ky ligj është bukur me rëndësi edhe për faktin se zëvendëson ligjin e ish-Jugosllavisë dhe mendoj se rregullimi i këtyre fushave me ligjet e një shteti që nuk ekziston dhe disa rregulloreve ka qenë i tepërt për vitet e pasluftës dhe besoj se komisioni dhe të gjithë ata që janë të interesuar me ndërhyrjet e tyre do të ndikojnë pozitivisht, veçanërisht te neni 5 dhe 11 të këtij ligji, i cili në njëfarë forme ruan shijet e ligjeve të një shteti që nuk ekziston ose, thënë ndryshe, na përkujton pak sa nenin 133 alineja 1 të "famshmit", me të cilin shumë qytetarë të Kosovës janë dënuar dhe besoj në rrethanat në të cilat është Kosova si shtet demokratik, të gjithë deputetët, e veçanërisht komisioni funksional do ta japë kontributin e vet që ligji të jetë funksional në shoqërinë e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli. Më fal, të lutem, Ibrahim. Në emër të Grupit Palamentar të LDK-së, Agim Veliu.

AGIM VELIU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike i përcakton mirë kundërvajtjet kundër rendit dhe qetësisë publike, si dhe ndëshkimet për kryerjen e kundërvajtjeve.

Në vërejtje e cila duhet të merret parasysh në fazën e amendamentimit është se disa përkufizime që janë në këtë projektligj duhet të harmonizohen me Kodin penal të Kosovës.

Grupi Parlamentar i LDK-së, pas shqyrtimit i jep mbështetje, në parim, këtij projektligji dhe deputetët e LDK-së do ta japin kontributin e tyre gjatë punës në komisione. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, fjalën e ka Ibrahim Makolli.

IBRHAIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë po kërkoj falje, kujtova që në emër të koalicionit është njëjtë të flet një për të gjithë, por megjithatë nuk ndodhi kështu!

Unë do të përpiqem që në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së të jap disa prej vërejtjeve tona, që në radhë të parë do të ishin më tepër si dilema se a ka kapacitete për t'u zbatuar ky draftligj në praktikë, kur kemi parasysh që ekziston një numër i rregullave,

qofshin edhe ato nga ana e kuvendeve komunale, të cilat nuk zbatohen pothuaj në asnjë rast.

Po ashtu, ka disa gabime këtu që përmban, por besoj se gjatë punës do të evitohen. Kemi këtu edhe te definicionet, por sidomos do të përmend vetëm dy raste.

Ta zëmë, e kemi nenin 7.1 “Kushdo që përfshihet në një akt seksual të prostitucionit, dënohet për kundërvajtje”. Ne të gjithë e dimë që akti seksual i prostitucionit është vepër penale, nuk është vepër kundërvajtje, nën një.

Po ashtu, ligji, përpos që e rregullon, ka për qëllim edhe parandalimin e kësaj dhe natyrisht do të duhej që

(Zhurmë në sallë)

Po pres deri sa të qetësoheni dhe do të vazhdoj. Është fjala te prostitucioni, lexojeni mirë nenin, ju lutem – Marrja me prostitucion. Dhe, për ta përmbyllur, është ligji, sikur e thashë, ka për qëllim përpos rregullimin e kësaj fushe, ka për qëllim edhe parandalimin e dukurive të ndryshme dhe gjrobat të cilat parashihen në këtë projektligj për shkelje të këtyre rregullave janë aq të ulëta sa që po thuajse janë të kalueshme për gjithsecilin. Prandaj, ndoshta gjrobat do të duhej të ishin më të larta në mënyrë që të jenë edhe edukuese. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, zoti Maloku.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit zoti kryesues!

Unë e përgëzoj ministrin për një ligj të mirë që e ka pru në Kuvend dhe i domosdoshëm, i hartuar mirë dhe mendoj që e plotëson mirë një fushë e cila nuk ka qenë gjer më tani e rregulluar me ligj. Unë ju ftoj, të nderuar deputetë, zoti ministër, që të kemi vëmendjen në disa paragrafe dhe nene që unë do t’i citoj tani.

Te përkufizimet, paragrafi 1.7 thotë, citoj “Zhurma është tingulli (zëri i lartë dhe i padëshirueshëm)”. Është në rregull kjo, por keni parasysh që te neni 8, që përkufizon bezdisjet publike, pra shkeljet që kanë të bëjnë me zhurmën, thotë kështu, citoj: “Kushdo që shkakton zhurmë të panevojshme dhe të padurueshme, të cilat shqetësojnë personat tjerë nga ora 10 të mbrëmjes deri në 7 në mëngjes ditëve të javës dhe 11 deri në 7 mëngjes të shtunave dhe të dielave, dënohet për kundërvajtje”. Në qoftë se miratohet ky ligj kështu dhe hyn në fuqi, duhet të mendojmë mirë, hapet një mundësi që qytetarë të ndryshëm të bëjnë peticione, për shembull, për ezanin e mëngjesit, kur në xhami falen para orës 7, do të thotë. Pse po e them këtë? Po duhet të rregullohet që të mos lihet hapësirë. Ne e kemi Ligjin për liritë fetare, por duhet..., se miratimi i këtij ligji kështu me këto dy paragrafe, pa e formuluar edhe këtë lejen tjetër, pra lejimin e atyre vakteve, pra edhe të kishave e tjera, hap një mundësi, lë hapësirë, pra lë mundësi që qytetarët e ndryshëm ose njerëz, qoftë edhe për tinguj të kishave e tjera... Pra duhet kjo të kihet parasysh, zoti ministër, edhe Komisioni funksional.

Më lejoni që te neni 10, përkufizimi, paragrafi 1 thotë kështu, citoj: “Kushdo që në vend publik kërkon lëmoshë në mënyrë tepër të bezdisshme”. Qysh mund të klasifikohet diçka “tepër e bezdisshme”. Ne po bëjmë ligj këtu. Pra, ligji duhet të jetë qartë i përkufizuar. Çfarë mase ose çfarë kriteri mund ta përcaktojë një qasje “tepër të bezdisshme” ose “më pak të bezdisshme” ose “të bezdisshme”. Pra, edhe kjo duhet të kihet parasysh dhe gjatë

shqyrtimit të këtij projektligji të mos lihen hapësira që pastaj të kemi probleme gjatë implementimit të këtij projektligji.

Parafolësi im ceku edhe te prostitucioni ose te definicioni për prostitucionin. Edhe kjo duhet të rishikohet, sepse thuhet aty që prostitucion pra shërbimet, nejse, me të holla. Po, ka prostitucion edhe pa të holla, duhet të dihet, janë çështje për të cilat duhet thjeshtë të gjendet një formulim, a po kuptoni. Faleminderit!

Pra, Grupi Parlamentar i AAK-së e miraton në parim. Unë vetëm i ceka, sepse ne po bëjmë ligj, po miratojmë ligj në këtë Kuvend dhe ligji nuk duhet të lë hapësira për dykuptimësi ose çështje për të cilat pastaj gjatë implementimit të këtij ligji të ketë probleme dhe dilema. Këto ishin ato, zoti ministër dhe të nderuar deputetë, që unë në emër të Grupit Parlamentar pata për qëllim të tërheq vërejtjen, se duhet rishikuar edhe një herë dhe të gjenden përkufizimet adekuate të këtyre paragrafëve dhe neneve dhe në parim e miratojmë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Maloku! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, fjalën e ka deputeti Gani Geci.

GANI GECI: Faleminderit, zoti kryesues!

Duke pas parasysh se ruajtja e rendit dhe të qetësisë publike në Republikën e Kosovës nuk ka qenë e rregulluar me ligj, ka lindur nevoja edhe më herët që para nesh të vijë ky ligj, por nuk ka ardhur. Megjithatë, ky ligj është në dobi të qytetarëve të Republikës së Kosovës, por edhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Me aprovimin e këtij ligji do të vendoset ligjshmëria dhe drejtësia për procedimin për kundërvajtje, pra të atyre që e prishin rendin dhe qetësinë publike. Prandaj, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e mbështet, në parim, këtë projektligj dhe vërejtjet tona eventuale do t'i themi në komisionin funksional, por edhe në Kuvend. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputetja Shpresa Murati.

ŠPRESA MURATI: Hvala, predsjedavajući!

Pozdravljam sve prisutne u sali!

Ovim se nacrtom zakona reguliše lično ponašanje u cilju održavanja javnog reda i mira, definiše se prekršaj i utvrđuju kazne za učinjene prekršaje. Ovim se nacrtom zakona takodje utvrđuju pravila protiv kršenja javnog reda i mira, kao što su neprimerno i arogantno ponašanje, verbalni napadi, prostitucija, javna uznemiravanja, kršenja vezano za buku i galamu, pijanstvo na javnim mestima, zaštita maloletnika, lažna prijavljivanja i slično. Kazne su od presudnog značaja za preventivno delovanje u suzbijanju narušavanja javnog reda i mira i one bi morale biti adekvatnije i strožije pogotovo prema onim licima koji su višestruki prekršioc i javnog reda i mira, a u Nacrtu zakona se nigde ne precizira kakve su kazne predviđene za takva lica.

U Nacrtu zakona se takodje ne precizira da li novčanu kaznu u zavisnosti od težine prekršaja mogu naplaćivati i službenici policije na licu mesta. Šta ako prekršioc ne plati novčanu kaznu na licu mesta, da li mu ovlašćeni službenik uručuje poziv da u odredjenom roku plati izrečenu kaznu i u kojim slučajevima se pokreće prekršajni postupak od nadležnog suda. Odgovori na ova pitanja trebali bi biti deo ovog zakona, jer se oba pitanja uredjuju zakonom o javnom redu zemalja u regionu, recimo u Bosni i Hercegovini.

Član 13. – zaštita maloletnika, i član 18. - nenadziranje maloletnika, mogu se preformulisati u jedan član sa više stavova.

Smatramo da će ovaj predlog zakona uz naše sugestije doprineti povećanju bezbednosti građana Kosova, slobode kretanja po ulicama i drugim javnim mestima, kao i zaštite imovine građana Kosova. S toga će Parlamentarna grupa „7+“ podržati ovaj predlog zakona u načelu i daće svoj doprinos u toku njegove dalje procedure. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS, Bojan Stojanović e ka fjalën.

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!

Uvažene kolege poslanici,

Parlamentarna grupa SLS podržava ulazak u skupštinsku proceduru na prvo čitanje ovakvog zakona. Naravno, ovo je jedna neophodna stvar jer smo suočeni, i svi dobro znamo, da ne pričamo puno priče o tome kakvo je stanje trenutno kod nas i verovatno ako se ovaj zakon bude primenjivao u naredne dve godine, nećemo razmišljati puno ni o budžetu, jer ima puno onih koji su se do sada ove stavke ugušivali. Parlamentarna grupa SLS će takodje će dati svoj doprinos kroz komisije. Medjutim, ovde postoje neke stvari, na primer izložba stidljivog materijala. Ja ne znam da li je to prevod ili, ovamo kaže „svako ko javno deli i izloži neki natpis, znak ili drugo javno predstavljanje koje nekog vredja ili sramoti u cilju narušavanja mira, kazniće se prekršajno“. Ja mislim da je to šira kategorija, znači imate donji veš ili rublje koje se nalazi u izlogu na lutkama ili na reklamnom materijalu, pitanje je da li to nekog vredja ili ne i da ne ulazimo u detalje. Mora se ovaj član malo bolje obraditi.

Zatim, zaštita maloletnika, piše od „22 do 07 časova“. Ja ne znam da li neki lokal ima dozvolu i šta se radi s tim, da li neko posle 23 u opšte ima pravo da radi. Znači, to je neusklađeno. I mislim da su neprimerene novčane kazne, po gotovo za vlasnike lokala javnih objekata je nedopustivo da su kazne svega stotinu evra veće nego za fizičko lice koje to napravi, a suočeni su s tim da imaju, po gotovo kod maloletnika, i u zadnje vreme ozbiljnih krivičnih dela, i ništa se ne dešava, normalno i dalje rade jer za jedan lokal koji radi dobro – u diskoteku nije mnogo da plati 700 evra mesečno kaznu ako može tamo svaku noć da izbija po pet, šest tuča ili više, imaće i zakon o privatnom obezbeđenju pa će moći to da se reguliše.

Onda, mislim da nije dobar član o vandalizmu. Svako ko namerno i sa predumišljajem i zlonamerno izaziva štetu i uništava strukturu i sadržinu javne ili privatne imovine, kazniće se prekršajno od 100 do 900 evra. To mora na drugi način da se reguliše. Znači, ili vrednost imovine koju je on narušio, jer će možda neko namerno sada da zapali sto automobila ili da napravi štetu od par miliona evra i da plati kaznu od 900 evra, što ja mislim da je nesrazmerno i ja ne znam da li određene visine štete koje nanose lica koja su okarakterisala kao o vandali, to možda popada i pod krivično zakonodavstvo. Znači, u to treba obratiti pažnju, kao i pijanstvo, znači pojavljivanje ljudi u pripitom stanju na javnom mestu, koliko mogu da ugroze ostale ljude. Ja mislim da ne mogu da ugroze ostale ljude samo u domenu prekršaja, već i u nekim granicama koje su na ivici sa krivičnim delima ili sama krivična dela.

Naravno, još jednom da ponovim, mi podržavamo ulazak ovog zakona u proceduru i svojim sugestijama kroz funkcionalne komisije doprinećemo da se ovaj zakon usvoji na drugom čitanju. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar, “Zajedno”, Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala puno! Ponovo pozdravljam sve u sali. Ponovo imamo Nacrt zakona o održavanju javnog reda i mira, koji smo jako pažljivo pročitali u Grupi i znamo da je ova oblast koja je opisana u načelu ovog zakona bila regulisana do sada na osnovu Zakona o javnom redu i miru – jugoslovenskog zakonodavstva, Zakon pod brojem 23/1981. godine.

Ovaj nacrt zakona o održavanju javnog reda i mira znači danas je u promenjenom nazivu zato što smo mi zemlja u tranziciji i isti zakon je i kao prethodni zakon sa istim ciljem regulisanja ličnog ponašanja građana kako bi se očuvao javni red i mir.

Svi znamo da je zakon opisan u IV poglavlja, sa ukupno 22 člana. Ovim zakonom se definišu sve prekršajne mere i kaznene mere. Utvrđeni su svi nadležni organi za sprovođenje zakona koji je u nadležnosti Ministarstva unutrašnjih poslova. Zakon nema budžetski dodatni trošak, pošto isto ministarstvo ima izdvajanje od budžeta od 67.700.000 evra, za 9.979 svojih zaposlenih u Ministarstvu. Znači, imamo infrastrukturu zakona, imamo subjekte i izvršioce koji su nadležni da se ovaj zakon sprovodi.

Medjutim, kada su definisane prekršajne mere, ja mislim da je zakon, piše ovde, da je uskladjen sa Slovenijom, Hrvatskom i Albanijom u regionu, mislim da za definisanje ovih prekršaja treba da se ponovo obrati pažnja, jer postoje pojedine specifične prekršajne mere koje se ovde smatraju normalnim kod nas ovde na Kosovu, tako da ne bi imale posledice pojedine grupacije stanovništva i građana kada se remeti red i mir.

Kada je u pitanju prevod zakona, moram da kažem da je jako nestručan i kada se radi o srpskoj verziji, a kada se radi o engleskoj i albanskoj, meni je žao, jako malo znam, kakva je to će reći naše kolege, ali kada se prevode zakoni iz okruženja, molim da malo više pažnje da nam budu jasne pojedine reči i da imamo smisao kada čitamo zakon.

Zakon je jako potreban za zakonodavstvo i mislimo da treba da ide dalje u Skupštinskoj proceduri, kroz komisije i parlamentarne grupe i mi ćemo dati svoj doprinos dalje. Hvala puno!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas renditjes, tani deputetët e kanë fjalën. Radhën e ka deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe unë i bashkëngjitëm parafolësit se ky projektligj, me gjithë ato të meta që i ka, i ka të shumta, megjithatë është i domosdoshëm. Andaj, në parim e përkrah.

Po, sidoqoftë, më lejoni që t’i jap disa vërejtje të mia, ndonëse disa u prekën. Pos gabimeve gjuhësore, që mendoj s’kemi nevojë t’i komentojmë për shkak se pothuaj secili projektligj lëngon nga kjo sëmundje, do të ndalesha tek neni 5 që në njëfarë mënyre deputeti i nderuar, Berisha, e përmendi, mendoj në Zafërin. Te pika 1, këtu thotë: “kushdo që në vend publik përdor fjalë ofenduese me qëllim që të provokojë prishjen e rendin dhe qetësisë publike, dënohet për kundërvajtje”. Po, cilat janë ato fjalë ofenduese, është

çështje e shijes, është e gjerë, është çështje e perceptimit për shkak se për dikë disa fjalë mund të jenë ofenduese, për dikë tjetër jo, domosdoshmërisht.

Pastaj, në të njëjtin nen, pika 3, situata përkeqësohet edhe më shumë. Këtu thuhet se “Nëse kundërvajtja e paraparë në paragrafin 1”, ku nuk shpjegohet se cilat janë fjalët ofenduese dhe çka është ofenduese sipas këtij neni, “kryhet ndaj personave zyrtarë ose personave që mbrojnë rendin dhe qetësinë publike”, sipas ligjit për tubimet publike. Këto protestat publike bëhen pikërisht për t’i ofenduar institucionet apo për t’i akuzuar, varësisht se kush si i merr dhe këtu u jep të drejtën organeve të sigurimit që të përdorin forcën, varësisht sipas perceptimeve të tyre. Dhe, është një erë shumë jo demokratike apo e shtetit policor. Mendojmë se ne, apo, të paktën po tentojmë ta bëjmë një shtet demokratik, ku çdo kritikë nuk mund të merret si ofendim.

Pastaj, kemi nenin 6 - Sjelljet e pahijshme seksuale. Mendoj se nuk është korrekte që akti seksual i kryer në vend publik të barazohet me një eksponim të ndonjë pjese intime të trupit, që përsëri është çështje e perceptimit dhe se çka nënkuptojmë, cilën pjesë të trupit. Këtu nuk caktohet.

Dhe, pastaj gjrobat nuk janë në akordim me problemin që shqyrtohet. Mendoj se edhe këtu duhet të bëhet njëfarë ndarjeje për shkak se këto akte jo ligjore, po them, për kah rëndësia janë të ndryshme, nuk janë të njëjta.

Te neni 8 -Bezdisjet publike, unë mendoj se kjo ora 22:00 duhet të ulet në 21:00, sidomos duke pasur parasysh ndërtesat kolektive dhe duke pasur parasysh foshnjat dhe personat e sëmurë. Domethënë, unë jam partizan i asaj që të gjithë ata që shkaktojnë zhurmë të panevojshme, domethënë, nga ora 21:00, jo nga ora 22:00, e deri në orën 7:00, pra të ndalet me ligj çdo zhurmë nga ora 21:00 për hir të foshnjave dhe të fëmijëve parashkollorë, e po ashtu, siç e thashë, ta përsëris edhe një herë, për të sëmurët. Kështu është të paktën çdo kund në Evropën Perëndimore, por edhe në botën e qytetëruar.

Pastaj, te neni 10, e tha deputeti i nderuar Maloku, për punën, çka është kjo në mënyrë “tepër të bezdisshme”, “kushdo që në publik kërkon lëmoshë në mënyrë tepër të bezdisshme”. Përsëri kemi çështje të perceptimit dhe është çështje e shijeve çka është “tepër e bezdisshme”.

Te neni 11, “kushdo që shpërndan ose ekspozon ndonjë shkrim, sharje ose paraqitje tjetër të dukshme, e cila e ofendon ose turpëron dikë”. Përsëri kemi çështje të perceptimit personal. Çka janë këto që “e turpërojnë dikë”, “e ofendojnë dikë”, për shkak se nuk kemi ndonjë formulë universale. Nëse kemi të bëjmë me traktate politike, domethënë kjo hyn direkt te të drejtat e fjalës së lirë dhe mendimi im është se këtu pikërisht është synuar me këtë nen që të ndalohet fjala e lirë apo edhe ndonjë grafit me përmbajtje politike, që është në kundërshtim me atë që jemi përkushtuar si shtet.

Neni 13, është për mua i pakuptueshëm dhe lë shumë për të bërë interpretime. Këtu thuhet “pronari ose personi përgjegjës i një veprimtarie afariste, i cili lejon të miturit nën moshën 16 vjeçare që pa shoqërimin e prindërve ose të kujdestarit të hyjë ose të qëndrojnë në një lokal afarist në të cilin prej orës 10:00 deri në 7:00 shërbehet pija alkoolike”. Shtrohet pyetja, çka deri në orën 10:00 me këtë grup të shoqërisë sonë. Domethënë, ata kanë të drejtë të miturit nën moshën 16 vjeçare që të futen në lokale të cilat nuk e kanë licencën të shesin alkool prej 10:00 deri në 7:00, por e kanë po them licencën deri në 11:00 dhe këta munden në orën 9:30 të shkojnë dhe të marrin alkool. Për shkak se kështu

qysh është, interpretimi është se ka të bëjë me ndalesën e të miturve vetëm për këto klube të natës apo diskotekat, por jo edhe për lokalet tjera, ku shërbehet alkooli në një kohë tjetër. Dhe, mendoj se edhe këtu duhet të bëjmë qartësimet se fëmijët nën moshën 16 vjeçare a do t'i lejojmë të përdorin alkool në vendet të cilat janë të licencuara, apo jo. Kështu, edhe i lejojmë, edhe s'i lejojmë.

Kaq pata, i nderuari zoti kryesues. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Tali. Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

E përshëndesim Ministrinë e Punëve të Brendshme që ka sjellë një ligj të domosdoshëm për të plotësuar një vakum ligjor apo për të plotësuar një ligj të institucioneve të Kosovës.

Mirëpo, me qëllim që komisioni funksional të jetë apo t'i jepet mundësia që ta rregullojë projektligjin, atje ku është e mundur, e mora fjalën që të ngrejë disa nga shqetësimet që i kemi në projektligj.

Në fillim, konsideroj se dispozitat e përgjithshme dhe të qëllimi i ligjit duhet gjithsesi të riformulohet, sepse nëse lexohet, e kemi të paqartë se çka rregullojmë me qëllimin e ligjit. Thotë: "Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i sjelljes personale në mënyrë që të ruhet rendi dhe qetësia publike". Domethënë, qëllimi i këtij ligji nuk është për të rregulluar vetëm çështjet personale, por është për rendin dhe qetësinë publike dhe rendin e qetësinë publike mund ta prishin edhe grupet e organizuara dhe njerëz në forma të ndryshme apo në organizata të ndryshme. Prandaj, duhet gjithsesi komisioni funksional ta ketë këtë parasysh dhe ta riformulojë.

Çështje tjetër, u përmend nga të gjithë, mirëpo unë dua pak ta lexoj që patjetër duhet gjithsesi të rregullohet në komisionin funksional neni 1.5, ku flet për përkufizimin për prostitucionin. Duhet gjithsesi të rregullohet edhe në transkript. Thotë: "Prostitucioni nënkupton kryerjen e akteve seksuale për përfitime materiale". Jo, nuk është ashtu dhe duhet gjithsesi të ndërrohet, sepse ata të cilët kryejnë akte në prostitucion, nuk përfitojnë materialisht, ata humbin. Do të ishte veprimtari, apo diçka tjetër. Prandaj, duhet gjithsesi të amendamentohet, sepse nuk guxojmë ta lëshojmë kështu. Ne nuk e dimë qysh është, a është çështje përkthimi, apo si?

Mandej, shkojmë në nenin 4. Nuk e lash pa e përmendur, sepse nuk duhet ta lëmë një ligj të kalojë në institucione kështu. Neni 4 thotë: "Sjellja arrogante", nëse e lexoni – "Sjellja arrogante" dhe më poshtë shkruan: "Kushdo që në vend publik nxit ose merr pjesë në përleshje, dënohet për kundërvajtje". Domethënë, nuk i shkon asaj që po shkruan në nenin 4, sepse është fjala për sjellje arrogante, nuk është për përleshje, për marrje direkte në sulm apo në...

Çështje tjetër me interes që është mirë ta dallojmë. Këtu kanë paraparë shumë dënime të ndryshme me gjobë dhe kanë paraparë edhe dënimin me burgim për vepra të ndryshme 30, 40, 50, 60 ditë. Ka qenë mirë, meqë të gjitha dënimet kundërvajtëse janë deri në 60 ditë, të ketë dy kufizime. Një deri në 30 ditë, dhe tjetri deri në 60 ditë, dhe mos të jepen diku 40 ditë, diku 50 ditë, sepse nuk ia kanë qëlluar. Mandej, për disa vepra shumë më të rënda, për shembull, kanë kërkuar deri në 40 ditë, për disa shumë më të lehta ndoshta deri në 50 ditë. Unë nuk do t'i përmend të gjitha.

Çështje tjetër, është çështja..., “bezdisjet” i thanë, nuk do ta përsëris. Është “lajmërimi i rrejshëm” që më ka lënë përshtypje dhe është mirë që të rregullohet. Thotë: “Kushdo që me dashje shkakton panik në tubime publike, duke lajmëruar rrejshëm për alarm nga zjarri dhe për kërcënime me bombë, do të dënohet për kundërvajtje”. Konsideroj që duhet ta marrim dhe ta shikojmë edhe Kodin penal, sepse këtu kanë paraparë dënim 30 ditë. Është shumë vepër e rëndë penale dhe mund të ketë pasoja shumë të rënda për këto tubime kur dikush lajmëron se në tubim është një bombë dhe, ne që jemi juristë e dimë çka është nevoja ekstreme dhe gjendja ekstreme. Prandaj, nuk mund ta definojmë me këtë ligj që është kundërvajtje, sepse nga ai panik mund të kemi edhe viktima, njerëzit të kërcëjnë dhe të përplasen, të humbin jetën, prandaj nuk mund të mendojmë dhe ta paraqesim gjobën, siç e kanë paraparë dënimin deri në 500 euro dhe dënimin me burg 30 ditë. Gjithsecili do ta bënte këtë nga pakujdesia, do të thotë, është një bombë, njerëzit do të lëvizin dhe të shkaktojnë pasoja të ndryshme, sepse dënimin e ka më së shumti 30 ditë, ashtu siç është paraparë në këtë ligj.

Dhe, krejt në fund, është neni 20, që konsideroj se duhet gjithsesi të ndryshohet. Thotë – Mbikëqyrja: “Zbatimi i këtij ligji është përgjegjësi e organeve të Ministrisë së Punëve të Brendshme”. Jo nuk është kështu, duhet ta kuptojmë, ligjin nuk jemi duke e nxjerrë për ta zbatuar vetëm Ministria e Punëve të Brendshme. Duhet ta zbatojnë të gjithë qytetarët për të cilët po nxirret. Duhet ta zbatojnë organet e drejtësisë, natyrisht që edhe Ministria e Punëve të Brendshme. Pastaj thotë: “sipas ligjit në fuqi mbi zbatimin e ligjit”. Duhet të riformulohet, sepse është i formuluar ashtu që është i padrejtë dhe nuk duhet kurrësi që të na vijë në leximin e dytë me këto vërejtje.

Të gjitha këto vërejtje ishin me qëllim që në leximin e dytë ta nxjerrim një ligj i cili do të ishte i mirë dhe do të ishte i zbatueshëm në praktikë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti Riza Smaka e ka fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuar zoti kryesues!

Ministra e deputetë,

Ky projektligj esencialisht i referohet Ligjit për kundërvajtje dhe si vërejtje parimore e përgjithshme është se një numër i konsideruar i akteve të kundërvajtjes fare nuk janë sanksionuar. Vërejtje parimore, kështu, substanciale. Tjetër, po e zëmë, Ligji për ruajtjen, nuk është fjala për ruajtjen e rendit, por për mbajtjen e rendit. Kjo është, domethënë, shprehje adekuate me këto, në dy gjuhët tjera dhe me praktikat e mira në legjislativ.

Më pastaj, po e zëmë, on preservation, preservation of funds apo tradition është shprehje që i referohet prezervimit të ushqimit, po e zëmë, apo të traditave dhe ka tjera shprehje. Këtu është mjeshtëria e përkthimit adekuat kur e gjen shprehjen që është juridike, siç është, po e zëmë, sejt guard of is. Ka shumë vërejtje të këtilla, ato po i kaloj se është fjala për çështje parimore.

Neni 8, kur thotë, po e zëmë, paragrafi 1, “kushdo që shkakton zhurmë të panevojshme”. Kjo është një shprehje anti-shprehje, sepse ai apo ajo që do të shkaktonte zhurmë, kurdoherë do të thoshte- është e nevojshme edhe do të justifikohet dhe do të kalonte nga sanksioni. I teket, në mesnatë e merr bormachinën e dridh krejt ndërtesën, po e zëmë, edhe do të thoshte -e është e nevojshme, apo jo. Pra, kush do të shkaktonte zhurmë të nevojshme, të panevojshme. Ose, bie fjala, neni 9, paragrafi 1, “kushdo që shfaqet në vend publik dukshëm i dehur”. Kjo “dukshëm i dehur”, “dukshëm” është

standard juridik që aplikuesit i jep kualifikim që ta vlerësojë. Nuk ka qenë “dukshëm i dehur”, ka qenë “dukshëm i dehur”, prandaj do të jepte mundësi korruptive për ta kaluar pa dënim, apo jo. Prandaj, shprehjet e këtilla duken në pamje formale e tjera, por janë substanciale, prandaj në këtë aspekt do të duhej të rishikohej me seriozitet.

Ose, te neni 10, paragrafi i 1: ”Kushdo që në vend publik kërkon lëmoshë në mënyrë tepër të bezdisshme”. Po, kjo duhet të fshihet krejt: “kushdo që kërkon lëmoshë”. Ne e kemi Qeverinë, e kemi Ministrinë adekuate që do të kujdesej. Ne duhet t’i largojmë nga rrugët ata që kërkojnë lëmoshë, herë me vend, herë pa vend, por duhet në mënyrë institucionale. Ama, formulimi i këtillë është një anti-formulim, që me të vërtetë krijon raste juridike që jep mundësi juridike për ta abuzuar ligjin kushdo që do dhe për ta pasur mbulesën.

Neni 19- Sekuestrimi i mjeteve dhe sendeve. Organi kompetent mundet, që do të thotë organit kompetent ia jep mundësinë e arbitrarizmit, nëse do e sekuestron, nëse nuk do, nuk e sekuestron. Këtu nuk ka mundet, nuk duhet fakultativja, duhet obligativja. Do të thotë, e sekuestron edhe aty nuk ka, mandej, si të thuhet, arbitrarizëm, sepse autoriteti publik e ka për obligim për ta sekuestruar sendin e rrezikshëm. Kështu është ngjashëm edhe te paragrafi i dytë. Natyrisht, kam edhe tjera vërejtje, por këto ishin të karakterit parimor, që me të vërtetë do të duhej të eliminoheshin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputetja Njomza Emini.

NJOMZA EMINI: Ju faleminderit, kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Vërejtjet parimore që unë desha t’i them veç u cekën, por njëra te dispozitat e përgjithshme, çka foli edhe parafolësi, Bahri Hyseni, do të thotë kolegu, te qëllimi i këtij ligji, thotë që është “rregullimi i sjelljes”. Unë mendoj që këtu ka munguar ajo që është dashur të thuhet, që ndoshta “te rregullimi i rendit” apo edhe i “qetësisë”, sepse nuk kemi të bëjmë këtu me rregullim sjelljes të personit apo të individëve tjerë.

Gjithashtu, edhe te nenet që, vetëm po i them me nene, sepse nuk do t’i lexoj për shkak se u përsëritën edhe nga parafolësit e mi – te neni 7, neni 6. Unë mendoj që, do të thotë këtë projektligj ka nevojë Kosova ta ketë, duke e ditur që edhe prishet rendi dhe qetësia në publik. Ajo se çka është më e rëndësishme, është që ndoshta do të ishte mirë që formulimi i neneve do të ishte me disa terma tjera dhe jo me këto terme që janë përsëritur. Në një nen thuhet numri i gjobës, një çmim më i ulët, ndërsa tek ato veprat tjera që bëhen, veprat penale, do të thotë është gjoba më..., domethënë nuk është shuma e caktuar.

Unë mendoj që ky projektligj duhet të përkrahet parimisht, por me vërejtjet që do të përmirësohen që u parashtruan këtu dhe që ka rëndësi të madhe, do të thotë, për Kosovën, duke ditur që prioritet e keni bërë tani, që jemi duke e diskutuar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Emrush Xhemajli.

EMRUSH XHEMAJLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ligji për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë është shumë i nevojshëm për fazën që po e kalojmë, për një popull që ka vuajtur shumë dhe ka nevojë për rend dhe qetësi dhe për respektim të vendit ku jetohet, vendit ku pushohet dhe ambientit në përgjithësi.

Tash u tha ajo çka është dashur. Unë desha ta tërheq vërejtjen për dy çështje: E para, neni 5 dhe neni 11, rreth ekspozimit të materialeve të turpshme, për të mos e lexuar edhe një herë, direkt këto nene i shkelin të drejtat dhe liritë e njeriut. Konkretisht, e shkelin të drejtën e të shprehurit të qytetarit që ndalohet, është e dënuar me të gjitha konventat ndërkombëtare, ajo e drejtë nuk mund të shkelët në këtë mënyrë. Që në çfarë mënyre, bie fjala, që qysh thuhet: “Kushdo që shpërndan ose ekspozon ndonjë shkrim, shenjë ose paraqitje tjetër të dukshme, e cila ofendon ose turpëron dike me qëllim që të nxisë prishjen e rendit dhe të qetësisë”. Po, i ke pasur njësoj edhe në ligjin e mëhershëm, neni 133 ka qenë përpara, në kohën mëhershme, alineja 1 ka thënë kështu: “Kush e prish rendin dhe qetësinë përmes fjalës, të shprehurit, vizatimit apo karikaturës”. Edhe unë jam njëri prej atyre që jam dënuar përpara me këtë farë neni. Domethënë, ky dënohet me kaq e aq. Domethënë, kjo duhet jo të revidohet, siç u tha këtu dy-tri herë, por kjo duhet të hiqet për gjithmonë në këto hapësira. Kjo është e para që desha ta tërheq vëmendjen, si diçka shumë serioze në këtë ligj.

E dyta, te shpërndarja e dënimeve, kush e ka bërë rangimin, thjeshtë nuk ka pasur kurrfarë kujdesi, për të mos thënë më hollë, është tallur. Që, një shembull konkret. I kemi afaristët që i përmendëm dy a tre, janë dënuar 4-500 euro, ndërsa personi fizik është dënuar 100, 200, 30 euro e nuk di çka. Ndërkaq, është këtu një nen, neni 10, ia vlen për të lexohet krejt, për parë se si është dënuar ky.”Kushdo që në vend publik kërkon lëmshë në mënyrë tepër të bezdisshme, dënohet në kundërvajtje”

Tash, alineja 2. “Kryerësi i kundërvajtjes nga paragrafi 1”, domethënë është fjala për këtë lypësin që po kërkon lëmshë, “dënohet me gjobë prej 30 euro deri”, që shikoni, mos besofshi, “deri në 500 euro”. Ky ka dalë të lypë. Pra, unë thjeshtë e pyes veten edhe ju, qysh do të ekzekutohej ky farë lloj dënimi, a është fjala për t’ia marrë ndonjë para që e ka mbledhur, apo për çka është fjala këtu, thjeshtë, unë nuk po e kuptoj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Xhamajli! Fjalën e ka deputeti Naim Rrustemi.

NAIM RRUSTEMI: Ju faleminderit, kryesues!

Unë nuk do t’i përsëris, edhe pse shumica e diskutuesve i prekën gati të gjitha nenet një pas një, sepse ky dokument në përgjithësi po duket se është i dizajnuar me një terminologji shumë relative, që lë shumë kuptueshmëri dhe mungon saktësia dhe preciziteti.

Por, sido që të jetë, unë do ta jap një sugjerim konkret. Për shembull, në nenin 8, shkeljet që kanë të bëjnë me zhurmën, ku thuhet se “kushdo që shkakton zhurmë të panevojshme dhe të padurueshme”, të saktësohet saktësisht niveli i zhurmës, niveli i zhurmës të saktësohet, të saktësohet me njësi matëse, për shembull me decibel, me këtë nivel të zhurmës që e tejkalon apo të jetë në harmoni me Ligjin për zhurmën. Gjithashtu, i përkrah edhe deputetët tjerë që të zvogëlohet ora kur mund të bëhet zhurmë që mund t’i bezdisë të tjerët. Prapë po kthehem në atë, nëse ne veç vendosim madhësi të sakta, atëherë edhe implementimi i këtij neni do të ishte shumë më i lehtë, sepse është e mundshme dhe thuhet që të jenë në harmoni me Ligjin mbi zhurmën dhe nuk tolerohet, nuk lejohet që të kalohet kaq e kaq decibel, 40 në këto vende, e 30 në vende tjera. Kjo e bën ligjin shumë më adekuat. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit të gjithëve! Diskutues të tjerë nuk ka. Në vazhdim, kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të projektligjit.

Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim. Votojmë tani:

Konstatohet me 61 vota “për”, 1 “kundër” dhe 5 abstenime, miratohet Projektligji për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike.

Në bazë të Rregullores së Punës të Kuvendit të Kosovës, Kuvendi ngarkon këto Komisione:

- Komisionin për Punë të Brendshme dhe Siguri, si komision funksional
- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisionin për Buxhet dhe Financa,
- Komisionin për Komunitete dhe
- Komisionin për Integritet Evropian.

Vazhdojmë me pikën e gjashtë:

Shqyrtimi i parë i Projektligjit për armët

Në bazë të Rregullës 35.1 të Rregullores së Punës janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim, të këtij projektligji.

Ftoj ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Zenun Pajaziti, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektligjin.

ZENUN PAJAZITI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë e kolegë,

Më lejoni që krejt shkurt të bëj prezantimin e këtij projektligji për faktin se siç e dini, vitin e kaluar e kishim të gatshëm, e kemi pasur edhe një rast, një prezantim të këtij projektligji. Siç e dini, ka pasur kërkesa që të bëhet harmonizimi i këtij projektligji me disa ligje të tjera, siç është ai për sigurime private dhe ligje të tjera.

Siç e dini, tashmë është koha e fundit që ne ta kemi ligjin në vend të aprovuar dhe të zbatueshëm. Fushëveprimi i këtij projektligji është rregullimi i kushteve për blerje, posedim, mbajtje, ruajtje, prodhim, riparim, paaftësim, tregtim, shitje, gjurmim, transportim dhe importim të armëve për personat fizikë dhe personat juridikë brenda territorit të Republikës së Kosovës dhe eksportimi nga Republika e Kosovës. Siç e dini, në Kosovë ende ekziston një numër i madh i armëve që mbahen ilegalisht. Kemi statistika të ndryshme që vijnë, qoftë nga institucionet vendore apo ato ndërkombëtare. Ajo që është për t'u konstatuar është që numri i madh i tyre shkakton edhe rrezik për qytetarët, kur kemi parasysh që një numër i tyre mbahen në kushte jo të mira dhe janë kryesisht të llojeve të ndryshme që kanë rrezik për përdorimin e tyre.

Projektligji është në përputhje me legjislacionin e BE-së. Ju e keni parë në dokument se ka edhe një kosto buxhetore, e cila ka një vlerë të konsiderueshme. Ne i kemi bërë të gjitha përgatitjet dhe e kemi prezantuar në kornizën afatmesme. Këtu nuk e keni, po ashtu, meqë ky projektligj ose aprovimi i këtij ligji, po ashtu, do të ketë të hyra buxhetore dhe do të ketë një numër, një kosto buxhetore që do të jetë si rezultat i zbatimit të këtij ligji.

Në përgjithësi, ne mendojmë që janë pjekur kushtet që Kuvendi i Kosovës ta procedojë më tutje këtë projektligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Tani kryetari ose raportuesi i Komisionit funksional për Punë të Brendshme dhe Siguri e ka fjalën. Ftoj deputetin dhe kryetarin e Komisionit, Rrustem Mustafa, që ta marrë fjalën.

RRUSTEM MUSTAFA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Në pajtim me Rregulloren e Kuvendit të Kosovës, Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, në mbledhjen e mbajtur më 14 prill 2009, ka shqyrtuar Projektligjin për armë, nr. 142/1L dhe kemi vendosur t'ia rekomandojmë Kuvendit që ta miratojë ligjin në parim, në leximin e parë.

Për informim të deputetëve, ju njoftoj se Projektligji për armë ka qenë edhe më herët i miratuar në lexim të parë, në Kuvend, por Komisioni kishte rekomanduar t'i kthehet Qeverisë në rihartim dhe ky është draft i përmirësuar dhe ne ju ftojmë për ta votuar.

Do ta shfrytëzoj rastin, zoti kryesues, të flas edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës. Të njëjtën gjë edhe Grupi Parlamentar rekomandon për ta aprovuar ligjin në lexim të parë.

Unë, nëse më lejohet që t'i them disa vërejtje që kanë filluar veç të vijnë dhe janë cekur, qoftë nga anëtarët e komisionit, qoftë nga njerëz të tjerë, ku flitet për disa gabime edhe në draftin e ri të ardhur, por që janë, që mund të amendohen brenda komisionit. Domethënë, nuk flasim për t'ia kthyer prapë Ministrisë, sepse e dimë që edhe në Ministri edhe në komision janë mbajtur disa herë grupe punuese edhe punëtori për këtë ligj dhe i kënaq interesat tona tash për të shkuar në procedim të mëtutjeshëm, por janë disa gabime që do t'i shohim me vonë.

Për shembull, unë po e përmend paragrafin 1.3, është një shprehje e përgjithësuar, ku thuhet: "Rrethanat tjera që tregojnë se armët e zjarrit mund të keqpërdoren". Nuk përcaktohen veç e veç se për të cilat rrethana është fjala. Këtu duhet të ndryshohet me qëllim që ligji të jetë më preciz. Kështu siç është, kemi rekomandime se ligji mund të ketë kufizime arbitrare në dhënien e lejeve për armë nga ana e zyrtarëve.

Kështu që, mendoj se të gjitha këto vërejtje që janë paraqitur edhe në Grupin parlamentar, edhe në komision, unë besoj që me kohë në komision do të shqyrtohen dhe do të amendohen. Komisioni ka caktuar edhe referuesin për këtë ligj, i cili në vazhdimësi do t'i pranojë edhe rekomandimet e deputetëve tjerë që vijnë për ta proceduar më tutje. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Agim Veliu.

AGIM VELIU: Ju faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Duke pasur parasysh se në Kosovë ka një numër të madh të armëve ilegale, siç u tha edhe nga ministri, është nevojë urgjente që të aprovohet Ligji për armët.

Varianti i tashëm i projektligjit ndryshon pak nga ai varianti i mëparshëm që ka qenë në procedurë, mirëpo si të tillë Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah në parim, ndërsa vërejtjet që i kemi do t'i përcjellim përmes deputetëve tanë në procedurat e mëtejme të aprovimit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputetja Suzan Novobrdaliu.

SUZAN NOVOBRDALIU: Ju faleminderit, zoti kryesues! Grupi Parlamentar i AKR-së në parim e përkrah këtë projektligj. Konsideron se për këtë periudhë i njëjti është i domosdoshëm dhe jep mundësinë e mbajtjes së armës në mënyrë ligjore nga personat civilë.

Vërejtjet të cilat i kemi, janë se çështjet esenciale nuk rregullohen me këtë projektligj, por lihet mundësia që rregullimi të bëhet me akte nënligjore. Andaj, shpresojmë se Komisioni gjatë amendamentimit të këtij projektligji, çështjet e papërfshira në këtë projektligj do t'i përfshijë dhe nuk do ta lë mundësinë që çështjet me rëndësi të rregullohen me aktet nënligjore.

Tek neni 31, të legalizimi i armëve, konsiderojmë se i njëjti duhet të hiqet dhe për çështjen e legalizimit të armëve duhet të punohet një ligj i posaçëm, duke marrë parasysh numrin e madh të armëve që duhet të legalizohet, e jo çështja e legalizimit të rregullohet me akt nënligjor, i cili mund të jetë i kufizuar ose akt politik i ndonjë ministrie.

Gjithashtu, kemi edhe vërejtje tjera, mirëpo tani nuk do t'i përmend. Të njëjtat do t'ia japim komisionit përkatës në formë të shkruar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Maloku.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,
Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së të jap disa vërejtje, në fakt të pakta që i kemi në këtë projektligj, për faktin se ky projektligj është punuar gjatë, është punuar mirë dhe, duke qenë edhe pjesë e ekipit që ka punuar në rihartimin e këtij projektligji, mund t'ju them se i përgëzoj ministrin, stafin e tij, këshilltarët dhe zyrën ligjore për angazhimin që e kanë pasur në rihartimin e këtij projektligji. Ju e dini që i ishte kthyer Qeverisë për rihartim, ripunim. Pra, është një punë e mirë që është bërë dhe një gatishmëri e theksuar, e shprehur që ky projektligj të vijë dhe të hartohet projektligj i mirë.

Më lejoni të them se janë dy dilema që i kisha shprehur në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, që kanë të bëjnë me nenin 7 të këtij projektligji, ku përcaktohen kushtet apo kërkesa e personit fizik për blerjen e armës së zjarrit. Ju keni parasysh, dua t'ua them, neni 7, pra paragrafi 1.5, ku thotë: "Ka shkaqe të arsyeshme për blerjen e armës së zjarrit".

Ky paragraf, të nderuar deputetë, e kufizon në masën ekstreme dhënien e lejes për marrjen e armës. Cilat janë ato shkaqe të arsyeshme që duhet t'i ketë një person, për

shembull, për të pasur një armë apo për ta fituar lejen për ta blerë dhe për ta pasur armën në posedim? Pra, kjo është një dilemë praktikisht që ky paragraf mendoj që do të kufizojë në masë të madhe edhe një prej qëllimeve të këtij projektligji, legalizimin e ardhmëve të vogla ekzistuese që janë në Kosovë. Ministri i tha disa vlerësime, por unë nuk isha bazuar në ato vlerësime që japin organizatat joqeveritare ose organizatat e ndryshme ndërkombëtare që Kosovës praktikisht ia veshin që qytetarët e Kosovës kanë diku me qindra e mijëra armë në posedim dhe me ato të dhëna, që kinse bazohen në disa analiza dhe anketa, praktikisht e bëjnë Kosovën të rrezikshme dhe qytetarët e Kosovës me një rrezikshmëri të lartë, pra vet gjendjen këtu.

Mendoj se këtu duhet të liberalizohet ky nen, pra faktet dhe kërkesat që duhet personi fizik për t' i plotësuar për dhënien e lejes për të pasur armë dhe, normalisht, legalizimi i armëve ekzistuese, zoti ministër dhe të nderuar deputetë, pra duhet në forma tjera, pra të mendohen forma dhe mënyra tjera se si të bëhet legalizimi i armëve. Janë nenet, që janë kategorizimi atyre armëve, mundësia në armë të trofeve ose armë të vjetra, e tjera. Pra, këto duhet të jenë ato mënyrat dhe aksionet që duhet ndërmarrë me qëllim të legalizimit të armëve dhe mos të mbeten, mos të ketë pra armë jo legale. Qëllimi i këtij ligji është që qytetarët e Kosovës të mos posedojnë armë jo legale, por të jenë armë legale të cilat i kryejnë ato atestet, kontrollin teknik, kontrollin periodik, janë të regjistruara, është balistika e tyre e kryer, që në qoftë se ndodhin krimet ose tjera, hyhet në databazë dhe menjëherë dihet se nga cila armë, nëse pra përdorën dhe kush është posedues i asaj. Pra, ky ligj e ka qëllimin e rritjes së nivelit të sigurisë të qytetarëve dhe të sigurisë në Kosovë.

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së edhe njëherë ta përgëzojmë ministrin që e ka bërë Ministria e tij dhe stafi që është marrë me hartimin e këtij ligji dhe e mbështesim në parim, pra, këtë projektligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Maloku!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputeti Gani Geci.

GANI GECI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Projektligji për armët ka qenë mjaft i nevojshëm edhe më herët për qytetarët e Republikës së Kosovës, për faktin se në Kosovën e pasluftës një numër i konsideruar i armëve ekziston në duar të qytetarëve. Pra, ky projektligj vendos rregullat ligjore për blerje, posedim, mbajtje, ruajtje, prodhim, riparim, paaftësim, aftësim, tregtim dhe shitje, si dhe rregullon transportin dhe importin e armëve për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Edhe pse ky ligj është dashur të miratohet më herët, dhe ne e kemi miratuar një herë në lexim të parë, por për shkaqet që dihen, është kthyer dhe ne kemi punuar së bashku me të tjerët që ta harmonizojmë, prandaj ne si Grup Parlamentar, pra Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, do ta shqyrtojë edhe në leximin e dytë dhe e mbështesim në parim. Vërejtjet tona eventuale do t'i adresojmë, qoftë në komisionin funksional, qoftë në Kuvendin e Republikës së Kosovës më vonë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar” 7+”, Enis Kervan

ENIS KERVAN: Ju faleminderit, zoti Kryesues!

Silahlar Yasası kendi alanındaki boşlukları doldurması anlamında gerekli olan bir yasadır. Özellikle yasa dışı illegal silahların yasallaşmasında önemli rol oynayacaktır. Söz konusu Yasa Tasarısıyla silahların legal satın alımı, kullanışı, üretimi, ticareti için şartlar yaratılacaktır. Ayrıca Yasa Tasarısı, Kosova dışında transit silah ihracat ithalat koşullarını da düzenleyecektir. Bu Yasa Tasarısı askeri silahlanmasını, Kosova Güvenlik Güçleri Bakanlığı ihtiyaçları, İçişleri Bakanlığı ihtiyaçları, polis ve devlet tarafından vekalet verilen organların ihtiyaçları için uygulanmayacaktır. Silah ve muhimatları Yasa Tasarısına göre sadece İçişleri Bakanlığı tarafından verilen izin belgesi sayesiyle gerçekleşecektir. Üretim içinde uzmanlar Güvenlik Güçleri Bakanlığının görüşü alındıktan sonra İçişleri Bakanlığının lisansı vermesiyle gerçekleşecektir. İçişleri Bakanlığının 2009 yılı Bütçesinde Silahlar Yasası ile ilgili hiçbir aktivite bütçesi uygun görülmemiştir. 2 412 620 euro tutarlı Bütçe, 2010 ve 2011 yılı sıralı bütçe planlamasında uygun görülmelidir. Ancak bu şekilde Yasa yürürlükte olmuş olacaktır ve hedefe ulaşılacaktır.

7+ Paralemter Grubu Tasarının ilk okunuşunu desteklerken, katkılarını sunacağını özüt önerilerle komisyona iletecektir.
Ju falënderoj!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, deputeti Bojan Stojanović

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!

Parlamentarna Grupa SLS je razmatrala ovaj zakon i mislim da je on dobar i da ćemo mi moći da podržimo ovaj zakon, ulazak na prvo čitanje u Skupštinu. Sve svoje sugestije i primedbe ćemo dati preko funkcionalnih komisija. Međutim, mislim da i kada se zakon bude usvojio ovde ... će biti 15 dana nakon usvajanja ovog zakona na drugom čitanju, ali on ne znam koliko će biti praktično primenjen zato što vidim da je i Ministarstvo za rad i socijalnu politiku čak, pri Ministarstvu zdravlja mora da učestvuje u proceni i sposobnosti fizičkih lica za posredovanje kako vatrogas, tako i lovskog oružja. Mislim da je ono što je bitno, da treba da Ministarstvo zdravlja i Ministarstvo za rad i socijalno politiku tako naprave podzakonska akta ili šta već sa Ministarstvom unutrašnjih poslova, da kada se taj zakon donese, da on bude praktično i primenjen. Naravno, on će regulisati mnoge stvari. Smatram da je ovaj Zakon bio neophodan i kažem još jednom, podržavamo njegovo ulazak u skupštinsku proceduru i na prvom, a nadam da će naše sugestije biti usvojene u komisijama, pa ćemo tako moći da podržimo i na drugom čitanju. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Tani të paraqitur të tjerë në emër të grupeve parlamentare nuk ka. Janë të paraqitur disa deputetë që donë të flasin. Fjalën e ka deputeti Shkumbin Demaliaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Do të jem i shkurtër dhe i qartë lidhur me rëndësinë që ka projektligji dhe kërkesa edhe një herë të jetë më bindëse që deputetët sot ta aprovojnë në parim këtë projektligj për shkak se ne në bashkëpunim edhe me mekanizmat ndërkombëtarë që funksionojnë në Kosovë dhe me vetë pajtimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme më herët, si komision parlamentar kemi parë të arsyeshme që të kthehet në procedim edhe një herë te Qeveria projektligji që të vijë i modifikuar ashtu si është sot.

Është e vërtetë se shumë prej dispozitave ligjore, për t'u bërë ligji më i implementueshëm, kanë mbetur për t'u rregulluar me akt nënligjor, mirëpo krahas gjithë kësaj janë, si të them, akte aq të shkurta sa më shumë rregullojnë çështje aplikative, sepse duke përfshirë prej poligoneve dhe vendeve, forma se si do të jetë aplikacioni i aplikantëve që dëshirojnë të posedojnë armë, mirëpo përmbajta dhe rëndësia më e madhe që të aprovohet sot ky projektligj, është që të harmonizohen ligjet e dy ministrive më të rëndësishme që i kemi në sferën e sigurisë, sepse është e përfshirë shumë në do dispozita edhe Ministria e Forcës së Sigurisë. Pra, dihet se shumë shpejt do të duhej të armatosej edhe Forca e Sigurisë dhe harmonizimi i këtyre dispozitave në mes këtyre dy mekanizmave të rëndësishëm institucional që rregullojnë sigurinë në Kosovë, do të thotë e bën edhe më të përgjegjshëm këtë Kuvend që sot ta aprovojme në parim këtë projektligj. Te dispozitat ndëshkuese ka një, ka rrëshqitur, sigurisht, një defekt teknik, sepse nuk përcakton kundërvajtje për personat fizikë, ndërkaq te personat juridikë e lë që të rregullohet me akt nënligjor një pjesë e masave ndëshkuese. Pra, shpresojmë dhe si grup parlamentar e përkrahim projektligjin, por edhe si referues i këtij projektligji do ta jap përgjegjësinë time se do ta rregullojmë, amendamentojmë që në leximin e dytë ligji të jetë përmbajtjesor dhe i implementueshëm. Ju faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka Berat Luzha.

BERAT LUZHA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Neni 11 përcaktohen personat fizikë, të cilëve mund t'u lëshohet leja ose pëlqimi për blerjen e armës së gjuetisë. Meqenëse edhe për gjueti nevojitet një lloj kualifikimi, unë mendoj se këtij neni duhet t'i shtohet pika 2 dhe kjo pikë të duket kështu: "Leja e armës së gjuetisë u jepet vetëm personave që e kanë të dhënë provimin për gjueti dhe që janë anëtarë të shoqatave të gjuetarëve në bazë të certifikatës së lëshuar nga shoqatat". Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Unë e lus personelin teknik që t'i thërrasë deputetët dhe t'i bien ziles, sepse është vetëm edhe një deputet dhe duhet ta votojmë ligjin.

Deputeti Riza Smaka e ka fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuar, zoti kryesues!

Ministra dhe deputetë,

Në parim ky ligj është i nevojshëm dhe duhet të mbështetet, megjithëse ka defekte. Unë, po e zëmë, si qytetar dhe deputet, do të isha angazhuar që në Kosovë të ketë leje për mbajtje, bartje, posedim të armës vetëm ai apo ajo që e ka uniformën. Do të thotë, do të kisha shkuar në këtë koncept që ky ligj të bëjë restriksione rigoroze edhe të mos jep mundësi çfarë, po e zëmë ka këtu, që sipas disa dispozitave, një që e kam identifikuar, kushdo, kurdo që do të kërkonte leje, do të merrte. Kjo duhet të rregullohet, se ndryshe ka shumë psikopatë, neuropatë e debilë e imbecilë e idiotë që kanë armë e janë shumë të rrezikshëm për ambientin, apo jo, prandaj do të duhej të bëjmë atë që është e mundur që të çarmatosen njerëzit e tillë edhe armën ta mbajnë vetëm ata që me të vërtetë kanë nevojë për armë.

Bie fjala, ka shumë, po ndër tjera, thotë: "regjistrin ekonomik." Në Kosovë nuk ka regjistër ekonomik. Ka regjistër biznesor edhe kjo sipas Ligjit për organizatat biznesore duhet të korrigjohet.

“Mbytësi i zhurmës”, qysh mbytet zhurma? Zhurma ngulfatet, ka shprehje të rënda inadapte. Duhet të rishikohen këto. Edhe disa vërejtje substanciale.

Neni 7 thotë: “Pëlqimi për blerjen e armës së zjarrit i lëshohet personit fizik në bazë të kërkesës së paraqitur nga ai”. Do të thotë, sipas këtij diksioni, vetëm parashtrës, vetëm kërkesa do të ishte e suficiente për ta marrë lejen dhe duhet të plotësohet me mund që t’ia jep autoritetin organit kompetent për ta refuzuar, bie fjala.

Te neni 9, pjesa e alinesë, aftësia për posedimin dhe mbajtjen e armës përcaktohet përmes vërtetimit mjekësor. S’ka kush që nuk do të mund ta merrte një vërtetim mjekësor në kushtet e sotme, por do duhej medoemos që të riformulohej e të thuhej: “në bazë të lejes, mendimit të komisionit special mjekësor prej 5 anëtarësh”. Do të thotë, një komision institucional prej mjekëve kompetentë të fushave të caktuara, e jo kurrësi të një mjeku, respekt për një mjek, por një mjek gjithmonë mund të korruptohet dhe të japë një letër e në bazë të asaj letre ta marrë armën.

Te neni 48, referuar termit “trashëgimia e armës së zjarrit”. Medoemos do të duhej rishikuar dhe riformuluar esencialisht, sepse leja për blerje, mbajtje, bartje dhe përdorim të armës së zjarrit është akt juridik individual i dedikuar personit të identifikuar dhe të konfirmuar si të kualifikuar afirmativisht me veti të mira konform me ligjin, ndaj suksesor apo sukesorja i tij apo e saj, asnjëherë apriori nuk është e thënë, as praktikë e mirë, që automatikisht të shpallet trashëgimtar. Mund ta trashëgojë tokën, vreshtin, livadhin, shtëpinë, banesën, por jo edhe armën, pse i ati e paska pasur armën, e ky ndoshta nuk i ka ato cilësi që duhet t’i ketë sipas ligjit për ta trashëguar armën, se do të ishte një zgjidhje anakronike.

Edhe përfundimisht, dispozita e nenit 72 -Personat fizikë e juridikë. Kjo është një dispozitë tipike, shembull se si nuk mund të formulohet dispozita. Është një antidispozitë, një shembull i mirë për t’i treguar kujtdo se ja si bëhet formulimi më i keq i mundur. Ja, konkretisht: “Personat fizikë e juridikë që veprojnë në kundërshtim me ligjin duhet të sanksionohen”. Kjo është, si të them shprehje moraliste. Nuk është mirë, se të gjen e keqja, ose “lloji dhe lartësia e sanksioneve përcaktohen me akt nënligjor”. Shikoni, ju lutem, kolegë, me këtë formulim do t’i merrej ingerenca, juridiskcioni, kompetenca, legjislativit që është i vetmi eskuzivisht i autorizuar për të caktuar, po e zëmë, sanksione dhe do t’i jepej aktit nënligjor, të cilin do të kishte mundësi për ta miratuar ministri, që është ekzekutivi, që është në kolizion me ndarjen dhe kontrollimin reciprok të pushteteve. Prandaj, ky është një formulim krejtësisht i papranueshëm edhe nuk mund të gjejmë formulime të këtilla. Prandaj, do të duhej këto që i identifikova edhe të tjera ka, natyrisht në procedurë, por ju lutem procedura, siç e dimë, është mjaft e koklavitur dhe e vështirë për të ardhur në shprehje, prandaj, puna më e lehtë është që ai i cili e ka hartuar projektin, si të them, t’i bëjë këto riformulime vetë, se i bën më lehtë dhe më shpejt se sa me amendamente. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputetja Nurishahe Hulaj u lajmërua tash.

NURISHAHE HULAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Vetëm disa çështja desha t’i paraqes këtu në Kuvend. Shpesh ndodh zhvillimi i filmave përmes ekraneve televizive me karakter dhune në çdo kohë, duke përdorur armë të zjarra, të ftohta e të tjera, e që kjo ndikon në psikikën e fëmijëve me orientim dhune, të cilët kanë një interesim shumë të shprehur ndaj këtyre filmave me karakter dhune.

Është me rëndësi që me një amendament të rregullohet kjo çështje. Pra, si duhet të rregullohet kjo çështje? Të bëhet kështu: Me këtë ligj të ndalohet zhvillimi i filmave me karakter dhune përmes televizioneve publike deri para orës 11:00 të natës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Konstatohet që diskutimet kanë përfunduar, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratim në parim të projektligjit. Lus regjinë dhe deputetët që të bëhen gati për votim.

Votojmë, tani:

Konstatohet që me 62 vota “për”, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, miratohet Projektligji për armët. Ju faleminderit!

Në bazë të Rregullores së Punës, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Punë të Brendshme dhe Siguri, si komision funksional,
- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisionin për Buxhet e Financa,
- Komisionin për Komunitete, dhe
- Komisionin për Integritet Evropian.

Unë e kuptoj që jemi lodhur pak. Në qoftë se mendoni që duhet ta kemi një pauzë ose...

(Ndërhyrje nga salla)

Jo, nesër nuk është mirë, se mund ta kryejmë sot, se e kemi edhe pak punë. Atëherë, a të vazhdojmë ta kryejmë. Okej. Ju faleminderit! Vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për partneritet publiko-privat dhe koncesionet për sigurimin e infrastrukturës dhe të shërbimeve dhe procedurat për dhënien e tyre

Lidhur me këtë, është paraqitur deputeti Gani Koci, kryetar i Komisionit për Buxhet.

GANI KOCI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Këtë që tash duhet ta them, ndoshta është dashur ta them në fillim të seancës, por nuk i kemi pasur dhënë të gjitha, ndoshta edhe informacionet edhe sugjerimet, prandaj, në emër të Komisionit, për shkak të disa paqartësive rreth amendamenteve të Projektligjit për partneritet privato-publik dhe koncesione, kërkojmë që të shtyhet për seancën e ardhshme, në mënyrë që ne si Komision, bashkërisht me Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave, që ka pasur disa vërejtje rreth disa amendamenteve, t'i harmonizojmë ato dhe t'i sjellim në seancën e ardhshme për miratim. E di që ndoshta ky ligj, që është më se i nevojshëm për Kosovën, sidomos për këtë fazë nëpër të cilën po kalojmë dhe ndoshta është vonuar dhe kemi punuar mjaft gjatë ne si Komision dhe me seriozitetin më të madh me të gjithë aktorët, që në formë të ndihmave të ndryshme, edhe profesionale në këtë drejtim, por e shohim të udhës që deri në seancën e ardhshme të shtyhet ky projektligj për shkak të qartësimit të disa çështjeve, amendamenteve që sot janë prezantuar këtu.

Nuk desha të vazhdoj, por tha Ganiu - i ka ra pishman. Nuk i kam ra pishman absolutisht, por dua të, nëse më kujtohet një poezi e një poeti të njohur kosovar, që thotë:

“le të bijën mbi mua meritë e qiellit, veç le të ruhet bukuria e tokës”. Unë në këtë rast dua të them:” le të bien mbi ne deputetët edhe Kuvendit edhe meritë e qiellit edhe të tokës, veç le të ruhet ajo që quhet Kosovë”, domethënë bukuria e Kosovës.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Sipas kësaj, kërkoj që për propozimin e Gani Kocit, në emër të Komisionit për Buxhet, të deklarohen kryetarët e grupeve parlamentare ose grupet parlamentare. Ftoj zotin Buja që të deklarohet në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

RAMË BUJA: Zoti kryesues, unë do të përpiqem të jem më pak poetik se Ganiu dhe të them që ky ligj ka rëndësi të veçantë për Kosovën dhe, meqë është kështu, atëherë do të kishim kërkuar vërtet që të kemi pak kohë që të konsultohen faktorët relevantë për ta bërë më të mirë këtë ligj, kështu që të shohim se si dhe pastaj... për ta shtyrë edhe për një kohë.

KRYESUESI: Okej. Zoti Haziri! Shkurt besoj.

LUTFI HAZIRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Grupi ynë parlamentar e mbështet kërkesën e kryetarit të komisionit parlamentar duke besuar që ministri do të arrijë ta finalizojë për seancën e ardhshme, sepse ligji është i domosdoshëm, ka kaluar 9 muaj nëpër shumë procedura dhe është jetik për proceset që janë në programin qeveritar.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zonja Riza Hajzeraj në emër të AKR-së.

RITA HAJZERAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i AKR-së është për propozimin e deputetit, zoti Gani Koci. Gjithashtu, ne shpresojmë që në seancën e ardhshme gjithsesi të vijë ky projektligj, duke pasur parasysh që kemi nevojë shumë për këtë Projektligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit dhe me fal!

Në emër të LDD-së, Berim Ramosaj.

BERIM RAMOSAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë kisha një vërejtje parimore që vërtet të bëhen konsultimet paraprake dhe me kohë dhe mos të vijnë në këso pozitash të palakueshme, që kryetari i komisionit apo shefat e grupeve parlamentare të deklarohen sot, kur vërtet ishim të përgatitur për një ligj të tillë.

Sa i përket arsyeshmëri, unë besoj që nuk ka nevojë të thuhet, sepse vërtet i duhet një ligj i partneritetit, mirëpo duke marrë parasysh rolin shumë të madh që do të ketë komisioni ndërminstor për përcjelljen, menaxhimin e tërë procesit koncesional, respektivisht të krijimit të këtyre marrëdhënieve partneriste - publike dhe private, kemi shumë vërejtje, mirëpo edhe duke marrë parasysh involvimin e katër ministrive të tjera, që nuk është në pyetje vetëm Ministria për Ekonomi dhe Financa, por edhe ministrinë tjera, që sigurisht do të gjenden si partnerë në këtë projekt gjatë implementimit, do ta bëja një propozim që të shkojë edhe në Komisionin funksional për Ekonomi, Transport, Energjetikë dhe Miniera, duke marrë parasysh se shumica e lëndëve të kësaj natyre të partneritetit publiko-privat do të jenë të fushës së caktuar dhe besoj që edhe ne si komision funksional të ta japim kontributin dhe sigurisht do ta nxjerrim në ligj më të mirë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Tani fjalën e ka Myfera Shinik, në emër të Grupit parlamentar” 7+ “

MYFERA SHINIK: Ju faleminderit!

Gündemin yedinci noktası gündemin önemli bir Yasa Tasarısını göstermektedir. Bunun için Bütçe Komisyonu başkanı teklifinin üzere zaman açısından amandmanların yeniden gözden geçirilebilmesi için gelecek meclis toplantısında gündeme getirilmesi öneriliyor. Buna da 7 + Parlementer Grubu olarak kabul ediyoruz.

Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, Bojan Stojanović.

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke podržava predlog i prihvata obrazloženje predsjednika komisije da se ova tačka povuče sa dnevnog reda sobzirom da su se svi složili. Ovaj Zakon je kako bitan, a da resorno ministarstvo sigurno ima kapacitete da poboljša ovaj zakon i da je samo tražilo rok, pa kada bude završilo, ponovo će doći u skupštinsku proceduru. Ništa nećemo izgubiti ako to traje i 15-20 dana, bolje bolji zakon malo kasnije, nego odmah nešto što ćemo kasnije ispravljati. Hvala!

KRYESUESI: Atëherë, e hedh në votim formal, meqenëse të gjitha grupet janë dakord që Projektligji për partneritet publiko-privat dhe koncesionet për siguri të infrastrukturës dhe të shërbimeve dhe procedurat për dhënien e tyre, të shtyhet për seancat e ardhshme.

Votojmë, tani:

(Ndërhyrje nga salla)

KRYESUESI: Jo, jo, u krye diskutimi. Ju lutem, se nuk po votohet. Unë mendoj që të gjithë deputetët janë të lirë të marrin pjesë në secilin komision që shqyrtohen ligjet dhe të kontribuojnë, meqenëse unë nuk mund t'i detyroj deputetët sot ta sjellë këtë ligj në komisionin e juaj. Më fal!

Regjia gati për votim! Votojmë, tani që ligji të shtyhet.

Konstatohet se me 58 vota “për”, tri abstenime, 1 “kundër”, shtyhet shqyrtimi i këtij projektligji për seancën e ardhshme.

Berim, mocion është. Të lutem, kur të duash mund të bësh mocion bashkë me 6 deputetë të tjerë, ju lutem. Unë nuk mund ta bëj, nuk kam të drejtë ta hedh në votim...

(Ndërhyrje nga salla)

...shumë mirë po e di, nuk kam të drejtë, nuk ma jep këtë të drejtë Rregullorja që mbi bazën e propozimit tënd të kërkoj sot që ky ligj të shqyrtohet në komisionin përkatës...

(Ndërhyrje nga salla: Pse?)

... nuk kam të drejtë në bazë të Rregullores. Ky është mocion dhe meqë është mocion, ti kërko në emër të komisionit dhe unë besoj që Kryesia në javën e ardhshme mund t'ua dërgojë. Pra, unë nuk e kam atë fuqi ta kërkoj sot. Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Protokollin e Shtetit të Republikës të Kosovës

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e Projektligjit me amendamentet e propozuara. Raportet me rekomandimet të komisioneve u janë shpërndarë deputetëve. Para se të procedojmë me votim të amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit funksional, zotëri Sabri Hamitin apo raportuesin e komisionit, që para deputetëve ta arsyetojë Raportin me rekomandime.

SABRI HAMITI: Kolegë të çmuar, zoti kryesues i seancës, Haliti, Ne kemi krijuar një komision raportues. Komisionin raportues e ka udhëhequr zoti Avdiu, i cili sot nuk është këtu. Ne e kemi paraparë që ai të raportojë për amendamentet dhe procedurën. Unë mendoj që diçka substanciale të veçantë nuk kam që ta them këtu. Ju them që katër herë komisioni është mbledhur për këtë ligj. Ka punuar shumë, ka një numër të madh të amendamenteve, mirëpo me këto amendamente, të cilat një për një dhe të gjitha bashkë janë votuar në komisionin tonë, ky ligj rristrukturohet, saktësohet dhe plotësohet dhe unë ju thërras që t'i votoni amendamentet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Tani, të nderuar deputetë, vazhdojë me votimin e amendamenteve të propozuara, sipas radhës së paraqitur në raport. Si duket, nuk kemi kuorum, presim nja 2 minuta.

Atëherë, kuorumi është, 64 deputetë janë në sallë. Fillojmë votimin.

Amendamenti 1.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 48 vota “për”, 3 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 53 vota “për”, 1 abstenim dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tani:

Ju kisha lutur, mos ta pengoni seancën. Në qoftë se doni të votoni, votoni, është e drejtë e juaja të votoni ose mos të votoni. Në qoftë se e doni fjalën për amendament, përpara paraqituni, sepse ka mbetur pa u votua amendamenti duke mos pasur sqarime. Atëherë, edhe një herë e përsëris amendamentin 3, votojmë tani.

Konstatohet se me 52 vota “për”, 2 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 49 vota “për”, 2 vota “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 51 vota “për”, 1 votë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 53 vota “për”, 2 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 6.

Ju lutem, i hiqni kartelat e atyre që nuk janë këtu.

Amendamenti 7.

Regjia, votojmë tani:

Konstatohet se me 52 vota “për”, 2 “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 54 vota “për”, 3 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 8.

Zoti Makolli, e deshe fjalën? Urdhëro!

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Kam vërejtje sa i përket amendamentit 9, paragrafi 2, pas pikës, po e citoj si ekziston, thotë: “Zyra e Protokollit të Shtetit mbanë lidhje të ngushta me zyrat e protokolleve të institucioneve qendrore dhe lokale. Komunikon praktikat”, që nuk ka kuptim, ose duhet të jetë presje, ose duhet të kalojë në paragraf të ri, sepse kështu si është nuk ka kuptim, është i shkëputur. Pas pikës do të duhej të vije ose presje ose të kalojë në paragraf të ri dhe të thuhet: “Zyra e Protokollit komunikon praktikat protokollare”, por jo kështu si është. faleminderit!

KRYETARI: Kryetari i komisionit, keni koment? Okej, atëherë edhe kryetari i komisionit pajtohet me... Ju lutem, zotit Hamiti ia jepni fjalën, regjia.

SABRI HAMITI: Teksti është i plotë në shkrim, në vend të pikës vihet presje dhe teksti është i plotë. Vërejtja ishte në rregull.

KRYESUESI: Atëherë, vazhdojmë me amendamentin 9. Mendoj që edhe komisioni edhe propozuesi janë në dakord.

Votojmë amendamentin 9, me propozimet e zotit Makolli dhe miratimin e komisionit, të kryetarit të tij.

Amendamenti 9.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 55 vota “për”, 3 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 54 vota “për”, 3 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 55 vota “për”, 1 “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 52 vota “për”, 2 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 50 vota “për”, 2 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 54 vota “për”, 4 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 56 vota “për”, 3 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 53 vota “për”, 3 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 53 vota “për”, 3 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 55 vota “për”, 3 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 53 vota “për”, 3 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 54 vota “për”, 3 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 20.

Amendamenti 21.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 42 vota “për”, 2 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 21.

Amendamenti 22.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 54 vota “për”, 4 “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 22.

Amendamenti 23.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 49 vota “për”, 3 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 23.

Amendamenti 24.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 52 vota “për”, 2 “kundër”, 1 abstencion, miratohet amendamenti 24.

Amendamenti 25.

Zoti Makolli e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Kaluan edhe disa të tjera, por unë këtu po e përqendroj vëmendjen. Te paragrafi 3: “Intonohet himni shtetëror i Kosovës. Kryetari i Kuvendit fton Presidentin për të marrë fjalën përshëndetëse para Kuvendit”. Thjeshtë, nuk ka kuptim, sepse fjalitë janë të shkëputura dhe kështu nuk krijohet kurrfarë kuptimi i këtij paragrafi. Prandaj, do të duhej shikuar se çka? Nëse thuhet: “Kur intonohet himni shtetëror i Kosovës, Kryetari i Kuvendit...” thjeshtë është e pamundshme për të perceptuar se çka është dashur të thuhet me këtë. Lexojeni mirë! “Intonohet himni shtetëror i Kosovës. Kryetari i Kuvendit fton Presidentin për të marrë fjalën përshëndetëse para Kuvendit”. Nuk ka kuptim.

KRYESUESI: Urdhëro, zoti Hamiti, kryetar i Komisionit!

SABRI HAMITI: Shumë amendamente, nëse janë pa kontekst, duken që s’kanë kuptim, po ky është tekst që e saktëson ceremonialin e fillimit të punës së Presidentit të Republikës në këtë sallë. Nëse lexohet teksti i plotë, ky është saktësim i saktë dhe komisioni mendon që është variant i saktë dhe i duhur. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, votojmë amendamentin 25, variantin e Komisionit.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 50 vota “për”, 5 “kundër”, 4 abstencione, miratohet amendamenti 25.

Amendamenti 26.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 40 vota “për”, 2 “kundër”, 2 abstencione, miratohet amendamenti 26.

Amendamenti 27.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 55 vota “për”, 3 “kundër”, 2 abstencione, miratohet amendamenti 27.

Në sallë janë 66 deputetë.

Amendamenti 28.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 56 vota “për”, 2 “kundër”, 1 abstencion, miratohet amendamenti 29.

Amendamenti 29.

Zoti Smaka e ka fjalën.

RIZA SMAKA: Faleminderit!

Te amendamenti 29 do të kisha propozuar, ku është pika, mos të thuhet: “Ai ka...”, se është fjalia pa kryefjalë, e s’mund të ketë fjali pa kryefjalë, po duhet prapë të thuhet: “Kryetari i Kuvendit”, jo: “Ai ka të drejtë”, po: “Kryetari i Kuvendit ka të drejtë”. Në esencë nuk ndryshon, po gjuhësisht rregullohet mirë. Pra, propozoj që alineja 2, ku fillon pas pikës: “Ai”, të fillojë me: “Kryetari i Kuvendit”. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Hamiti, si kryetar i Komisionit.

SABRI HAMITI: Paj, fantastike është kur të japin ligjërata stili njerëzit që s'janë stilistë të fortë, po është në natyrën e njeriut të dëshmohet atje ku s'di shumë. Unë e kuptoj edhe këtë këtu, sepse gjithherë fjalia, përemri zëvendëson emrin. Kjo është rregull elementare gramatikore, po pse jo, nëse kolegët kanë qejf secilën herë të përsëritet “Kryetari i Kuvendit”, unë e akceptoj. Kaq.

KRYESUESI: Në emër të Komisionit, jeni që të mbetet si është, apo të ndryshojë sipas propozimit që e dha zoti Smaka. Zoti Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Unë po e kryej detyrën e zotit Avdiu, që sot nuk është këtu. Komisioni ka vendosur kështu si ka vendosur, zotëria propozon që në vend të “Ai” në fjalinë e dytë të thuhet “Kryetari i Kuvendit”, që unë po them “po”.

KRYESUESI: Okej, e qesim propozimin e Komisionit bashkë me vërejtjet e zotit Smaka, për miratim.

Amendamenti 29.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 54 vota “për”, 2 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 29 me propozimin e zotit Smaka.

Amendamenti 30.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 55 vota “për”, 5 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 30.

Amendamenti 31.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 51 vota “për”, 6 “kundër”, 6 abstenime, miratohet amendamenti 31.

Amendamenti 32.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 52 vota “për”, 5 “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 32.

Amendamenti 33.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 56 vota “për”, 3 “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 33.

Amendamenti 34.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 49 vota “për”, 3 “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 34.

Amendamenti 35.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 51 vota “për”, 4 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 35.

Amendamenti 36.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 54 vota “për”, 3 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 36.

Amendamenti 37.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 51 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 37.

Amendamenti 38.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 57 vota “për”, 3 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 38.

Amendamenti 39.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 45 vota “për”, 7 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 39.

Amendamenti 40.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 49 vota “për”, 5 “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 40.

Për amendamentin 41 janë paraqitur 4 diskutues. Naser Osmani, i pari.

NASER OSMANI: Faleminderit, i nderuari Kryesues!

Sipas logjikës time, amendamenti 41 duhet të pësojë ndryshime. Përpos kësaj ka edhe gabime, si po duket ka lëshime teknike, gabime. Mendoj që duhet të bëhet një renditje e re, kjo që ka të bëjë me grupin e dytë. Konsideroj që deputeti duhet ta ketë renditjen më të lartë, bile para ambasadorëve, pasi që ambasadorët janë zgjedhur me konkurs, ndërsa deputetët janë përfaqësues të popullit dhe konsideroj që duhet të bëhet ky ndryshim. Edhe anëtarët e Gjykatës Kushtetuese janë të përshkruar dy herë. Kjo duhet të korrigjohet, por duhet të fshihen këta që janë para deputetëve, ata të hiqen. Konsideroj që këtu duhet të shtohen edhe ish-kryetarët e Kuvendit, duhet të shtrohen ish-kryeministrat dhe duhet të shtohet kryetari i partisë politike që përfaqësohet në Parlament. Ne kemi rastin konkret të zotit Haradinaj, i cili është kryetar i partisë politike që ka deputetë në Parlament, ndërsa sipas kësaj, do me thënë, ai nuk do ta kishte vendin fare në këtë protokoll, andaj konsideroj që duhet të bëhet ky korrigjim. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Nait Hasani.

Zoti Hamiti, mendoni të prononcoheni për secilin veç e veç, se janë edhe 5 diskutues, se di kush çfarë propozimesh, për këtë nen është. Okej, zoti Hasani.

NAIT HASANI: I nderuar kryesues,

Naseri e përmendi amendamentin 41, renditjen për deputetët, po këtu është çështja edhe ambasadorët dhe ambasadorët tanë dalin përpara nesh. Këtu kemi renditje të rektorit të universitetit publik, tani ne i kemi 4 – 5 universitete, ku do t’i renditim ata, edhe ata janë të barabartë para ligjit. Kemi Odën ekonomike, Odën e biznesit, kemi shoqata të ndryshme, nuk është e thënë që t’i shtim të gjitha këto në renditje këtu. Ato që i tha Naseri, s’po i përsëris, po me gjithë atë edhe këto janë shtesa të cilët nuk duhet të jenë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Veliu.

AGIM VELIU: Unë i mbështes vërejtjet që i bënë kolegët e mi. Unë kisha për ta bërë edhe një plotësim këtu. Ma merr mendja mua që kryetarët e komunave duhet të renditen më lartë se këshilltarët, ta zëmë, të kryeministrit apo këshilltarët politikë. Do me thënë, e shtoj edhe këtë kërkesë që nga rangimi i tretë të nxirren edhe kryetarët e komunave, sepse

s'ka kuptim që kryetarët e komunave të jenë të ranguar më poshtë se këshilltarët politikë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Hvala! Ne znam da li će se javiti predsednik Komisije za zajednice, ali ovaj amandman je u vezi sa amandmanom 42. koji sledi, koji je komisija dala i zaista u ovom redosledu izastavljeni su zamenici ministra, a čak se predviđaju savetnici, prvi savetnici ministara, predviđaju se prvi savetnici premijera i tako dalje, a ne zamenici ministra, što nije dobro. Znači, to u drugoj grupi nije logično. Takođe nisu ni zamenici predsednika parlamentarnih komisija, a u trećoj grupi nisu predviđeni takođe zamenici gradonačelnika, odnosno zamenici predsednika opštine, ne predsedavajućeg u skupštinama. Tamo su predviđeni odbornici skupštine, ali ne i zamenici, predviđeni direktori opštinski, a ne zamenici predsednika opštine, koji su mahom iz manjinskih zajednica, ima ih u nekoliko opština u ovom trenutku. Komisija za prava i interese zajednica ima amandman, to je 42 po redu, ali je u vezi sa ovim amandmanom, ukoliko prođe ovaj amandman znači koji je 41, onda onaj 42. se isključuje. Znači, ima po prilično stvari koje nisu rešene, ovo što su prethodne kolege Naser Osmani i Veliu rekli, mislim da i to ima mesta da se ovaj amandman preuredi malo. Hvala lepo!

KRYESUESI: Zoti Idrizi, diskutimet po zhvillohen pë amendamentin 41. Prandaj vazhdojmë, Ardian Gjini është paraqitur.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Mendoj se ky amendament për të cilin po flasim, realisht, ndoshta edhe nuk e ka peshën aq të madhe, mirëpo unë nuk guxoj të kaloj pa e përmendur para seancës se ky ligj që po e kalojmë, nuk ka qenë dashur të vijë hiq para nesh. Është ligji më i keq që ndonjëherë Kuvendi i Kosovës e ka pasur para veti. E masakron Protokollin e Shtetit, jo vetëm që nuk e rregullon. Në fund të fundit, ky ligj e rregullon zonjën e parë e zonjën e dytë dhe i rekomandon përmasat e flamurit, po përsëris, i rekomandon, në ligj thuhet: “rekomandohen përmasa”. E, tash, deputetët e Kuvendit të Kosovës janë rrokur se cili kryetar i komunës e cili nënkryetar duhet të jetë më përpara. Ka qenë dashur të këqyren se çfarë amendamentesh keni kaluar. Jeni duke e kaluar një ligj që ka sa amendamente, aq nene, a jeni duke kuptuar? Do me thanë, unë ju lus edhe njëherë, mos e kaloni hiq ligjin, se ky ligj nëse kalon kështu qysh është, realisht vetëm çka i shkakton telashe të mëdha shtetit të Kosovës, se nuk zgjidh kurrgjë, se sa të merremi me një amendament kush është më përpara, nënkryetari i komunës a kryetari i komunës. Me të vërtetë është e çuditshme. Nëse dikush këtu i ka lexuar këto amendamente, nëse e lexon shtyllën e tretë të ligjit, ka për të parë që ky ligj është befasia më e madhe që mund t'i ndodhë Kosovës. Paramendo, ky ligj parasheh flamur të kryeministrit, ky ligj i parasheh dy salla të veçanta në aeroport, e ne edhe sot, si të aprovohet ligji, s'i kemi dy salla.

Po dua t'ju them edhe njëherë që ky ligj nuk duhet të kalojë dhe është pa lidhje shumë të merremi me radhitje protokollare, kur ligji me të vërtetë ka për t'i shkaktuar telashe shtetit, e s'ka për t'i ndihmuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Me qenë se jemi tek neni 41, tash s'po flasim për Ligjin si tërësi, po për nenin 41. Edhe unë e mbështes atë që thanë më herët tek renditja. Duket ndoshta jo e

rëndësishme, por megjithatë ka rëndësi dhe unë pajtohem plotësisht që pas nënkryetarëve të Kuvendit, ministrave, të renditen deputetët dhe të tjerët, ndërkaq këshilltarët në asnjë mënyrë të mos jenë para kryetarëve të komunave, sepse kjo do të ishte diçka shumë e papranueshme.

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputetja Flora Brovina e ka fjalën.

FLORA BROVINA: Faleminderit! Edhe unë gjatë kontrollimit të grupit të dytë ose të parë, nuk ka rëndësi, e shoh se mungon një emër emblematic dhe që është përfaqësuesi i familjes Jashari. Kujtoj se në protokoll duhet ta kemi edhe përfaqësuesin e kësaj familje dhe të shkruaj në ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Kryetari i Komisionit, zoti Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Unë u përpoqa, zoti kryesues, meqë më duhet të komunikoj në këtë rast, po më bien, s'e kisha për detyrë, por po e kryej.

U përpoqa t'i shënoj të gjitha vërejtjet. Zakonisht këtu deputetët i shkruajnë vërejtjet e veta, por nuk dhanë saktësim ku donë t'i fusin propozimet e veta. I mbledha të gjitha mendimet. Thonë që deputetët s'duhet të jenë mbas përfaqësuesve diplomatikë. Kjo i bien që të zhvendosen, ku thotë deputetët, të vinë para përfaqësuesve diplomatikë dhe mund të akceptohet. Kjo s'është farë problemi, veç rendi, dalin përpara.

(Ndërhyrje nga salla)

Unë po e shoh tekstin, mos flitni përmendsh. Kur del para këtyre, del edhe para atij. Zoti Osmani e pa që është gabim, se dy herë është përsëritur, ai është gabim teknik. Normalisht, anëtarët e Gjykatës Kushtetuese bien, fshihet njëra. Tutje, pashë që kishte kërkesë për kryetarët e komunave të cilët ekzistojnë këtu, po duan t'i rangojnë në rangun e dytë prej të tretit. Nëse Kuvendi pajtohet, s'kam pse të them unë jo. Komisioni e ka bërë këtë rangim dhe grupi i caktuar.

Tjetër. Tjetër vërejtje të veçantë këtu nuk ka pasur, unë i rezimova të gjitha që i dëgjova.

(Ndërhyrje nga salla)

Shikoni, shikoni, bëhuni racional. Rektori i Universitetit Publik dhe kryetari i Akademisë së Shkencave. Këtu flitet për institucione shtetërore edhe publike. Mund të jenë 100 shkolla, unë po them me shifër, po 100 përfaqësues nuk thirren në ceremoniale totale. Keni kujdes, edhe sekte fetare mund të jenë, po e zëmë, në Kosovë nja 50 sot a 49, nuk di sa janë, por ekzistojnë me ligj sistemor të ri dhe këtu janë numëruar. Do me thanë, nuk është që nuk janë biseduar të gjitha problemet. Natyrisht, ka perceptime të ndryshme. Unë thashë, akceptohet ndërrimi i vendit të deputetit para përfaqësuesve diplomatikë dhe kalimi i kryetarëve të komunës nga rangi i tretë në të dytin. Të tjera nuk pashë substanciale. Kaq.

KRYESUESI: Faleminderit!

Atëherë, hedh në votimi amendamentin 41, kështu siç është, me ndryshimet që i propozoi ose i miratoi kryetari i Komisionit, zoti Hamiti, në emër të komisionit.

Amendamenti 41.

Regjia gati, votojmë tani:

Konstatohet se me 45 vota “për”, 14 vota “kundër”, 4 abstenime, u miratua amendamenti 41. Faleminderit!

Amendamenti 42.

Zoti Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Ata janë të lidhur, ky është variacioni. Nëse është votuar i pari, ky është pa objekt, s’ka pse të votohet më.

KRYESUESI: U votua kjo, u krye. Amendamenti 41 me dy propozimet shitesë që i patët ju, u votua dhe përfundoi kjo, se 14 vota janë kundër. Nëse doni, unë e qes edhe...

SABRI HAMITI: Jo, jo!

(Ndërpritet incizimi)

KRYESUESI: Atëherë, në rregull, vazhdojmë se është gabim i administratës që e kanë bërë. Është dashur të lihet alternativa, do të thotë, i zbresim nenet. Administrata e ka bërë gabim këtu.

Amendamenti 42 tash, në vend të 43-shit. Pasi po shkojmë me radhë, po e bëjmë 43-shin 42.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 44 vota “për”, 7 “kundër” dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti 42.

Amendamenti 43.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 48 vota “për”, 7 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 43.

Unë kërkoj falje, më duhet ta përsëris këtë si është e shkruar në regjistër, sepse edhe teknika aty po ka problem. Por, le të nënkuptohet që amendamenti 42 nuk është votuar, sepse 41-shi e ka eliminuar.

Vazhdojmë, pra, me amendamentin 45.

Amendamentin 45.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 47 vota “për”, 6 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 45.

Amendamenti 46.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 43 vota “për”, 3 “kundër”, miratohet amendamenti 46.

Amendamenti 47.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 52 vota “për”, 8 “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 47.

Amendamenti 48.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 50 vota “për”, 5 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 48.

Amendamenti 49.

Votojmë tani:

Konstatoj se me 43 vota “për”, 4 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 49.

Amendamenti 50.

Votojmë tani:

Konstatoj se me 49 vota “për”, 8 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 50.

Amendamenti 51.

Votojmë tani:

Konstatoj se me 44 vota “për”, 6 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 51.

Amendamenti 52.

Votojmë tani:

Konstatoj se me 47 vota “për”, 8 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 52.

Amendamenti 53.

Votojmë tani:

Konstatoj se me 44 vota “për”, 9 “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 53.

Amendamenti 54.

Votojmë tani:

Konstatoj se me 43 vota “për”, 11 “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 54.

Amendamenti i fundit 55.

Votojmë tani: Votoni ju lutem. Faleminderit!

Konstatoj se me 48 vota “për”, 12 “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 55.

Tani votojmë tekstin e Ligjit në tërësi. Urdhëro, zoti kryetar i Komisionit Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Veç thashë që ekzistojnë këtu në fund edhe këto dy rekomandime, që janë të rëndësishme të merren parasysh.

Nën një, i tërë teksti i projektligjit t’i nënshtrohet redaktuarës gjuhësore për shkak se po të shkonim e të bënim amendamente për formula, shihet se do të bëheshin shumë, kjo nën një,

Dhe, dy, të harmonizohen variantet gjuhësore të tekstit të projektligjit. Me këto dy rekomandime, të votohet tash teksti në tërësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Nuk ka debat, u krye. Faleminderit!

Atëherë, e hedhim tekstin në tërësi me rekomandimet e kryetarit të komisionit, për redaktim. Votojmë tekstin në tërësi tani. Ju lutem, votoni!

Konstatoj se me 41 vota “për”, 21 vota “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi sot miratoi Ligjin për Protokollin e Shtetit të Kosovës. Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik

për aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë për vitin 2008

Konstatime hyrëse:

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës ka shqyrtuar Raportin e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë për vitin 2008 dhe ka rekomanduar që i njëjti të shqyrtohet në seancë plenare.

Raporti me rekomandime u është shpërndarë deputetëve.

Tani ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet, zotin Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Vërtet, unë do të lexoj vetëm rekomandimin që e keni përpara të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Raportin e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik. Siç dihet, ky komision autorizimet e veta i nxjerr nga Ligji i prokurimit publik, respektivisht nga neni 81 i këtij ligji, dhe mbi bazë të këtyre autorizimeve i ka paraqitur Kuvendit raportin e vet, të cilin raport e ka shqyrtuar komisioni dhe ka sjellë këto rekomandime.

Sipas teknikës të përgatitjes së raportit, ky raport i plotëson kushtet edhe teknike, edhe ligjore të raportimit, sipas asaj se çka brenda na sjell, ajo mbetet që ne si Kuvend ta shqyrtojmë dhe ta analizojmë dhe të japim vlerësimet tona lidhur me këtë raport.

Komisioni ka konstatuar se duke u bazuar në analizën e bërë lidhur me raportin dhe mënyrën e implementimit të Ligjit për prokurim publik, duke pasur parasysh pengesat e shfaqura me procedurat e prokurimit publik që janë zbatuar në praktikë deri më tani, Komisioni për Buxhet dhe Financa në kuadër të shqyrtimit të këtij raporti kërkon dhe i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës që të kërkojë nga Qeveria formimin e grupit punues për hartimin e Ligjit të ri të prokurimit publik, i cili ligj ndër të tjera duhet të përmbajë edhe dy kaptina të veçanta që nuk i kemi pasur deri më tani lidhur me prokurimin, që kanë të bëjnë në ndërmarrjet publike, si dhe me prokurimet në përfaqësitë diplomatike, në të cilat kem pasur probleme mjaftë të mëdha në konsolidimin e përfaqësive tona pikërisht për shkak të pengesave ligjore që ka pasur në këtë drejtim.

Në përgjithësi, ky Kuvend njëherë ka amendamentur këtë ligj, por edhe si i tillë, me amendamente nuk i plotëson kushtet e tanishme pas zgjidhjes së statusit të Kosovës. Prandaj, shtrohet si nevojë e domosdoshme dhe urgjente që Qeveria të bëjë grupin punues prej ekspertëve që të hartojë një ligj dhe t'i përshtatet rrethanave dhe kushteve në të cilat ne ekzistojmë tani.

Them se duhet të ketë dy kaptina të veçanta, sidomos të ndërmarrjet publike, sepse ndoshta nuk kem pasur rastin deri më tani që të kemi një konkurrencë të mirëfilltë mes sektorit publik dhe privat dhe vetëm rasti kur kemi dhënë licencën për Operatorin e Dytë të Telefonisë Mobile, janë parë se cilat janë pengesat në aspektin e prokurimit në sektorin publik dhe në atë privat, gjë që nuk paraqesin një ambient vërtet të mirëfilltë konkurrues, prandaj shtohet një nevojë e domosdoshme që rreth këtij ligji të punohet sa më parë dhe sa më shpejt.

Vetë ky komision ka dhënë rekomandimet e veta që duhet të ndryshohen nenet e caktuara, mirëpo ne si komision kemi konstatuar se jo të ndryshohen nenet e caktuara, por të ndryshohet i tërë ligji dhe të sillet në Kuvend një ligj i ri. I mbetet Kuvendit që për

çështje të tjera të caktuara, këtu deputetët të flasin dhe të raportojnë. Një çështje është e përcaktuar se jo në të gjitha rastet ky komision ka përfillur ligjin dhe ka respektuar autorizimet e veta që i ka mbi bazë të ligjit dhe, një çështje që është shumë e rëndësishme, jo gjithëherë ka propozuar ndërmarrjen e masave të caktuara administrative ndaj shkelësve të Ligjit të prokurimit publik, gjë që shihet edhe nga raporti ku është i përbërë prej shumë shifrash, po pa ndonjë analizë të mirëfilltë në rastet e veçanta që janë të nevojshme që të përmirësohen, po them, praktikat e prokurimit publik në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Sipas radhës, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës është paraqitur Bahri Hyseni. Debat ka, të votojmë nuk kemi, votojmë nesër.

Urdhëro, zoti Hyseni, e ke fjalën.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka shqyrtuar Raportin e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik dhe përshëndet këtë komision që brenda afatit të paraparë ligjor ka proceduar një raport në Kuvendin e Kosovës. Gjithashtu përshëndet rekomandimet që kanë ardhur nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Mirëpo, megjithatë, si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës kemi edhe disa shqetësime, të cilat unë po i përmendi në pika të shkurta.

Në raportin që kemi para vetes për vitin 2008, nuk janë pasqyruar të dhënat mbi përkrahjen e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik nga Agjencioni Evropian për Rindërtim, kurse në Raportin e vitit 2007 kanë qenë të pasqyruara këto të dhëna dhe kur dihet se për Agjencionin e Prokurimit Publik në Kosovë janë derdhur dhe janë shpenzuar miliona euro, kurse gjendja në prokurimin e Kosovës nuk ka ndryshuar në dobi të rezultateve.

Vlen të përmendet se amendamenti i Ligjit për prokurim publik, në raport thuhet se KRPP-ja me përkrahjen, po flas tash në krahasim me vitin 2007, me përkrahjen e kompanive konsulente ka marrë iniciativë për thjeshtësimin e Ligjit të prokurimit publik, mirëpo në përfundim mund të konstatohet se ky projektligj nuk është thjeshtësuar fare, mirëpo është komplikuar edhe më tepër dhe është problem që sot mbasin në Kosovë me dhjetëra apo qindra miliona euro pa shpenzuar mu për shkak që është procedurë shumë e komplikuar. Dhe, unë po përmendi vetëm disa nga çështjet që vlen të përmendet. Mjafton të lexohet neni 89a) dhe neni 92 i Ligjit të prokurimit publik dhe të vërtetohet kjo që e thashë më parë. Në nenin 89a) shkruan se “Çdo anëtarë i KRPP-së që është në detyrë që prej datës 31 dhjetor të vitit 2006 do të vazhdojë të kryej detyrat e tij deri në fund të mandatit të tij”. Kjo do të thotë që edhe pse me amendamentin e Ligjit të prokurimit publik parashihet që Bordi i KRPP-së të ketë 3 anëtarë, punën do ta vazhdojnë 5 anëtarë të tanishëm të Bordit të KRPP-së edhe në kohën kur po raportojmë.

Gjithashtu, edhe në nenin 92.2 të Ligjit të prokurimit publik thuhet se “Agjencioni i Prokurimit Publik duhet të udhëhiqet vetëm nga drejtori ekzekutiv i Agjencionit deri më 30 qershor të vitit 2009”. Të gjithë anëtarët e tanishëm do të vazhdojnë të mbasin anëtarë të Bordit në këtë agjension dhe shtrohet çështja, mos vallë Kosova është tash e pasur që të paguajmë paga aq të larta edhe për njerëzit të cilët edhe me ligj nuk duhet të ekzistojnë tani.

Në raport përmendet Departamenti për trajnime dhe pasqyrohen të dhënat mbi trajnimet të cilat i ka zhvillua komisioni dhe me të vërtetë është inkurajuese ajo që përmendet që për çdo vit ka pasur numër të madh të njerëzve të trajnuar. Po përmendi vetëm vitin 2007, ku kanë qenë 414 zyrtarë të trajnuar të prokurimit, kurse në vitin 2008 kemi 431 zyrtarë të prokurimit të certifikuar, por po e ngrehim një shqetësim, sa zyrtarë janë certifikuar dhe a kanë punuar ndonjëherë këta zyrtarë në sektorët e prokurimit? Nëse duhet të marrim qëndrimin përfundimtar, mund të thuhet se shumica e këtyre zyrtarëve që janë certifikuar, asnjëherë nuk kanë punuar në prokurim. Do me thënë, kanë ardhur prej sferave të ndryshme dhe nuk kanë njohuritë elementare as për certifikim.

Vlen të përmendet një fakt pozitiv për vitin 2008 se 77.40% e buxhetit për prokurime është shfrytëzuar sipas procedurës së hapur dhe që është procedura më transparente që e kërkon ligji në fjalë. Kjo vlen të përmendet dhe nëse krahasohet me vlera monetare, diku mbi 639.679.000 euro kanë shkua përmes procedurës së hapur dhe është një fakt që na gëzon në krahasim me vitin 2007, ku do me thënë është një përqindje 96.02, që do me thënë në këtë rast procedurat e prokurimit kanë shkua sipas procedurës së hapur dhe është një lajm i mirë që kanë filluar procedurat e hapura si procedurë më transparente.

Mirëpo, është fakti tjetër që nga numri i kontratave për vitin 2008, janë gjithsej 14.817 kontrata publike sipas Ligjit të prokurimit publik, që kanë përfshirë të gjitha llojet e vlerave të prokurimit.

Nga ky numër i madh i kontratave shihet që Departamenti për Mbikëqyrje dhe Monitorim ka kryer vetëm 12 monitorime të aktiviteteve të punës për gjithë autoritetet kontraktuese, pesë monitorime të inspektimit sipas kërkesës, shtatë vëzhgime të hapjeve publike dhe nëse krahasohet me buxhetin që 70% komplet i buxhetit të prokurimit është shfrytëzua me hapje dhe të kenë vetëm shtatë vëzhgime, është një krahasim i madh dhe nuk di se sa e ka kryer punën mirë komisioni në këtë rast.

Po përmendi edhe një çështje. Janë bërë 1612 njoftime për anulime të kontratave dhe vetëm gjatë muajit janar janë anuluar 46.46% të tenderëve të publikuar nga autoritetet kontraktuese. Nëse merret një përqindje e përgjithshme, mund të thuhet se 35% e të gjithë tenderëve të publikuar janë anuluar. Arsyetimi në raport nga komisioni qëndron vetëm me një fakt se gjëja nuk ka pasur tenderues të përgjegjshëm, apo kanë munguar tre tenderues të përgjegjshëm. Ky fakt për ne është mjaftë shqetësues, duke marrë parasysh që edhe humbet kohë, edhe humben projekte kapitale, prandaj është një çështje që duhet në të ardhmen që shikohet me kujdes të veçantë, sepse të anulohen 45% të tenderëve të cilët paguhen, natyrisht që është edhe një shumë e madhe që e paguajnë taksapaguesit e Kosovës dhe duhet të kemi një kujdes të veçantë.

Dhe, krejt në fund, po e përmendi edhe një fakt. Në këtë raport përmendet edhe raporti që i dërgohet Organit për shqyrtim publik, që Paneli shqyrtues i KRPP-së ka shqyrtuar apo ka pasur diku 110 ankesa, duke filluar nga janari deri në qershor. Vlen të përmendet një fakt se 98 kërkesa janë shqyrtuar, janë aprovuar 24 prej tyre, në rivlerësim janë dërguar 9 kërkesa, të anuluar kanë qenë 33 dhe të pakomplementuara kanë qenë 32 ankesa. Është një fakt që na gëzon, sepse së paku janë shqyrtuar 98 ankesa. Mirëpo, është fakti tjetër që kërkon të mbikëqyrim këtë proces se sa autoritete kontraktuese janë marrë në përgjithësi, sa fletëgaranci të kompanive janë marrë në disponim duke pasur faktin që e kanë penguar procesin e mëtutjeshëm të zhvillimit të këtyre projekteve dhe kanë ndikuar që ndoshta në këtë vit mos të përfundojnë projektet e parapara nga autoritetet kontraktuese. Dhe, mbi të gjitha vlen të përmendet se askund nuk e kemi një raport a është marrë ndonjë masë

disiplinore ndaj të gjithë atyre të cilët kanë zhvilluar procesin e prokurimit, proceset janë anuluar, janë kthye në rivlerësim dhe askush nuk ka dalë në përgjegjësi.

Prandaj, duke pasur parasysh këto masa që nuk i kemi parë në raport, ne si Grup Parlamentar i ngrehim këto shqetësime që së paku në të ardhmen të mos bëhen këso lëshimesh dhe të merren masa adekuate ndaj të gjithë atyre të cilët kanë shkelur ligjin, nuk kanë proceduar konform Ligjit të prokurimit publik dhe, natyrisht, të merren masa qoftë ndaj autoriteteve kontraktuese, qoftë ndaj zyrtarëve të cilat nuk i kanë respektuar procedurat e prokurimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: A ka mundësi me të më falësh, se qenka kjo renditja sipas grupeve parlamentare. Më falë!

ARDIAN GJINI: Në rregull, s'ka problem!

KRYESUESI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Shatri e ka fjalën.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti kryesues!
Raporti që po e shqyrtojmë sot, përkrahet nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës. Ky raport përmban të gjithë aktivitetin e kryer nga ana e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik në vitin 2008.

Po ashtu, Grupi Parlamentar i LDK-së konsideron se Komisioni Rregullativ i Prokurimit për vitin 2008 e ka kryer obligimin që e ka pasur në bazë të Ligjit për prokurimin publik, që lidhet me zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të prokurimit publik.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e përkrah propozimin që e ka bërë KRPP-ja në raport për fillimin e procedurës nga ana e Qeverisë për hartimin e ligjit të ri ose amendamentimin e Ligjit ekzistues të prokurimit publik me qenë se ligji aktual i ka disa zbrazësi në disa segmente të cilat lidhen me ato që më parë i përmendi edhe kryetari i Komisionit për Buxhet, zoti Koci, që kanë të bëjnë me prokurimin në misionet diplomatike dhe prokurimin në ndërmarrjet publike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Në emër të AKR-së, është paraqitur zoti Smaka.

RIZA SMAKA: Zoti kryesues, për hir të kohës dhe të durimit, do të kisha mbështetur plotësisht theksimet nga zotëri Koci, zotëri Hyseni, dhe zotëri Shatri, sidomos propozimet e Komisionit për Buxhet. Po do të isha koncentruar pak te çështja e Ligjit për prokurimin publik, i cili ka defekte, ka zgjidhje kontradiktore edhe ka vakuume juridike, veçanërisht te procedurat, ku nuk është e precizuar ecuria e konstatimit të gjendjes, e vendosjes, e mjeteve juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme. Prandaj, do të kisha apeluar që Qeveria ta përgatis me ngutësi, po me seriozitet apo jo, ose propozimet për ndryshimin edhe plotësimin, ose eventualisht Ligjin për prokurimin publik, sepse varësisht nga ai, do

të bëhej edhe prokurimi publik, a prokurimi publik është çështje mjaftë delikate edhe problematike që ka konsegenca negative dhe komente të tilla. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar AAK-së, zoti Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës, ministra,

Me të vërtetë është befasi se në çfarë niveli ka rënë Kuvendi i Kosovës dhe kam për ta ndërlidhur me këtë raport dhe të provoj ta shpjegoj.

Fillimisht, ky Kuvend voton në parim që të bëhet redaktura e ligjit pas leximit të dytë dhe kur unë e kërkoj fjalën, kryesuesi nuk ma jep fjalën. Nuk e di a ka deputetë që e di çka do të thotë kjo, të redaktohet teksti i ligjit pas aprovimit në lexim të dytë dhe kryetari i komisionit të na thotë nuk kemi mund t'i bëjmë përmirësimet se na kishin dalë shumë amendamente. Kthehuni dhe kujtohuni se çka jemi duke i bërë Kuvendit.

Çështja tjetër është se raporti i KRPP-së sillet për t'i vlerësuar procedurat e prokurimit, prokurimin në Kuvend, jo për të vlerësuar punën e KRPP-së për ... dhe në këtë Kuvend vetëm një deputet deri më tani me vetëm dy fjali foli për esencën, që 45% e tenderëve janë kthye. Ky duhet të jetë objekt i diskutimit sot, e jo sa tabela edhe sa diagrame na ka sjellë KRPP-ja këtu. KRPP-ja që na sjellë një raport tepër konfuz, që duhet të jesh ekspertë për ta marrë vesh, i cili i ka kamufluar elementet më të dëmshme që i kanë ndodhur kësaj shoqërie dhe na prapë themi se është në rregull ky raport dhe flasim për qëllimin e ndryshimit të ligjit. Ky koalicion qeveritar e ka ndryshuar Ligjin e prokurimit, do me thënë tash vjet për vjet duhet ndryshuar Ligjin e prokurimit. Kjo është, do me thënë, çka po dëgjojmë ne sot. Është rekomanduar njëherë të ndryshohet ligji, është ndryshuar. Po rekomandohet edhe një herë të ndryshohet ligji, do të ndryshohet ligji edhe njëherë. A jeni duke e kuptuar, kolegë të dashur, se çka jemi duke i bërë Kuvendit, se çka jemi duke i bërë vendit, se kur i bëjmë Kuvendit, si institucioni më i rëndësishëm dhe më i lartë në këtë shtet, jemi duke e sakatuar edhe vendin tonë.

Rekomandohet, do të thotë, ndryshimi i ligjit edhe krejt kohën flitet për rekomandimin e ndryshimit të ligjit, nuk flitet për të gjitha ato masakrat që i janë bërë parasë publike dhe shihni çka kemi. Në vend që të jetë ministri i Financave këtu, ministri i Transportit që e ka shpenzua 20% të buxhetit, në vend që të jetë zëvendëskryeministri, bile edhe Kryeministri, i kemi vetëm dy ministra. Nuk janë as të interesuar, edhe i kam njehur, 25 deputetë janë krejt në sallë a 26 a sa janë. Nuk janë as 18 prej koalicionit qeverisës. Kaq është me rëndësi, do me thanë, ky raport saqë më shumë ka deputetë të opozitës, se sa të pushtetit.

Tjetra. Raporti i shpenzimeve nuk na ka ardhur, u thye ligji. Raporti ka qenë dash të vinte deri më 31 mars. Ne nuk e kemi marrë raportin e shpenzimeve, të buxhetit për vitin 2008. Tash, ne diskutojmë për raportin e KRPP-së, e nuk e dimë cili është raporti i shpenzimeve. Këto janë mashtrime të mëdha që po i bëhen opinionit publik. Kjo është papërgjegjësia ekstreme që po dëshmoni ju dhe, fatkeqësisht, Kuvendi po shndërrohet totalisht në pjesë të krejt kësaj hipokrizie dhe duhet deputetëve t'ju vijë keq, më vjen keq nëse s'ju vjen keq pse po ndodh kështu, se Kuvendi është subordinuar totalisht. E kam lexuar në raport para pakë ditësh, i cili thotë se Kuvendi i Kosovës i është subordinuar totalisht Qeverisë dhe diskuton vetëm për çështje anësore. Sot dy herë, për dy ligje dhe për një raport Kuvendi i Kosovës ka diskutuar për çështje totalisht të parëndësishme. Nuk

ka pasur guxim askush ta përmend esencën e punës. Mund të them që lirisht mund të vazhdoni, lirisht mund të vazhdoni, por po ju them diçka. Asnjë gjë nuk mbetet e pa shënuar, asnjë gjë në këtë vend nuk mbetet e pa shënuar, gjithçka shënohet. Edhe unë, edhe Grupi Parlamentar i Alenacës për Ardhmërinë e Kosovës nuk dëshirojmë të jemi pjesë e këtij masakrimi të parasë publike dhe në këtë hipokrizi që po zhvillohet në Kuvendin e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: S’di a ta ka përmendur emrin? Për replikë, Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Kurrë më pa dëshirë nuk kam dalë në këtë foltore, por meqë po e shoh që është demonstrim i një sensibiliteti para opinionit, më lejoni që të bëjë një saktësim.

Ne të gjithë flasim në dialekt, flas edhe unë dhe e quaj gjuhë të motivuar kur flitet në dialekt. Për fat jo të mirë, shërbimet gjuhësore të Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk e shkruajnë mirë standardin e shqipes. Ajo që unë kërkoj që tri legjislatura, është përsëritur edhe sot, që të bëhet redaktimi gjuhësor, që i bien të shkruhen format standarde, të shkruhet shumësi si shumës, njëjësi si njëjës, të shkruhet standardi. Kjo s’ka të bëjë me substancën dhe unë kolegut tim shumë të nderuar nuk dua t’ia lexoj format që i foli ky këtu, të gjitha i shënova, asnjëra nuk është standarde. Po të bëhet tekst, është një gjuhë e motivuar e krahinës ose e Kosovës, ta quajmë ne. Unë nuk dua t’i theksoj, sepse ato bëhen tekst, prandaj kur bëhen tekst, dokument, këto rrafshohen dhe askush nuk thotë që nëse shkruan “gjë”, është gabim sepse këtu është thënë “gja”, sepse thuhet me hundore te ne. Nëse thuhet “vand” në vend se të thuhet “vend”, bëhet “vend” dhe askush nuk hidhërohet. Nëse shumësi bëhet me “ë” për ta dalluar, “deputetë”, në shumës qitet një “ë”, e di që këtu shumica s’e dinë që bëhet me atë, prandaj bëhen redakturat dhe unë do të pushoja këtu ...

KRYESUESI: Regjia, edhe një minutë!

SABRI HAMITI: Kjo duhet, unë e thashë, sepse po koketohet në opinion. Isha i detyruar ta them, do me thënë, s’ka të bëjë me esencë, ka të bëjë me redakturë gjuhësore dhe ju garantoj që çdo letër që do ta shkruanim sot ne të gjithë këtu, e ka nevojën e një redakture gjuhësore. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Kundër replikë, zoti Gjini, një minutë.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, profesor Hamiti për lekturën që ma mbajte. Nëse një ligji i duhen 500 amendamente, duhet t’i kthehet Qeverisë. Unë ju kam thanë në komision parlamentar, kthejeni se ligji nuk amendohet. Ju mund të flisni sa të doni për mënyrën time të foljes, ama unë po ju them juve që nuk ka normë ndërkombëtare që thotë, që ligji mbas leximit të dytë shkon në redaktorë, se mund të ndodhë shumëçka që s’duhet të ndodhë. Ju mund të thoni çka të doni por, të lutem, mos na thuaj këtu që ligji guxon të shkojë në redakturë pas leximit të dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Unë ju kisha lutur, e ezauruat kohën tuaj. Unë vetëm lidhur me atë që thatë, që s’jua dhashë fjalën, unë nuk kam të drejtë t’ua jap fjalën kur përfundon diskutimi për amendamente. E keni pasur kohën në fillim të diskutoni, e keni pasur kohën e duhur edhe në komision që të diskutoni dhe keni diskutuar. Prandaj, nuk do të kisha thënë që unë e kam shkel të drejtën tuaj, zoti Gjini, por unë e kam respektuar Rregulloren. Nëse Rregullorja është në procedurë, nëse ju e bëni rregulloren ndryshe, atëherë në rregull është.

Vazhdojmë me përfaqësuesin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, deputeten Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot vërtet po e shqyrtojmë një raport që quhet për aktivitetin e prokurimit publik të Kosovës për vitin 2008.

E kemi parasysh se në bazë të këtij raporti ne dhe më shumë qytetarët e Kosovës duan të dinë se si është shpenzuar paraja për vitin 2008, a janë respektuar vërtet procedurat e Ligjit për prokurimin publik. Kjo, kur jemi sot në këtë temë dhe kemi përpara vetëm dy ministra, mungon komplet Kabineti qeveritar, mungon interesimi, mungon disponimi më shumë i deputetëve mazhurancës, kuptohet, na jep të kuptojmë se sa pak e rëndësishme është për institucionet e Kosovës, se sa respektohet ligji në Kosovë, e në rasti, në fjalë, Ligji për prokurimin publik.

Unë nuk dua të thellohem në këtë raport, sepse vërtet ky raport s'thotë kurrgjë, absolutisht kurrgjë nuk thotë. Natyrisht, në bazë të kësaj Lidhja Demokratike e Dardanisë nuk e përkrah këtë raport, aq më pak kur ne ende s'e kemi marrë raportin e shpenzimeve për vitin 2008. Megjithatë, kjo s'do koment. Në kuadër të këtij raporti shumë të dobët thuhet shumë qartë se janë anulua mbi 45% të tenderëve dhe çfarë del kontraverze pastaj, 77%, mbi 40% janë prokurime të hapura, kjo pastaj nuk do koment, vërtet ne e dimë realitetin në terren.

Veç po ndalem te problemi i çështjes për misionin diplomatik. Merreni me mend, në bazë të këtij ligji vërtet aktual, nuk ka mund të rregullohet çështja e prokurimit për misionin diplomatik të Kosovës për ambasadat të cilat i kemi hapur. Kjo të jep të kuptosh se kjo Qeveri sa herë ka shkelur vendimin pikërisht të këtij Kuvendi për miliona euro, Kuvendi ka marrë vendim mos të investohen ato para, kjo Qeveri e ka shkelur atë vendim, ndërsa nuk ka qenë në gjendje të nxjerrë një akt nënligjor për t'ua lehtësuar punën ambasadave jashtë. Edhe kjo mendoj se s'do më shumë koment.

Është edhe diçka me rëndësi që më bëri përshtypje. Kur është fjala tek komunat e banuara me serbë, aty s'kemi qasje fare, si zakonisht, ligji në përgjithësi në Kosovë nuk funksionon, por realisht vendbanimet me serbë as që na japin asnjë llogari. Fjala është për mbi një milion euro, tash nuk po mund ta gjej shumë në këtë material, por realisht është mbi një milion euro që vërtet ne s'kemi qasje fare, paratë janë shkuar, por nuk e dimë në çfarë forme, në çfarë prokurimi janë harxhuar.

Tjetra, për ta përmbyllur, vërtet është paraqitur si nevojë hartimi i një ligji të ri për prokurimin publik, edhe kjo të jep të kuptosh, secila Qeveri që të vijë në pushtet, duhet t'ia përshtasë vetit ligjin, e pastaj gjatë punës prapë mund të dalin pengesa, që realisht kështu shkon viti, kështu menaxhohet ose administrohet paraja publike, ku ne e dimë se kjo Qeveri e ka vonuar mbi 6 muaj konstituimin e Bordit të KRPP-së e tjera, e tjera. Këto janë në pika të shkurta procedurat ose proceset të cilat na japin të kuptojmë se nuk respektohet Ligji për prokurimin publik dhe na jep të kuptojmë se në çfarë forme shpenzohet paraja publike e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, nuk është paraqitur askush. SLS, nuk është, “Zajedno” nuk është.

Atëherë, vazhdojmë me deputetët e paraqitur për diskutim. Fjalën e ka deputeti Naim Rustemi.

NAIM RRUSTEMI: Ju faleminderit, kryesues!

Raportin e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik të vitit 2008, sipas mendimit tim, është dashur t’i paraprijë një arsyetim pse nuk është shqyrtuar Raporti i vitit 2007.

Të gjithë deputetëve dhe të tjerëve që e kanë përcjellë punën e Kuvendit, ju kujtohet një ndeshje e fortë në karriget përballë meje rreth Raportit të KRPP-së për vitin 2007. Së paku, para se të hyjë në shqyrtimin e Raportit 2008, nja dy fjalë arsyeshmërie, sa për të qenë fer dhe i barabartë ndaj të tjerëve, pse nuk e kemi shqyrtuar 2007-shin. Nëse ka ndonjë arsye të fuqishme, në rregull, nëse ka ndonjë arsye veç për shkak kohës, ka qenë obligim i KRPP-së që të raportoje para Kuvendit, që të bëjë raportin vjetor, por ai raport nuk u kthye më kurrë në Kuvend. Vetëm këtë desha që ta qes në pah dhe mirë kishte për të qenë nga Kryesia e Kuvendit, bile nja dy fjalë t’i shtojë për këtë gjë, pse nuk e kanë shqyrtuar.

Kemi parasysh që është faza kur është ndarë Organizata për shqyrtimin e ankesave dhe Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.

Në vitin 2007, KRPP-ja ka pasur obligime shtesë, obligimet që i janë dhënë Organit Shqyrtues të Prokurimit. Me fjalë të tjera, Raporti i vitit 2007 ka qenë shumë më voluminoz dhe më substancial. Por, ai nuk u është shqyrtuar. Mirë kishte qenë të jepet një arsyetim pse. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pasi u përmend Kryesia, unë kam qenë në udhëheqje të seancës atë ditë dhe vendimi i seancës ka qenë për mbledhjen e ardhshme të shqyrtohet. Nuk e di pse nuk është shqyrtuar, as unë nuk di se çfarë sqarimi të jap më tutje. Ju faleminderit. Kaq.

Në radhë është deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Fillimisht, desha ti them disa gjëra, por pastaj zoti Gjini, zonja Gaxherri dhe zoti Rustemi tashmë ma shkurtuan fjalimin tim. Unë do të ndalem vetëm në aspektin e raportit si raport, se po e them që e kam lexuar disa herë.

Është një raport aq i mërzitshëm që duhet të kesh shumë durim, mega durimin për ta lexuar dhe për të nxjerrë diçka. Raportshkruesi këtu ta jep ndjenjën se diçka do të fshehë dhe shumë sende fshihen. Nja dy-tri informata që na i ka dhënë, na i ka dhënë nga çdo projeksion i mundur, do me thënë, të them figurativisht, e ka marrë llastikun veç e ka zgjeruar. Veç nëse i lexojmë titujt, do të shohim se çfarë raporti është shkruar këtu. Do me thënë, një titull është -Prokurimet publike sipas autoriteteve kontraktuese. Pastaj, vjen titulli tjetër -Kontratat e nënshkruara sipas autoriteteve kontraktuese. Pastaj ke -Prokurimet publike sipas burimeve të financimit, ke -Kontratat e nënshkruara sipas burimeve të financimit, do me thënë për të njëjtën gjë flitet, e flitet, e flitet, e kurrëgjë s’kallëzohet.

Ky raport, po them edhe një herë, lexuesin e arsyeshëm fare nuk e respekton. Duhet të jesh ose jo i arsyeshëm në kuptimin negativ dhe ta marrësh si gjë të mençur që është

shkruar këtu, ose të jesh super ekspert i lëmisë për t'i gjetur dobësitë apo për ta gjetur një informatë që të intereson. Edhe atëherë e ke shumë vështirë.

Unë, thjeshtë po ju them, e kam lexuar disa herë dhe mendimi im është një nga ato raportet më të këqija që na është sjellë, të rëndësisë së veçantë. Andaj, nuk e përkrah dhe çuditem, disa deputetë, sidomos të opozitës, a e kanë lexuar këtë raport që e përkrahin, a nuk e kanë lexuar. Hajt, po them, këta të pozitës mbase janë të obliguar që ta mbrojnë, por mendimi im është se nuk është lexuar për ta përkrahur një raport të tillë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për dy ministrat e Kabinetit qeveritar dhe për këta deputetë që janë brenda seancës sot këtu.

Raportin mbi aktivitetin e Prokurimit Publik në Kosovë për vitin 2008 e kam lexuar mjaft me vëmendje, mirëpo nuk dua të përsëris shumë sende që u përsëritën prej kolegëve të mi këtu gjatë diskutimit.

Dua të them se ky raport është një raport sa për të bërë qejf, apo të themi sa për të mbuluar të gjitha të këqijat që kanë ndodhur brenda këtij Organi të Prokurimit Publik, e që shihet prej anëve tabelare si janë paraqitur këtu, mund të shihet shumë lehtë që manovrohet shumë lehtë me shifra dhe paraqitet gjendja shumë e mirë. Në anën tjetër, kur t'i nxjerrësh shifrat, del se diku 45% e tenderëve janë anuluar, ndërsa në anën tjetër thuhet se 77.40% të Buxhetit të prokurimit gjatë vitit 2008 janë shpenzuar sipas procedurave të hapura, ku automatikisht bie në kundërshtim me atë që e thotë pak më përpara. Ndërsa, në rast se dalim te kontratat e nënshkruara me vlerë mbi 3 milionë nga autoritetet kontraktuese gjatë vitit 2008, mund të shihet se është një skandal shumë i madh. Veç nëse e merr faqen 36 dhe i sheh negociatat, kontratat e negociuara nga kompania apo kompania publike e KEK-ut, mund të shohësh tmerrin çka ndodhë brenda këtij Organi Rregllativ të Prokurimit, andaj më shumë vetëdije them se ky raport është sa për t'u mbuluar të gjitha të këqijat që kanë ndodhur brenda këtij Organi Rregullativ të Prokurimit Publik. Absolutisht, nuk mund të them se mund ta përkrah një raport të tillë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Për fjalë është paraqitur Myrvete Pantina.

MYRVETE PANTINA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Raporti i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik të Kosovës paraqet analizën e aktiviteteve të prokurimit publik në Kosovë për vitin 2008, si dhe jep rekomandime për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik, gjë që do të thotë edhe i takon në bazë të detyrës, në bazë të Ligjit për prokurimin publik.

Ky raport është i pasur me të dhëna statistikore që kanë të bëjnë me numrin e kontratave të nënshkruara sipas autoriteteve kontraktuese, për strukturën e numrit të kontratave, për vlerën e kontratave të nënshkruara, me të dhëna për vitin 2008, të cilat krahasohen edhe me vitin 2007. Mirëpo, problemet nuk shihen nga ky raport. Në raport ceket po ashtu numri i monitorimeve të kryera të aktiviteteve të prokurimit, por nuk ceken konstatimet

ose të gjeturat gjatë procesit të monitorimit, do me thënë nuk kuptohet se a ka pasur dobësi në procedurat e prokurimit.

Mirëpo, vet fakti që në Raport janë dhënë shumë rekomandime për përmirësimin e sistemit të prokurimit, do të thotë se problemet ekzistojnë në procedurat e prokurimit.

Nga raporti shihet se është shkalla e lartë e anulimit të tenderëve të publikuar, një element që u cek edhe nga shumë folës më herët. Një gjë e tillë pengon realizimin e tyre në afat të paraparë, natyrisht, edhe rritë shpenzimet apo ngarkon buxhetin. Një faktor që ndikon në këtë shkallë të lartë të tenderëve të anuluar, është se në 82% të rasteve janë pranuar më pak se 3 ofertues të përgjegjshëm. Por, edhe për këtë nuk dihet se pse nuk ka pasur ofertues të mjaftueshëm. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Diskutues më nuk ka, dhe njëkohësisht forum për të votuar nuk ka. Gani Koci e ka kërkuar fjalën, dy minuta. Po i biem ziles, në qoftë se janë deputetët të vinë, po i presim pak minuta. Zoti Koci e ka fjalën.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Në cilësinë e kryetarit të komisionit, unë thashë se ne si komision e kemi shqyrtuar, ndërsa i mbetet Kuvendit që të vendosë lidhur me dobësitë e këtij raportimi, por paraprakisht, po them, nga të gjithë diskutuesit u dëgjua një dozë e kritikës, të cilën dozë e kemi pasur edhe ne si anëtarë të komisionit, por me të vetmin dallim dhe ndryshim se shumica e diskutuesve këtu as nuk e kanë lexuar se cilat janë autorizimet e Rregullatorit të Prokurimit Publik dhe të flasin mbi bazë të atyre autorizimeve se cilat janë dobësitë dhe mangësitë e këtij dokumenti dhe vetëm atëherë kishim mund të shohim vërtet atë që po e dëshirojmë të gjithë, një ambient të mirë të procesit të prokurimit dhe të aktivitetit të prokurimit.

Ky rregullator e ka për detyrë bërjen e rregullave të prokurimit publik dhe përcjelljen e aktivitetit të prokurimit publik në zbatimin e këtyre rregullave. Është një organ tjetër, po ashtu, një Agjencion tjetër i pavarur i Prokurimit Publik, që është Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik, raportin e të cilit do ta shqyrtojmë sot këtu dhe tek në atë raport mund të shohim se vërtet sa janë zbatuar ato rregulla dhe ku kanë qenë shkeljet dhe cilat janë ato shkelje dhe vërtet a janë ndërmarrë masa të caktuara ndaj shkelësve të rregullave të prokurimit publik.

Ne si Komision kemi ardhur në përfundim se ligji duhet të ndryshohet dhe, natyrisht, propozuesi duhet të shikojë mirë se a ekziston nevoja, a duhet edhe më tutje të ketë në një proces, në një organ që quhet ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Regjia, ia zgjatni kohën të flasë Ganiu!

GANI KOCI: ...kemi tre agjencione që merren me këtë aktivitet, siç është APP-ja, KRPP-ja dhe OSHP-ja. Dhe, duke pasur kështu tri organe që merren me këtë aktivitet dhe e mbikëqyrin këtë aktivitet, është e natyrshme që vërtet nuk mund ta çojmë procesin e këtij aktiviteti dhe mbikëqyrjen e shpenzimeve të parasë publike. Dikush e tha këtu se ka vetëm shifra. Këtij organi i shkojnë raportet prej agjencioneve buxhetore të ndryshme rreth aktivitetit të prokurimit dhe, mbi bazë të atyre raporteve, këta i përmbledhin dhe na i sjellin neve këtu.

Çështja tjetër është se ky raport nuk përmban se cilat masa i ka propozuar organi rregullativ ndaj autoriteteve kontraktuese në rast të shkeljes së Ligjit të prokurimit publik. Dhe, nëse me themelimin e OSHP-ës, një pjesë e përgjegjësive i është dhënë këtij agjencioni, bile së paku në 6 mujorin e vitit 2008 është dashur të na tregojë se ku kanë qenë ato shkelje dhe cilat janë masat që ka ndërmarrë ose ka propozuar që të ndërmerren ndaj autoriteteve kontraktuese në shkeljen e Ligjit të prokurimit publik.

Ne, edhe ligji e thotë këtu, se ky raport shqyrtohet në Kuvend, nuk miratohet, jepen vërejtje për këtë raport, sikur që i dërgohet edhe Qeverisë i njëjti raport, që do t'i japë vërejtjet e veta, prandaj unë konsideroj se ky Kuvend duhet të dalë me një rekomandim – që Ligji i prokurimit publik të ndryshohet sipas rekomandimeve të komisionit që i ka dhënë gjatë shqyrtimit të këtij raporti.

KRYESUESI: Atëherë, konstatoj se tani kemi kuorum, janë 61 deputetë në sallë. Mendoj se ne duhet të votojmë rekomandimet e komisionit dhe ftoj regjinë që të jenë gati për votim dhe votojmë tani për rekomandimet e Komisionit.

Konstatoj se me 38 vota “për”, 20 “kundër, miratohen rekomandimet e Komisionit.

(Ndërhyrje nga salla)

Votimi është në rregull, sepse janë 62 deputetë në sallë. Nëse nuk besoni, mund t'i numëroni.

Vazhdojmë me pikën e dhjetë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i Raportit të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2008

Komisioni për Buxhet e Financa, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës ka shqyrtuar Raportin e Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2008 dhe ka rekomanduar

shqyrtimin e tij në seancë plenare.

Raporti, me rekomandime, iu është shpërndarë deputetëve.

Ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, zotin Gani Koci, që të marrë fjalën.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Gati është i njëjti qëndrim i komisionit edhe ndaj këtij raporti të organit shqyrtues, me dallim që ky si Organ Shqyrtues i Prokurimit Publik është themeluar, nuk i ka më shumë se 6-7 muaj dhe ka pasqyruar aktivitetin brenda këtyre 6-7 muajve. Raporti i këtij organi, megjithatë, nuk është gjithëpërfshirës dhe nuk i plotëson, nuk i ka plotësuar kushtet e raportimit sipas ligjit. Ne kemi kërkuar nga ky organ që së paku të na i plotësojë pjesët që i kemi kërkuar, si komision, dhe kemi marrë raportin e dytë të plotësuar që, megjithatë, si i tillë i ka edhe dobësitë dhe mangësitë e veta. Në të shumtën e rasteve ky raport nuk përmban pjesët që i jep, që i autorizon ligji. Sidomos nuk përmban se ku është shkel ligji, cilat dispozita ligjore janë shkelë, që e ka për detyrë t'i pasqyrojë, cilat masa i ka ndërmarrë, cili është aktiviteti i këtij organi në raport me gjykatën dhe prokurorinë dhe në shqyrtimin e ankesave të caktuara. Vërejtjet kryesore kanë qenë lidhur me këtë dhe

rekomandimi i Komisionit është që të kihet parasysh këto vërejtje të komisionit që i ka marrë dhe të mos na përsëriten në raportimet e ardhshme.

Është e vërtetë se iu ka munguar përvoja e punës, funksionimi, me çështje hapësinore kanë pasur pengesa, me çështje të buxhetit kanë pasur pengesa të natyrës së ndryshme, por këto nuk e justifikojnë që së paku për atë kohë, atë periudhë që ka vepruar, të mos na i pasqyrojë në raport në mënyrë të detajuar.

Drejtimin e seancës e merr zoti Sabri Hamiti

KRYESUESI SABRI HAMITI: Tani do të flasim shefat e grupeve parlamentare. Safete Hadërgjonaj, e ka fjalën në emër të Partisë Demokratike.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar dhe zoti zëvendëskryeministër,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Raportin e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik dhe është i mendimit që ky organ shqyrtues raportin e ka sjellë me kohë dhe me plotësimet që i janë bërë këtij raporti, i plotëson kushtet dhe i plotëson pikat e nenit të cilat janë të parapara për raportim në Kuvendin e Kosovës, domethënë pikat e nenit të Ligjit të prokurimit publik.

Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik është një organ shumë i rëndësishëm për rritjen e transparencës dhe të përgjegjshmërisë për administrimin e mirë të fondeve publike dhe njëkohësisht krijon kushte për një konkurrim të drejtë dhe të paanshëm të operatorëve ekonomikë.

Nga raporti, nëse shikojmë me kujdes, vërejmë se po rritet interesi i operatorëve ekonomikë për të paraqitur ankesa kur shkelen të drejtat e tyre sipas Ligjit të prokurimit publik.

Operatorët ekonomikë vetëm gjatë 5 muajve të funksionimit të punës së këtij organi shqyrtues i kanë paraqitur 179 ankesa, nga 207 ankesa sa i ka pasur në tërësi ky organ i pavarur. Nga kjo vërehet se gjithnjë e më tepër po rritet besueshmëria ndaj Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik në mbrojtjen e interesave të operatorëve ekonomikë.

Në kompetencë të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik është të hetojë veprimet apo mosveprimet dhe të gjitha ato veprime të cilat janë të kundërligjshme të autoriteteve kontraktuese në bazë të ankesave dhe të rekomandojë masa korrigjuese. Ndoshta ka qenë mirë që në këtë raport t'i shohim edhe disa masa rekomanduese të cilat i ka paraqitur ky organ i pavarur shqyrtues.

Meqenëse 30 ankesa të miratuara të operatorëve ekonomikë, janë 30 të cilat janë miratuar të operatorëve ekonomikë, atëherë vërehet se ka shkelje të neneve të ligjeve të prokurimit publik, por cilat janë ne nuk i dimë dhe a kanë pasuar masa ndaj shkelësve të këtyre neneve të Ligjit të prokurimit publik, nuk janë të paraqitura në këtë raport.

Meqenëse Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik veç ka filluar punën diku në muajin gusht, raporti i përpiluar ka pasuar vetëm për 5 muaj veprimtarie dhe për këta 5 muaj vërehet se është bërë një punë intensive nga ana e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik, prandaj Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike i përkrah rekomandimet e

Komisionit për Buxhet dhe njëkohësisht e përkrah Raportin e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, flet deputeti Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe pse raporti i Organit Shqyrtues të Prokurimit është i dobët në kuptim të kërkesave të raportimit, pra është i mangët, duke marrë parasysh mungesën e përvojës së raportimit të këtij organi, meqenëse ky organ është themeluar në gjysmën e dytë të vitit raportues, pra të vitit 2008, Grupi Parlamentar i LDK-së sugjeron që rekomendimet e Komisionit për Buxhet të mbështeten dhe po ashtu të përkrahet ky raport meqenëse, thashë, ka mangësi por ato mangësi nuk do t'i përsëris, i përmendi kryetari i Komisionit për Buxhet, është mungesë e përvojës në raportim dhe kërkojmë që në të ardhmen, kur t'i raportohet Kuvendit, ky organ ta bëjë një raport të plotë sipas standardeve të raportimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të Aleancës Kosova e Re, Ibrahim Makolli, shef i Grupit.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Me të vërtetë këtu po shkruan raport, por më së paku është raport, më tepër kemi të bëjmë me një informatë të këtij organi për konsolidimin e institucionit, sepse po që se e shihni, këto janë gjithsej 2 faqe në numra, për të cilat nuk ka njeriu se si të shqyrtojë diçka.

U tha këtu edhe nga kryetari i Komisionit që mungojnë ato se ku janë shkelë, cilat dispozita të ligjit dhe cilat janë procedurat e mëtutjeshme që ka ndërmarrë, prandaj sugjerimi ynë është që ky raport t'i kthehet mbrapa këtij organi, ta kompletojë dhe kur të jetë i kompletuar, pastaj ta diskutojmë. Përndryshe, për fat të keq, nuk kemi çka të diskutojmë, sepse kemi vetëm numra, një tabelar dhe asgjë tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e merr shefi i Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Tani, sikur pak më përpara, kryetari i komisionit thotë se nuk i plotëson kushtet raporti, që nuk i ka arritur objektivat e parapara me ligj, që ka shumë mangësi raporti, thotë po e kalojmë se institucioni është i ri. Edhe një herë, raporti nuk bëhet për ta vlerësuar ne, t'ia qesim notën institucionit. Raporti vjen para Kuvendit për të vlerësuar punën e Qeverisë, për të vlerësuar se qysh është shpenzuar paraja publike. Për të arritur ne deri te ky vlerësim, e marrim raportin, e jo për t'i qitur notë, domethënë, organit shqyrtues se a ka qenë i mirë, a ka qenë i keq.

Mendoj se prapë kemi mbërri te pika ku duhet thënë se këto raporte bëhen për të kamufluar masakrimin e parasë publike. Shikoni vetëm përmbajtjen!

Zoti Makolli e përmendi, dy faqe i kemi raport. Shikoni çka është përmbajtja. Baza ligjore në fuqi, nën një, na shpjegon neve se cila është baza ligjore në fuqi.

Atje thotë – parimet mbi të cilat funksionon Organi Shqyrtues i Prokurimit, prapë na tregojnë se në bazë të cilave parime. Ne vetë e kemi themeluar, ata na kallëzojnë neve cilat janë parimet.

Thotë, ngritja dhe fillimi i punës së institucionit të OSHP-së. Shumë bukur, bravo! Përzgjedhja dhe trajnimi i stafit, ecë edhe më tutje. Struktura dhe organogrami i OSHP-së, ky është raporti që është dashur të na e bien neve për ankesa, domethënë, po flas. Marrëdhëniet me publikun. Për marrëdhëniet e veta me publikun OSHP-ja na raporton neve. Atje thotë, për buxhetin e OSHP-së dhe shkon te shqyrtimi i ankesave të prokurimit në dy faqe, atëherë vazhdon prapë me punën e vet – konsolidimi i institucionit, e tjera, e tjera, e tjera.

Unë mendoj se pa dashur të përsërisë veten, të gjitha ato çka i thashë paraprakisht, vlejnë edhe njëherë. Unë mendoj se ky Kuvend po shndërrohet në një institucion i cili vetëm sa i miraton të gjitha veprimet më të këqija të mundshme që ndodhin në këtë vend, veprime të cilat unë personalisht as si individ, as si deputet nuk kam besuar që kemi për ta sjellë vendin tonë në këso gjendjeje. Faleminderit!

Drejtimin e seancës e rimerr zoti Xhavit Haliti

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Faleminderit! Sipas radhës, është LDD-ja. Kush është paraqitur? Synavere Rysha. Urdhëro Gani, je paraqitur për replikë? Okej, Gani Koci për replikë. Më fal Synavere!

GANI KOCI: Nuk e thashë rastësisht se shumë diskutues këtu nuk e lexojnë ligjin dhe tash më dhanë përshtypjen se nuk i kanë lexuar as rekomandimet e komisionit dhe flasin përmendësh. Nuk jam ithtar i të folurit përmendësh, prandaj do ta lexoj raportin, Rekomandimet e Komisionit, zoti Gjini, dhe të mësoheni të lexoni, para se të diskutoni. Komisioni ka shqyrtuar raportin e OSHP-së për vitin 2008 dhe ka konstatuar se i plotëson kushtet ligjore të raportimit. Nuk ka thënë se është raport i mirë ose është raport i keq, i plotëson kushtet ligjore të raportimit. Se a është raport i mirë apo është raport i keq, e konstatojmë ne këtu me diskutimet tona. Një fakt dua t'ua them se Kuvendi i shqyrton raportet, por nuk i miraton raportet e këtyre dy agjencioneve. Vetëm i shqyrton dhe nëse ka rekomandime, rekomandon dhe i nxjerr Kuvendi ato rekomandime, atëherë ato rekomandime i voton dhe ua çon institucioneve të cilat neve na raportojnë këtu. Prandaj, nuk kërkohet votim për këto raporte, vetëm në qoftë se Kuvendi ka nxjerrë rekomandime që i adreson problemet ndaj këtyre agjencioneve.

KRYESUESI: Zoti Gjini ka kundërreplikë!

ARDIAN GJINI: Zoti Koci, a bën të më dëgjoni?

KRYESUESI: Ju lutem, zoti Ibrahim dhe Gani! E keni foltoren e hapur për të diskutuar sa herë të doni. Po, por radhën e ka zoti Gjini. ka kundërreplikë dhe pastaj paraqitu, pse jo. Zoti Gjini e ka fjalën!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, por s'po mi krijon kushtet të flas. Shikoni!

KRYESUESI: Ju kisha lutur që ta lejojmë ta bëjë kundërrepublikën zoti Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit shumë, zoti kryesues!

Mendoj se zoti Koci në vend që të na këshillojë të mësojmë të lexojmë apo mos të mësojmë, duhet të mësojë vetë fillimisht të lexojë dhe, e dyta, duhet të flasë për materien që po flasim, e jo të japë këshilla, se shumë janë mësuar t'u japin këshilla deputetëve, nuk e di çka kanë kështu. Krejt çka fola unë, e fole edhe ti. Është raport i keq, duhet të kthehet, edhe unë po them me plotë kompetencë, që ky raport, edhe ai paraprak, se i përmendi vetë të dytë, janë vetëm kamuflim dhe mbulesë për masakrimin e parasë publike, janë bërë me qëllim për mos të marrë vesh askush se çka po ndodhë këtu. Këtë po e them unë edhe një herë, le të ma dëshmojë të kundërtën, zoti Koci, e të mos më tregojë mua a të mësoj të lexoj, a jo. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, fjalën e ka deputetja Synavere Rysha.

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë me kujdes e ka shqyrtuar Raportin e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik në Kosovë për vitin 2008 dhe vlerësojmë se raporti nuk i plotëson kushtet dhe kriteret e nevojshme për raportim. Nuk është në harmoni me standardet e raportimit qysh kërkohet për një organ shqyrtues, siç është rasti me Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik.

Në fakt, i gjithë materiali i paraqitur në këtë dokument, më tepër i përshkruan çështjet dytësore apo sekondare, se sa ato të rendit të parë. Në fillim këtu paraqet bazën ligjore të themelimit të këtij organi, mandej i paraqet parimet e funksionimit, stafin e tjera, çështje ndoshta jo të rëndësishme për Kuvendin, sepse është i themeluar nga ky Kuvend dhe janë shumë të njohura për deputetët.

Çështjeve më të rëndësishme më pak iu kushton rëndësi dhe ky institucion, domethënë, nuk ka përmbushur kriterin e raportimit për Kuvendin. Nuk e di si ka mund Komisioni për Buxhet dhe Financa ta kalojë këtë raport, edhe pse ka vlerësuar se nuk është një raport që i plotëson kriteret. Në momentin kur e ka vlerësuar, është dashur ta kthejë te organi rregullativ e jo ta sjell apo ta procedojë për në seancën e radhës. Është dashur t'ia kthejë organit rregullativ me vërejtjet e arsyeshme, me ato që duhet të plotësohen, e mandej të na vijë në Kuvend dhe ta debatojmë. Mirëpo, kjo nuk ka ndodh.

Këtij raporti i mungon një pasqyrë e qartë për shkelje të ligjit gjatë procedurave të prokurimit. Cilat kanë qenë masat e ndërmarra për përmirësimin e gjendjes, kush kanë qenë shkelësit më të mëdhenj të procedurave të prokurimit, si ka ndikuar kjo dhe sa është dëmtuar buxheti i Kosovës nga shkeljet e tilla dhe shumë çështje të tjera që është dashur të jenë pjesë e këtij raporti.

Duke pasur parasysh këto fakte, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë nuk e mbështet këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

U akuzuam këtu që nuk po i lexojmë ligjet dhe s'po dimë çka po flasim, por unë të gjithë atyre po u them, në këtë rast zotit Koci, se ne ishim tërësisht brenda kësaj materie. Unë po them se ky nuk i plotëson kushtet që të jetë raport. Nëse ju keni diçka në mendje, është krejt diçka tjetër, por po ashtu po e shfrytëzoni shumicën parlamentare në komisione dhe

natyrisht kalon kështu. Po flas duke u mbështetur në këtë ligj, sepse ky organ na ka sjellë ligjin neve këtu, se si është konsoliduar dhe një pjesë e ligjit. Po e citoj një pjesë të ligjit: “Të raportojë direkt në Kuvendin e Republikës së Kosovës për aktivitetet dhe problematikat që trajton, nëpërmjet analizës vjetore, me kërkesë të Kuvendit”. Absolutisht, as njëra as tjetra nuk janë. Të rekomandojë masa korrigjuese. Në këtë raport përpos këtyre tabelave me numra, të cilat ju mund t’i dini, ne nuk po i dimë, kurrgjë tjetër nuk ofrohet. Prandaj, ky nuk është raport dhe duhet të kthehet mbrapa. Jo rrallëherë kemi miratuar raporte të tilla, që gjithsesi po bëjnë edhe shkelje të ligjit. Po, ky nuk është raport, zoti Koci. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Naim Rrustemi.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit! Unë nuk kam shumë çka t’i shtoj diskutimit të kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa. Pajtohem plotësisht me të, por unë do të bëj një propozim në rekomandimet e kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa, sepse nuk po më duket shumë i arsyeshëm arsyetimi shumë emotiv, emocional, mungesa e përvojës, është hera e parë, andaj propozoj që të ndryshohen rekomandimet e komisionit dhe që të mos pritët për vitin e ardhshëm, pra që t’i kthehet ky raport Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe të bëhet raporti më gjithëpërfshirës. Nëse veç ne themi se raporti nuk është gjithëpërfshirës dhe i rekomandojmë që vitin e ardhshëm, s’kemi nevojë të humbim edhe kohën deri tani. Nëse pajtohem që nuk është gjithëpërfshirës, që shumica janë pajtuar prej diskutimeve të deritashme çka u thanë, edhe arsyeja, po pajtohem se nuk është gjithëpërfshirës. Tash po tentojmë ta arsyetojmë pse të kalojë për këtë vit. Nuk kemi arsye të arsyetojmë pse të kalojë për këtë vit. Ia kthejmë, e bëjnë më gjithëpërfshirës dhe e shqyrtojmë ne edhe njëherë. Kështu që në pikën e dytë, Komisioni i rekomandon OSHP-së që raportet e ardhshme vjetore të jenë më gjithëpërfshirëse, të ndryshohet që “Komisioni i rekomandon OSHP-së që raporti të jetë më gjithëpërfshirës”. Jo, “që vitet e ardhshme”. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Driton Tali e ka fjalën!

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë vetëm desha një replikë të vogël në përgjithësi, por pa emëruar askënd. Nëse këto dy raporte quhen raporte, unë atëherë ftoj çdo kënd dhe të sfidojmë shkencërisht se çka nënkuptojmë me raportin. Shikoni, në një raport i ke 7 informata, që na i kanë prezantuar në 50 faqe dhe në një raport tjetër janë diku 10 informata, që na i kanë prezantuar në dy faqe. Dhe, t’u themi këtyre raporte, unë nuk e shoh të arsyeshme. Të paktën, për aq sa unë e di se çka është raporti dhe si jam mësuar të shkruaj raporte, d.m.th. punime që mund t’i kuptojë çdo lexues i arsyeshëm. Mua po më intereson, ja po e marr shembull, këtu në raport ku thuhet se “janë revokuar apo janë kërkesa nga PTK-ja - 4, janë revokuar -3, procedurë të negociuar sipas nenit”, flas për shqyrtimin e vendimeve të... një, pastaj katër, çka do të thonë këto shifra.

Mua po më intereson pse nuk shkruan këtu për një të pa informuar, se çka ndodhi me tenderin për marketing dhe reklama të PTK-së, flas për tenderin 3,4 milionë euro që ju dha “Top Channelit”, po bie fjala dhe cilat procedura janë shkelur aty sepse ky tender pati shkruar në OSHP për ta analizuar, dhe OSHP e pati kthyer prapa si korrekte, e tjera, e tjera. Domethënë, ne mund të flasim gjithë ditën këtu, ama këto dy punime raporte nuk janë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Ismet Beqiri është paraqitur. Zoti Koci, a doni të diskutoni, të hyni në mes apo për fund të propozimit, sepse je i paraqitur non-stop. Okej, zoti Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Me të vërtetë po përsëriten gjërat dhe e mbështes propozimin e zotit Rrustemi. Arsytet u thanë këtu edhe nga ata që referuan dhe i mbrojnë në një mënyrë rekomandimet, sepse ka kundërshti. Ky mund t'i plotësojë kushtet për t'u futur në rend dite, por e njëjta, menjëherë në pikën 2 thuhet se ka lëshime dhe për të ardhmen të përmirësohen. Nuk shoh arsye që kjo të ndodhë për të ardhmen, por pikërisht të ndodhë me kthimin e këtyre rekomandimeve, gjegjësisht me kthimin e këtij raporti, të përmirësohen dhe të na vijnë të përmirësuara dhe ashtu siç kërkohet në pikën e dytë, të jetë gjithëpërfshirës e jo të ndodhë ta miratojmë tash, u tha shumë bukur, për hatër të kësaj ose të asaj, e pastaj në të ardhmen të mos i bëjmë këto lëshime.

Unë konsideroj që nuk ka nevojë tash kjo të miratohet, por të përmirësohen lëshimet që mund të përmirësohen. Po mirë, për rekomandimet po flas, sepse e keni shkruar qartë këtu çka po shkruan, zoti Koci. Prandaj, e mbështes atë që t'i kthehet ky raport dhe të plotësohet ashtu siç thuhet në vetë rekomandimet e Komisionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Gani, ju e keni fjalën, i fundit.

GANI KOCI: Neni 116 i Ligjit të prokurimit publik lidhur me dërgimin e informacioneve nga Autoriteti Shqyrtues i Prokurimit Publik, thotë: për çdo vit kalendarik OSHP do t'i sigurojë Kuvendit më së voni deri në fund të shkurtit të vitit pasues kalendarik informacionet dhe të dhënat, në vijim:

- Numrin e përgjithshëm të ankesave të pranuar.

Ju lutem, a e keni numrin e përgjithshëm të ankesave të pranuar?

- Numrin e ankesave të refuzuara për shkak të mungesës së afateve kohore ose joplotësi, sipas nenit 105 dhe 106.

Lexoni, a e keni këtë element atje?

- Numrin e ankesave që janë konstatuar se nuk përmbajnë pretendime të vlefshme.

Lexoni a e keni, ose keni nevojë t'ua tregoj në cilën faqe gjenden këto informacione në raport.

- Informacione të hollësishme për çdo rast kur autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar një urdhër të OSHP-së dhe e shihni këtu se a ka pasur urdhër të OSHP-së dhe cili autoritet kontraktues e ka respektuar ose nuk e ka respektuar, dhe
- Numrin e procedurave të shqyrtimit që kanë rezultuar me konstatimin se aktiviteti përkatës i prokurimit publik, dhënia ose vendimi janë bërë në mënyrë të vlefshme.

Urdhëroni, i gjeni, ndoshta i gjeni në një fjali të shkurtuar, ndoshta i gjeni në një frazë më të gjatë, por i gjeni në këtë Raport.

Me këtë nuk dua të mbroj Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik, por e ka plotësuar siç kemi thënë, ka plotësuar formën e raportimit dhe e kemi thënë se duhet të jetë edhe më gjithëpërfshirës, siç e kemi konstatuar si Komision. Unë çuditë nga anëtarët e komisionit, që unë e udhëheq, të partive që sot e kundërshtojnë këtu dhe do të ishte mirë ta dini se cili ishte qëndrimi i tyre edhe gjatë, prandaj herëve tjera unë do t'i sjell edhe procesverbalet e komisionit dhe diskutimet e tyre lidhur me këtë raport, ose me raportimet e...

KRYESUESI: Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Jo, unë vetëm desha të sqaroj diçka për arsye se jam anëtar i këtij Komisioni. Në dy këto raporte që kaluan, kam abstenuar. Arsyet janë shumë. Unë do të kisha lutur që këto organe le të vijnë dhe le të raportojnë pranë Kuvendit.

Veç dua ta lexoj një fjali, thotë këtu: "OSHP nuk janë pjesë e asnjë force politike". Ku ta di unë si anëtar i komisionit, a është anëtar i ndonjë organizate politike, a nuk është, ose po kërkohet nga ne, sikur të ishim auditorë të brendshëm dhe të dimë a është shkelur apo nuk është shkelur. Do të thotë, është mirë që raportuesit të vijnë pranë Kuvendit, këtu para, me raport dhe ta lexojnë raportin dhe këtu jemi 120 deputetë dhe kemi njohuri më shumë se sa një komision, ku jemi 11 ose 12 dhe shpeshherë mbivotohemi nga shumica. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Atëherë, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin e Raportit të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2008.

Lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim dhe votojmë tani.

Në sallë janë prezentë 63 deputetë. Ju lus që të votojmë "për" ose "kundër", vullneti i secilit është. Ju faleminderit!

Regjia, votojmë, tani Raportin e Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2008. Unë, në qoftë se komisioni kërkon që të mos votohet raporti, unë nuk kam kundër, por kërkesa ka ardhur e shkruar që të votohet ose të miratohet Raporti i Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2008, prandaj unë nuk mund ta ndryshoj qëndrimin dhe rekomandimin që i është bërë Kryesisë për këtë seancë.

Nëse, prapë po them, komisioni mendon se duhet të votojë vetëm ndonjë rekomandim të tij, atëherë vazhdojmë me debat. Urdhëro, zoti Koci!

GANI KOCI: Komisioni ka kërkuar që Kryesia e Kuvendit ta radhisë në rend dite dhe ta diskutojë dhe ta shqyrtojë këtë raport, duke i pasur parasysh këto rekomandime, se komisioni rekomandon që raportet e ardhshme, kjo është rekomandimi i komisionit, të jenë më gjithëpërfshirëse dhe të pasqyrohet me dispozita shkelja gjatë aktivitetit të prokurimit. Ky është rekomandimi i komisionit. Është kërkesë e komisionit, por po ju them edhe njëherë se Ligji i Prokurimit Publik në këto raportime, te çështja e raportimit nuk thotë se Kuvendi e miraton ose nuk e miraton një raport, e shqyrton raportin. Ju lutem! Ne rekomandimeve të komisionit mund t'ia shtojmë edhe ndonjë rekomandim të propozuar prej Kuvendit këtu.

KRYESUESI: Unë, përmendësh nuk e kam ndërmend të punoj, as nuk e kam ndërmend për të qitur diçka në votim, se këtu keni diskutuar shumë. Secili që ka diskutuar, ka dhënë ndonjë propozim. Urdhëroni, përmbledhni propozimet dhe i hedhim në votim propozimet, në qoftë se ka në emër të komisionit dhe në emër të Parlamentit.

Unë, po them prapë, në dokumentacionin që është përgatitur nga mbledhja e Kryesisë, konform rekomandimeve të komisionit, unë e kam për obligim ta qes në votim Raportin e Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2008. Nëse nuk besoni, jua jap, lexojeni!

(Reagime nga salla)

Atëherë, kryetari i Komisionit ra dakord që shtesë rekomandimeve të Komisionit, t'ju bëhen...

A do t'i lexoj fjalë për fjalë? Jo, jo, a do që t'i lexoj? Prit, ta jap fjalën dhe...

(ndërhyrje nga salla)

... mirë de, prit të sqaroj unë. Mua më ka futur në lajthitje administrata e Kuvendit të Kosovës, me letrat që m'i ka qitur përpara, konform, po them, rekomandimeve të komisionit edhe vendimeve të Kryesisë. Unë përmendësh nuk jam duke e udhëhequr seancën, sepse pati shumë pika të rendit të ditës.

Kryetari i komisionit po kërkon që të votohen rekomandimet e komisionit. Mua tani m'i dhanë rekomandimet e komisionit. Në qoftë se nga tri rekomandimet e komisionit, njëra nuk është kontestuese për ju, të nderuar deputetë, e votojmë prapë edhe atë. Në qoftë se me pëlqimin e komisionit, dikush pretendon të fusë rekomandim shtesë këtyre tri rekomandimeve të komisionit, atëherë i votojmë edhe ato. Nuk e di pse, pse duhet të...

Një rekomandim konkret e ka pasur Naim Rrustemi. Lidhur me rekomandimin e Naimit është deklaruar edhe zoti Koci "për". Atëherë, ka ndonjë rekomandim tjetër shtesë?

(Ndërhyrje nga salla)

Çka ke ti? Për çka? Jo, jo, a ke ndonjë rekomandim? Urdhëro, zoti Makolli e ka fjalën për një rekomandim.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit!

Seriozisht, vetëm shikoni rekomandimet e komisionit. Nëse ju kërkon prej nesh që të votojmë për rekomandimin, po ua lexoj rekomandimin e tretë: "Prandaj është e domosdoshme që Kuvendi të diskutojë për këtë çështje, siç theksohet në Rekomandim". A duhet të votojmë për këtë rekomandim? A po i lexoni cilat janë rekomandimet? A duhet votuar për këtë rekomandim?

KRYESUESI: Unë mund të votoj, mundem edhe të mos votoj, ashtu si çdo deputet këtu. Unë, as nuk i kam shkruar rekomandimet, as nuk jam redaktor i rekomandimeve.

Po vazhdomë me seancën. Do të thotë, Ibrahim Makolli propozon që të hiqet pasusi i tretë i rekomandimeve të komisionit.

Të nderuar deputetë,

Meqenëse kur njeriu do të komunikojë mirë me të gjithë ndonjëherë, i bie keq, mendoj se kuorum kemi. Detyrë e imja është ta hedh në votim materialin që më ka ardhur. Të gjithë keni pasur mundësi të dërgoni propozime në komisionet përkatëse. Ju lus që t'i votojmë rekomandimet e komisionit me shtesën që e ka miratuar.

Votojmë, tani:

Konstatohet që me 36 vota “për”, 20 “kundër”, 5 abstenime, nuk miratohen rekomandimet e komisionit.

Vazhdojmë me pikën e 11 të rendit të ditës:

11. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e një anëtari joekzekutiv të Bordit drejtues të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar propozimin e Bordit Drejtues të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për emërimin e një anëtari joekzekutiv në Bordin Drejtues të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Raporti i Komisionit së bashku me dokumentacionin iu është shpërndarë deputetëve. Ftoj kryetarin e Komisionit, zoti Gani Koci, që para deputetëve të Kuvendit të Kosovës t'i arsyetojë rekomandimet e dhëna. Zoti Koci, e keni fjalën.

GANI KOCI: Do të përpiqem të jem pak më i qartë, nëse nuk jam kuptuar deri më tash. Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar propozimin për emërimin e kandidatit, zoti Mehdi Bektashi për anëtar joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe i rekomandon Kuvendit që këtë propozim ta votojë dhe ta miratojë në këtë Kuvend. Jam i obliguar të them që, përveç tri abstenimeve, abstenime jo kundërshtime, Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka mbështetur këtë propozim. Nëse është e nevojshme, mund t'i them edhe me emër e mbiemër abstenimet, por kundërshtime në Komision, nuk ka pasur.

KRYESUESI: Sipas Rregullores, ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare që të deklarojnë lidhur me propozimin.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka zoti Ramë Buja.

RAMË BUJA: Nëse diçka dëgjohet nga kjo që mund ta them, ne e përkrahim propozimin në fjalë dhe votën e keni pro.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, fjalën e ka zoti Shatri.

HAKI SHATRI: Ju faleminderit!

Grupi Parlamentar i LDK-së ka vendosur që deputetët nga Grupi i LDK-së, të votojnë sipas vullnetit të vet.

KRYESUESI: Okej.

Grupi Parlamentar i AKR-së, Shkumbin Demaliaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!
Si Grup Parlamentar do ta përkrahim dhe do ta votojmë profesorin e nderuar.

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Grupi Parlamentar i AAK-së, zoti Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti kryesues!
Ne nuk e mbështesim, nuk e përkrahim për shkak se pika paraprahe nuk është përfunduar, nuk është shteruar. Ka pasur nevojë të diskutohet më tepër, ka pasur nevojë të konstatohet çka del pas mosmiratimit të raportit dhe, në fund të fundit, nuk mendojmë se ka logjikë të vazhdojmë kështu me seancë plenare. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Grupi Parlamentar i LDD-së, Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Grupi ynë jo vetëm që e konsiderojmë se po bëjmë një shkelje në raport, me përgjegjësitë që i ka ky Kuvend, me pikën e kaluar, në pikën e kaluar Kuvendi i Kosovës nuk votoi, jo për arsye se këto rekomandime i ka propozuar komisioni funksional, nuk kanë qenë të qëlluara, por arsyeja kryesore ka qenë se kemi pasur një raport të mangët mbi të cilin, mbi këtë bazë, mbi këtë raport nuk mund të konkludosh me rekomandime....

KRYESUESI: e kemi krye atë pikë të rendit të ditës.

LULZIM ZENELI:... prandaj shkelja që ka qenë, do të ishte një porosi e keqe për Kuvendin e Kosovës.

Zoti kryesues, fjala kryesore është funksioni bazë i Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik, është garantimi i zbatimit të ligjshmërisë.

KRYESUESI: Ju lutem, ju lutem...

(ndërrhyrje nga salla)

A ke diçka tjetër lidhur me propozimin, për pikën e fundit, pikën 11.

LULZIM ZENELI: Pikën e fundit, jo pse jemi kundër, mirëpo personi në fjalë që është propozuar, nuk është makro financier. Nuk përkon profesioni, kjo do të thotë fusha e caktuar, kjo do të thotë sikurse gjinekologun ta qoni në kirurgji. Prandaj, propozimi që është dhënë, nuk është argumentuar. Ne jemi kundër këtij propozimi për arsye se ka, ka kapacitet Kosova dhe ka njerëz me të qëlluar për këtë pozitë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Konstatoj se nuk kemi kuorum për ta votuar, prandaj po e lëmë për seancën e ardhshme.

Ju faleminderit! Me kaq përfundoi seanca e sotme.

Përgatiti:
Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës